



AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

**RAPORTI
VJETOR**

2017

Mars 2018

Përmbajtje

1.	PËRMBLEDHJE	5
2.	STRATEGJIA AUTORITETIT	25
3.	QEVERISJA E AUTORITETIT	26
4.	AUTORITETI SI RREGULLATOR PËR NJË TREG AUDIOVIZIV TË PËRGJEGJSHËM	28
4.1.	Shqyrtimi tematik i përmbajtjeve të emetuara	28
4.2.	Monitorimet e përmbajtjeve	31
4.3.	Përqasja ndaj fenomenit të piraterisë në transmetimet audiovizive	40
5.	KËSHILLI I ANKESAVE.....	43
6.	AUTORITETI NË PËRMBUSHJE TË ZBATUESHMËRISË LIGJORE.....	47
6.1.	Plotësimi i akteve nënligjore të domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit të OSHMA-ve...	47
6.2.	Mbikëqyrja e shfrytëzimit të spektrit të frekuencave	49
7.	AUTORITETI SI NXITËS I ZHVILLIMIT TË SEKTORIT AUDIOVIZIV	52
7.1.	Angazhimi i Autoritetit në zhvillimet teknologjike të tregut audioviziv	52
7.2.	Kontributi i Autoritetit në mbështetje të studimeve shkencore	53
7.3.	Bashkëpunimi në rregullimin e tregut audioviziv	54
8.	KALIMI NË TRANSMETIMET NUMERIKE.....	57
8.1.	Digjitalizimi i transmetimeve audiovizive të operatorit publik	58
8.2.	Digjitalizimi i transmetimeve audiovizive kombëtare private	59
8.3.	Digjitalizimi i rrjeteve analoge të operatorëve ekzistues.....	59
8.4.	Procesi i migrimit të frekuencave	63
8.5.	Lirimi i brezit të Dividendit Digjital.....	63
8.6.	Fushata e informimit të publikut	64
8.7.	Kontrata AMA - RTSH	65
8.8.	Planifikimi dhe administrimi i spektrit të frekuencave	66
8.8.1.	Planifikimi i frekuencave për shërbimet audiovizive	66
8.8.2.	Koordinimi i frekuencave të brezit audioviziv.....	68
8.8.3.	Planifikimi i frekuencave për shërbimet audio	69
8.9.	Adresimi i interferencave të shkaktuara në vendet fqinje	70
8.10.	Angazhimi i Autoritetit në zhvillimet teknologjike të tregut audioviziv	71
9.	AUTORITETI NË PËRMBUSHJE TË TRANSPARENCËS DHE RRRITJES SË IMAZHIT INSTITUCIONAL...	71
9.1.	Programi i transparencës	71
9.2.	Publikimi i Buletinit Periodik të AMA-s	72
9.3.	Menaxhimi i performancës së burimeve njerëzore.....	73
9.4.	Infrastruktura e informacionit dhe e njohurive	74
10.	TREGUESIT FINANCIARË DHE MENAXHIMI I BURIMEVE.....	75

10.1.	Menaxhimi i burimeve financiare	76
10.1.1.	Burimet e financimit	76
10.1.2.	Ecuria e arkëtueshmërisë të burimeve të vetëfinancimit.....	76
10.1.3.	Detyrimet financiare të OSHMA-ve	77
10.1.4.	Vendime të sanksioneve me gjobë	79
10.1.5.	Përdorimi i burimeve financiare	79
10.2.	Pasqyrat Financiare	80

1. PËRMBLEDHJE

Në respektimin e parimeve themelore gjatë zhvillimit të veprimtarisë audiovizuale në drejtim të garantimit të lirisë së shprehjes, lirisë së medias dhe të së drejtës për informim, duke besuar se shërbimet audiovizuale shqiptare duhet të reflektojnë vlerat dhe identitetin e shoqërisë shqiptare, zhvillimit në pavarësi të plotë dhe efikasitet cilësorë editoriale, si dhe duke përmbushur detyrimet e parashikuara në kuadrin rregullator për procesin e digjitalizimit, Autoriteti i Mediave Audiovizive, në tërësinë e tij si institucion, ka përmbushur kryesisht rekomandimet e Kuvendit të Shqipërisë për vitin 2017.

Në përmbushje të të gjitha detyrimeve, në angazhim të përmbushjes së detyrimeve ligjore, si dhe rritjes së besimit të publikut ndaj rregullatorit, përgjatë vitit raportues, Autoriteti miratoi strategjinë tre-vjeçare, ku pasqyrohet mënyra e realizimit të funksioneve të veta ligjore.

Strategjia përfshin objektivat kryesore të AMA-s, agjendën e aktiviteteve që duhen ndërmarrë në përmbushje të tyre, si dhe rrugët e realizimit. Ajo është e ndërtuar mbi dy boshte kryesore:

- Dokumenti Strategjik
- Plani i Veprimit për Dokumentin Strategjik

Dokumenti strategjik përmban misionin, vizionin, vlerat, qëllimet strategjike, si dhe objektivat përkatëse të Autoritetit, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi dhe në parimet mbi të cilat funksionon;

Plani i Veprimit të Dokumentit Strategjik, ku parashikohen veprimtaritë me përparësi, si dhe rezultatet e pritshme për përmbushjen e qëllimeve strategjike, të ndara në afate, për periudhën 2017-2019.

Gjithashtu, gjatë vitit 2017, AMA ndërmori një sërë aktiviteteve për përmbushjen e detyrimeve të saj ligjore, ndër të cilat vlejné të përmenden:

- Miratimi nga AMA i Kontratës së Shërbimit të transmetimit publik të RTSH-së në mars të vitit 2017, ku fokusi kryesor për Autoritetin ishte vlerësimi i ecurisë konkrete të zbatimit të saj në dy komponentët kryesorë: ndërtimi i platformës me 12 kanale të vetë RTSH-së, si dhe nivelin e mbulimit me sinjal transmetimi në territorin e vendit. Analiza mbi mulimin me sinjal është trajtuar me tej, në seksion përkatës, faqja 10.
Gjashtë muaj pas miratimit të Kontratës, AMA realizoi një vlerësim analitik mbi përmbajtjen e buqetës programore, pas një monitorimi të mbi 1200 orëve transmetim. Në raportin vlerësues që i dërgoi edhe RTSH-së, në muajin tetor 2017, AMA rekomandonte themelimin në platformë edhe të dy kanaleve të dedikuara për fëmijët, si dhe të kanaleve tematike *Lajme dhe Jetë*, të parashikuara në Kontratë.

Gjithashtu, Transmetuesi Publik duhej të plotësonte kushtin e transmetimit e të paktën një edicioni informativ në 24 orë në dy kanalet gjeneraliste, RTSH 1 dhe RTSH 3, për personat me nevoja të veçanta shqisore, duke siguruar emetim simultan në një kënd të ekranit. Deri në atë moment kjo kërkesë ishte përmbushur vetëm në RTSH 1.

- Gjatë vitit 2017 AMA zhvilloi një proces 9-mujor konsultimi me grupet e interesit, ekspertë vendas e të huaj, për përmirësimet e Kodit të Transmetimit, aktin nënligjor më të rëndësishëm për mediat audiovizive. I miratuar që në janar të vitit 2014, teksti ekzistues i Kodit kaloi në vlerësimet për amendime, ndryshime dhe saktësime nga një seri konsultimesh të drejtëpërdrejta dhe virtuale, ku kontribuan Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, Agjencia Shqiptare për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, Observatori për të Drejtat e Fëmijëve, Rrjeti për demokraci i grave në Shqipëri, Qendra Shqiptare për Komunikim Publik, Shoqata Kombëtare e të Verbërve, Urdhri i Mjekut, Urdhri i Farmacistit, Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit në Universitetin e Tiranës etj., por dhe nga OSBE dhe Këshilli i Evropës.

Teksti final që u miratua nga AMA në fund të vitit 2017 përfshiu dhe pjesën më të madhe të 75 vërejtjeve dhe propozimeve konkrete të institucioneve dhe organizatave vendase, si edhe nga ekspertiza e detajuar që dërgoi Këshilli i Evropës.

Edhe për rregulloren e reklamave dhe komunikimeve tregtare, që është në fazën përmbyllëse të miratimit, procesi i konsultimit me grupet e interesit dhe publikun ka kaluar përmes takimeve të drejtëpërdrejta, si dhe shqyrtimit të hollësishëm të propozimeve e vërejtjeve që mbërrinin në AMA virtualisht. Një ekspertizë të hollësishme mbi këtë projekt-rregullore ka dërguar në Autoritet dhe OSBE-ja.

- Buletini Periodik i AMA-s, një set treguesish nga performanca e tregut audioviziv në Republikën e Shqipërisë, gjatë vitit 2017 ka qenë shumë referencial në punimet dhe kërkimet studimore të pedagogëve të shkencave të komunikimit e gazetarisë, si dhe në procesin e përgatitjes së temave të diplomave dhe detyrave të kursit për studentë të këtij drejtimi. Dy subjekte joqeveritare të njohura për projekte ndërkombëtare në fushën e transparencës së mediave - platforma ballkanike investigative, BIRN, dhe kompania e kërkimeve dhe konsulencës, IDRA - nga fundi i vitit 2017, bazuar në të dhënat e Buletinit Periodik, po bashkëpunojnë me AMA-n në shkëmbimin e informacionit mbi tregun audioviziv, veçanërisht mbi aspektet e pronësisë në këtë sektor.
- Nga bashkëpunimi i AMA-s me Departamentin e Gazetarisë dhe Komunikimit në Fakultetin e Histori-Filologjisë në Universitetin e Tiranës, gjatë vitit 2017 u realizua studimi “Krizat e mediave televizive shqiptare dhe nevoja për një model të ri ekonomik”. Objekt ishte performanca e operatorëve audiovizivë në vendin tonë, për të evidentuar elementë të rëndësishëm që lidhen me modelin menaxherial, tregun e reklamave, për

pronësinë dhe bashkëpronësinë në aktivitetin audioviziv, ndikimi në përmbajtjet e emetuara etj. Në studimin e tregut u angazhuan 25 pedagogë dhe kërkues shkencorë, si dhe 14 studentë që u morën me anketimet në Tiranë dhe në rrethe. Të gjithë materialin e përgatitur në kuadër të studimit, Departamenti e vendosi në qendër të një konference shkencore, e titulluar “Modelet ekonomike të industrisë televizive në Shqipëri”, që u zhvillua në mes të muajit dhjetor 2017.

- AMA, gjatë vitit 2017, ka bashkëpunuar dhe me subjekte që janë të angazhuara në fushën e medias apo të të drejtave të njeriut, për kualifikime të redaksive audiovizive. Nga projektet kualifikuese përfituan rreth 160 gazetarë, redaktorë dhe reporterë terreni që punojnë në fushën e mediave audiovizive në qarkun e Tiranës apo në qarqe të tjera, si Shkodër, Lezhë, Vlorë, Elbasan etj., si dhe 35 studentë të degës së gazetarisë dhe komunikimit që angazhohen në media.
- AMA ka vijuar gjatë vitit 2017 realizimin e shqyrtimeve tematike për të vlerësuar përputhshmërinë me ligjin 97/2013 dhe Kodin e Transmetimit të përmbajtjeve të transmetuara, për mbrojtjen e fëmijëve, për reklamat dhe komunikimet tregtare, për evitimin e gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit etj. Mbi problematikat e konstatuara, AMA u ka tërhequr vëmendjen subjekteve nën monitorim për respektimin e kuadrit ligjor.
- Për herë të parë në fokus është vënë edhe respektimi i standardit të shqipes së folur dhe të shkruar në programet audiovizive. Mbi problematikat e evidentuara tek operatorët kombëtarë apo lokalë/rajonale, AMA do të zhvillojë dhe një tryezë pune për diskutim me përfaqësues të redaksive audiovizive, me qëllim përmirësimin e situatës.
- Monitorimi i edicioneve informative kryesore në subjektet me licencë kombëtare, për kohën që u lihet subjekteve politike dhe institucioneve kryesore të vendit, protagonistëve të jetës politike dhe publike, si dhe volumit të reklamave të emetuara, është bërë transparent çdo muaj përmes publikimit në faqen virtuale të institucionit, si dhe çdo gjashtë muaj kur përfshihen në Buletinin Periodik të AMA-s. Këta tregues gjenden në seksionin e zgjeruar përkatës të këtij raporti.
- Gjatë fushatës elektorale për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2017 e gjithë infrastruktura e Studios së Monitorimit në AMA, si dhe specialistët e saj u vunë në dispozicion të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për monitorimin e mbulimit mediatic audioviziv të procesit, bazuar në ligjin 97/2013, si dhe në Kodin Zgjedhor të Republikës. Studioja e Monitorimit, gjatë periudhës maj - qershor 2017, ka ofruar shërbimin e vet vetëm për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, bazuar në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, si dhe në Marrëveshjen e Bashkëpunimit AMA - KQZ.

Në mbështetje të Kodit Zgjedhor dhe, specifikisht, të Bordit të Monitorimit të Medias (BMM), angazhimi i Studios së monitorimit ishte maksimal në përshtatjen e metodologjisë së monitorimit, trajnimin e personelit të monitoruesve, përgatitjen e teknikës së nevojshme dhe infrastrukturës përkatëse.

Janë monitoruar 12 subjekte audiovizive dhe 2 subjekte audio në lidhje me edicionet e lajmeve (audio dhe audiovizive), si dhe për transmetimin e reklamave apo emisioneve politike, duke regjistruar në total:

- Rreth 1800 edicione lajmesh të subjekteve audio dhe audiovizive;
- Rreth 3000 orë regjistrime për transmetimin e emisioneve politike;
- Rreth 3000 orë regjistrime për transmetimin e reklamave politike.

KËSHILLI I ANKESAVE

Këshilli i Ankesave, gjatë vitit 2017 është përpjekur të realizojë angazhimet dhe objektivat kryesorë që lidhen me ecurinë e kësaj strukture, si dhe zbatimin e kuadrit ligjor të tij. Këshilli i Ankesave, bazuar mbi planin e veprimit të vitit 2017, ka punuar për përmbushjen e plotë të qëllimeve dhe objektivave të tij.

Ndërgjegjësimi publik dhe ankesat e shqyrtuara

Konstituimi i Këshillit të Ankesave në vitin 2016 nxiti ndërgjegjësimin qytetar dhe ndërinstucional për të ngritur çështje të debatueshme mbi përmbajtjen e transmetimeve audiovizive. Gjatë vitit 2017, numri i ankesave dhe çështjeve të trajtuara u dyfishua në raport me vitin 2016, duke shënuar një trend në rritje mbi ndërgjegjësimin qytetar. Nëse në vitin 2016 u regjistruan rreth 35 ankesa, ku pjesa më e madhe shenjonte raste të cenimit të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, në vitin 2017 numri i tyre arriti në më shumë se 70, ku pjesa dërrmuese ishin për cenimin e privatësisë, shkeljen e dinjitetit dhe rregullave etike. Konkretisht, ankesat e adresuara kategorizohen si më poshtë:

- 42% për shkelje të të drejtave të fëmijëve;
- 40% për shkelje të etikës dhe dinjitetit;
- 10% me natyrë tregtare;
- 8% të tjera.

Shtimi i çështjeve të trajtuara, falë reagimit për çdo ankesë të ardhur në AMA, rriti edhe ndërgjegjësimin e operatorëve audiovizivë për zbatimin më korrekt të Kodit të Transmetimit, por edhe të subjekteve të tjera, p.sh. agjencitë e reklamave si palë e tretë.

Aktivitete

Gjatë vitit 2017, Këshilli i Ankesave ka organizuar disa tryeza/konferenca që lidhen me problemet etike të vërejtura në përmbajtjet audiovizive. Këto aktivitete, Këshilli i Ankesave i ka projektuar si një platformë efektive për komunikim dhe shkëmbim informacioni mes institucioneve e organizatave të ndryshme që fokus kryesor kanë mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut, autoriteteve qeveritare dhe organizatave ndërkombëtare.

Diskutimet dhe rekomandimet në këto tryeza kanë ndihmuar në hartimin e qasjeve të reja në punën e Këshillit dhe propozimeve konstruktive që ai ka trajtuar, në bashkëveprim me njësitë e tjera pranë AMA-s.

Hartimi i rregullores

Që prej konstituimit të Këshillit të Ankesave, një prej objektivave të tij ishte nxitja e një komunikimi sa më të thjeshtë dhe efikas me publikun. Thjeshtëzimi i procedurës për t'u ankuar dhe shqyrtuar ankesat u reflektua në miratimin e rregullores së re sipas kërkesave të ligjit. Rregullorja "Mbi procedurat për trajtimin e ankesave dhe të drejtën e përgjigjes" sjell përmirësimin e mëtejshëm të veprimtarisë së Këshillit të Ankesave, por edhe të OSHMA-ve në trajtimin e problemeve mbi përmbajtjen audiovizive.

Përmirësimi i Kodit të Transmetimit

Rishikimi i Kodit të Transmetimit u pa si nevojë edhe e reflektimit të rasteve të shqyrtuara nga Këshilli mbi përmbajtjen e transmetimeve audiovizive. Nisur nga fakti se Kodi i Transmetimit ishte miratuar në vitin 2014, ai nuk mund t'u përgjigjej më disa prej problematikave të reflektuara në ankesat e qytetarëve. Ndaj lindi nevoja e përmirësimit të tij, për shkak edhe të hovit teknologjik që përfshiu mediat audiovizive në epokën e digjitalizimit. Gjatë procesit të rishikimit të tij, Këshilli, ashtu si çdo palë tjetër e interesuar për zbatimin e Kodit të Transmetimit, propozoi amendime dhe ndryshime që u reflektuan në përmbajtjen e Kodit.

Anketimi me publikun

Anketimi me publikun është, ndër të tjera, dhe një mënyrë për të përfshirë drejtpërdrejt opinionin publik në vlerësimin e performancës së Kodit të Transmetimit. Realizimi i dy anketimeve me mbi 200 qytetarë që u përkasin grupeve të ndryshme sociale dhe gjinore, u realizua në bashkëpunim me Departamentin e Gazetarisë dhe Komunikimit në Universitetin e Tiranës. Rezultatet dhe përfundimet e nxjerra prej anketimeve u sugjeruan njëkohësisht si rekomandime për përmirësimin e Kodit të Transmetimit dhe për ndërgjegjësimin e OSHMA-ve mbi përmbajtjet audiovizive.

Buletini i Këshillit të Ankesave

Çdo 6 muaj, Këshilli boton një përmbledhje të përfundimeve të nxjerra në një buletin të veçantë. Çdo ankesë e trajtuar dhe e shqyrtuar nga Këshilli i Ankesave, në bashkëpunim me

drejtoritë e tjera në AMA, bëhet publike dhe transparente nëpërmjet këtij buletini periodik. Buletini përmban trajtimin, shqyrtimin dhe vendimmarrjen për ankesat, duke shërbyer si udhërrëfyes për çdo OSHMA që mund të përballë në të ardhmen me raste të ngjashme. Publikimi i çdo ankese të trajtuar ka nxitur ndërgjegjësimin e OSHMA-ve për zbatimin e Kodit të Transmetimit. Institucionet, organizatat jofitimprurëse apo individët kanë rritur ndërkaq vëmendjen ndaj problematikave të vërejtura në përmbajtjen audiovizive.

DIGJITALIZIMI I TRANSMETIMEVE AUDIOVIZIVE

Autoriteti i Mediave Audiovizive, gjatë vitit 2017, ka pasur në fokus të veçantë të punës së tij ndjekjen e procesit të digjitalizimit të transmetimeve audiovizive.

Gjatë vitit 2016 është shtruar infrastruktura e rrjeteve numerike nga operatori publik dhe operatorët privatë kombëtarë numerikë, por implementimi i këtij procesi është kryer gjatë vitit 2017 me mbylljen e transmetimeve analoge në qarqet Berat dhe Korçë. Procesi filloi me mbylljen e transmetimeve analoge në qarkun e Beratit, meqë ky qark është me popullsi të vogël, ndaj përcaktimi dhe plotësimi i kërkesave të qytetarëve për marrës televizivë numerikë do të ishte më i lehtë. Gjithashtu, në rast problematikash të paparashikuara, do të kishte impakt më të vogël krahasuar me qarqet me popullsi më të madhe.

Në përmbushje të angazhimeve të saj, të planifikuara në Dokumentin Strategjik 2017-2019, AMA ka zhvilluar veprimtaritë e saj bazuar në frymën e bashkëpunimit të ngushtë me operatorët audiovizivë në treg dhe me të gjithë palët e tjera të interesuara.

Bashkëpunimi ka qenë në nivel të lartë dhe nivel teknik, në kuadër të diskutimit të çështjeve të ndryshme dhe gjetjes së zgjidhjeve eficiente për ecurinë e procesit. Në sajë të aktiviteteve të ndërmarra u mundësua mbyllja e transmetimeve analoge në qarqet Berat dhe Korçë, si dhe vijimi i procesit në qarkun e Fierit.

Ndërkohë, transmetimet numerike ofrohen nga operatori publik shqiptar (RTSH) edhe në qarqe të tjera të vendit, si në Tiranë, Durrës, Lezhë, Kukës dhe Dibër, dhe nga operatorët privatë kombëtarë numerikë në qarqet Tiranë, Durrës, Shkodër, Lezhë, Vlorë dhe Elbasan.

Në qarqet Berat dhe Korçë, ku tashmë janë mbyllur transmetimet analoge, ofrojnë programet e tyre edhe operatorët lokalë/rajonalë ekzistues vendorë, të cilët kanë mbështetur programet e tyre në njërin nga rrjetet kombëtare numerike.

Implementimi i procesit të digjitalizimit do të jetë në fokus edhe për vitin 2018, duke vijuar me mbylljen e transmetimeve analoge në qarqet Fier, Tiranë, Durrës, Shkodër, Elbasan e më pas në të gjithë Shqipërinë.

Lirimi i brezit DD1

Lirimi i brezit 790-862 MHz (brezi DD1) është një tjetër proces i rëndësishëm i ndjekur gjatë vitit 2017.

Gjatë vitit 2016, në adresë të AMA-s janë paraqitur ankesa të përsëritura nga vendet fqinje si Itali, Mali i Zi dhe Maqedoni lidhur me interferencat e dëmshme që shkaktonin operatorët tanë audiovizivë (të cilët kishin në përdorim frekuenca të brezit DD1) drejt stacioneve të tyre mobile. Për administrimin e problemit të interferencave dhe lirim të plotë të brezit DD1, gjatë vitit 2017 janë kryer studime dhe planifikime për migrimin e operatorëve audiovizivë nga frekuencat e këtij brezi në frekuenca të tjera, duke siguruar në këtë mënyrë edhe vijimësinë e transmetimeve audiovizive nga këta operatorë.

Në muajin mars 2017, AMA ka njoftuar të gjithë operatorët audiovizivë (analogë dhe numerikë), të cilët kishin në përdorim kanalet frekuencore të brezit DD1 për ofrimin e transmetimeve audiovizive, që të lirojnë këto kanale dhe të migrojnë në kanalet e përcaktuara nga AMA. Brezi DD1 zihet në 48 pika transmetimi nga 15 operatorë audiovizivë analogë dhe 1 operator numerik. Korrespondencat kanë vijuar edhe më pas, si dhe janë zhvilluar takime të përsëritura me operatorët lokalë/rajonale/kombëtarë. Falë këtij koordinimi u bë i mundur lirimi i frekuencave që kishin në përdorim operatorët për transmetimet analoge dhe numerike.

AMA ka monitoruar në terren përdorimin e brezit 790-862 MHz nga operatorët audiovizivë. Nga monitorimet e kryera në dhjetor 2017 rezultoi se kanalet frekuencore të këtij brezi janë liruar nga 15 operatorë në 45 pika transmetimi. Po gjatë këtij muaji ka vijuar puna për lirim të tre pikave të mbetura të transmetimit.

Në këtë mënyrë u shmangën përfundimisht interferencat e dëmshme që shkaktonin transmetimet audiovizive shqiptare drejt vendeve fqinjë dhe njëkohësisht iu hap rruga përdorimit të këtij brezi për shërbimet mobile (LTE) edhe në vendin tonë.

Me rëndësi gjatë vitit 2017 ka qenë edhe shmangia e interferencave të shkaktuara nga operatorët audiovizivë të Maqedonisë drejt vendit tonë, të cilët përdornin frekuenca jashtë planit GE06, të akorduara për operatorët tanë audiovizivë që transmetojnë në qarkun e Korçës. Pas korrespondencave dhe bashkëpunimit të ngushtë me homologët maqedonas u mundësua shmangia e interferencave dhe mbyllja brenda afatit i transmetimeve analoge në qarkun e Korçës.

Planifikimi i frekuencave për shërbimet audio

Në kuadër të planifikimit të frekuencave për shërbimet audio (brezi 87.5 - 108 MHz) vlej të theksuar studimet e kryera për licencimin e dy radiove kombëtare, njëri për operatorin publik shqiptar (RTSH) dhe tjetri për çdo subjekt privat të interesuar. Shqipëria ka pasur dy radio kombëtare në transmetim dhe tashmë numri do të shkojë në katër, numër që është në përputhje edhe me vendet e tjera të rajonit.

Në AMA janë paraqitur kërkesa për licencim apo zgjerim të zonës së shërbimit. Në përmbushje të këtyre kërkesave janë kryer studime teknike për një planifikim sa më efektiv të spektrit nga njëra anë dhe, nga ana tjetër, në përmbushje të detyrimeve mbi mbulimin

me sinjal të zonës së shërbimit, transmetimin me cilësi sipas standardeve ndërkombëtare, si dhe shmangien e interferencave të mundshme.

Përveç, përmbushjes së kërkesave të të interesuarve, AMA është në proces studimi për dhënien në përdorim të frekuencave në zonat e bardha, ku aktualisht nuk ka asnjë operator audio, siç janë bashkitë Peshkopi, Mat, Bulqizë, Kukës, Tropojë, Mirditë, Përmet dhe Tepelenë. Qëllimi është nxitja e subjekteve private për ofrimin e këtij shërbimi, në mënyrë që banorët e këtyre zonave, përveç informacionit/programacionit të përfituar nga transmetimet audiovizive, të mund të përfitojnë programacion edhe nga transmetimet audio.

Digjitalizimi i rrjeteve kabllore

Gjatë vitit 2017 vlen të përmendet roli në rritje i rregullatorit për implementimin e sistemeve digjitale në të gjitha shërbimet audio/audiovizive. AMA, me vendimin nr. 182, datë 6.9.2016, ndërmori hapin për kalimin e plotë në teknologjinë digjitale të transmetimeve audiovizive mbështetur në rrjetin kabllor, nisur nga përfitimet e publikut shqiptar për cilësinë e transmetimit dhe gamën e gjerë të shërbimeve që ofron kjo teknologji.

Në kuadër të përfshirjes së teknologjive të reja në transmetimet audiovizive, gjatë viteve 2015-2016-2017 vihet re një tkurrje e numrit të ofruesve të shërbimit audioviziv, mbështetur në rrjetet kabllore, dhe shtim i numrit të subjekteve që ofrojnë shërbimet e bazuara në teknologjitë e reja, që mbështeten në internet, si IPTV, OTT, Internet TV.

VEPRIMTARIA MBIKEQYRESE

Në kuadër të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për periudhën 2017-2019, AMA, gjatë vitit 2017 ka pasur në fokus të saj monitorimin dhe ecurinë e procesit të digjitalizimit, të lirim të brezit DD1, migrimit të transmetimeve të licencuara nga ky brez në frekuenca të tjera dhe mbylljen e të gjitha transmetimeve të palicencuara prej tij.

Në kuadër të transmetimeve numerike duhet theksuar se, pavarësisht fillimit të transmetimeve numerike dhe mbylljes me sukses të operatorëve analogë në allotmentet (qarqet) Berat dhe Korçë, disa zona të këtyre allotmenteve nuk mbulohen me sinjal nga operatorët kombëtarë të licencuar, në mënyrë të veçantë nga ana e RTSH-së, si i vetmi operator publik që ka në shfrytëzim dy rrjete numerike.

Më konkretisht, nga operatori publik RTSH nuk mbulohen me sinjal numerik zonat:

1. Allotmenti Berat:
 - Njësia administrative Sinje;
 - Tre lagjet pas Kalasë.
2. Allotmenti Korçë:
 - Voskopojë;

- Dardhë;
- Çërravë;
- Mokër;
- Aksi rrugor Korçë - Bilisht (Plasë, Kuç i Zi, rrëzë malit Moravë).

AMA i ka bërë me dije RTSH-së që të marrë masat përkatëse me qëllim mbulimin me sinjal edhe të këtyre zonave.

Përveç sa më sipër, nga ana e RTSH-së nuk bëhet mbulimi me sinjal, as numerik dhe as analog, dhe nuk ofrohen shërbime audiovizive as në zonat si më poshtë:

1. Bashkitë:

- Himarë
- Memaliaj
- Bulqizë
- Klos
- Divjakë
- Gramsh
- Konispol
- Selenicë
- Këlcyrë
- Librazhd
- Vau i Dejës

2. Njësitë administrative dhe fshatrat:

- Rrëshen
- Qukës
- Dhërmi
- Qeparo
- Borsh
- Lukovë
- Maqellarë
- Lekbibaj
- Fierzë
- Pogë
- Razëm

Edhe në lidhje me këtë, AMA i ka kërkuar RTSH-së të mundësojë menjëherë sinjalin në të gjitha këto zona, në mënyrë të veçantë në zonat ku nuk ka fare sinjal të operatorit publik.

Në fokus të Autoritetit përbën emergjencë sigurimi i të drejtës kushtetuese për informim, ndërkohë që shërbimi audioviziv i operatorit publik mundësohet kryesisht nga pagesat e qytetarëve nëpërmjet tarifës përkatëse. AMA është duke ndjekur me shumë vëmendje zgjidhjen e kësaj problematike.

Në vitin 2017 AMA liroi përfundimisht brezin frekuencor nga transmetimet e paligjshme audio, në mënyrë që spektri i frekuencave të shfrytëzohet vetëm nga subjektet e licencuar. Për rrjedhojë, gjatë kësaj periudhe është bërë ndalimi i funksionimit të pajisjeve

transmetuese të të gjithë subjekteve radio, që ushtronin aktivitet të kundërligjshëm në territorin e vendit, duke mundësuar kështu që brezi i frekuencave audio të shfrytëzohet vetëm nga subjektet e licencuar, sipas përcaktimeve ligjore.

Vetëm gjatë këtij viti u konstatuan:

- 3 subjekte radio që transmetonin pa licencë;
- 5 subjekte që transmetonin në kushtet kur AMA kishte vendosur me vendim heqjen e licencës së tyre;
- 4 subjekte që zinin në mënyrë të jashtëligjshme 10 frekuenca, si rrjedhojë e zgjerimit të zonës së shërbimit pa autorizimin e AMA-s.

Të gjithë subjekteve në fjalë u është bërë ndërprerja e menjëhershme e transmetimeve, duke mundësuar kështu lirin e frekuencave të zëna.

Gjatë periudhës së raportimit, AMA është fokusuar edhe tek dukuria e piraterisë televizive. Përveç ushtrimit të kompetencave kryesisht, AMA ka ndjekur me prioritet të gjitha ankesa, duke kryer inspektimet në terren apo monitorimet rast pas rasti.

Gjatë vitit 2017, AMA ka qenë më aktive në ushtrimin e detyrave të inspektimit, duke inspektuar dhe/ose monitoruar të gjithë subjektet audiovizive. Në mënyrë të veçantë, AMA ka monitoruar dhe mbajtur nën mbikëqyrje respektimin e drejtave të transmetimit të veprave kinematografike.

Nga ana tjetër, konstatohet ulje në raportin e gjobave të vendosura nga grupet e inspektimit dhe atyre të shfuqizuara, pas ankimit të subjekteve. Pothuajse i njëjtë ka qenë numri i subjekteve të konstatuar se ushtronin aktivitet të paligjshëm, pajisjet e të cilave janë sekuestruar.

Si rrjedhojë e kërkesave konstante të AMA-s ka një përmirësim të theksuar në lidhje me respektimin e të drejtave të transmetimit, në mënyrë të veçantë të atyre kinematografike. Subjektet audiovizive janë ndërgjegjësuar për respektimin e përcaktimeve ligjore dhe kanë filluar të kufizohen në transmetimin e veprave kinematografike shqiptare, ose atyre të huaja, për të cilat kanë një marrëveshje për respektimin e të drejtave të transmetimit dhe/ose të autorit.

Në mënyrë të veçantë, në lidhje me respektimin e të drejtave të autorit, AMA vazhdimisht ka pasur një qasje të njëjtë ndaj të gjitha agjencive apo subjekteve të tjerë që përfaqësojnë dhe mbrojnë të drejta autorësh në vend. Për këtë, Autoriteti ka zhvilluar takime me përfaqësues të të gjithë palëve që operojnë në fushën e mediave audiovizive, për ndërgjegjësimin dhe përcaktimet ligjore për respektimin e të drejtave të transmetimit dhe atyre të autorit.

Një prej shqetësimeve të vazhdueshme të AMA-s ndaj agjencive kolektive të mbrojtjes së të drejtave të autorit ka qenë mungesa e transparencës së tyre kundrejt subjekteve OSHMA dhe vetë AMA-s. Së pari, në informimin e OSHMA-ve për veprat që mbrohen nga këto agjenci. Së dyti, në mënyrën e mbledhjes së tarifave (që kërkohet të shlyhet në formë

aforfeje që në fillim të vitit) apo mungesa e plotë e transparencës në shpërndarjen e të ardhurave. Keto çështje kanë qenë dy prej problemeve më të mëdha, e që ishin edhe objekt diskutimi në takimin e nëntë të Nënkomitetit “Tregu i Brendshëm dhe Konkurrenca, duke përfshirë Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Shëndetit”, mbajtur në Bruksel, më 17 tetor 2017. Në këtë takim, shtetit shqiptar iu theksua pikërisht fakti se nga këto agjenci nuk ishte shpërndarë asnjë honorar për autorët, pavarësisht se subjektet OSHMA kishin paguar rregullisht tarifën e vendosura njëanshmërisht dhe pa asnjë kriter nga agjencitë.

Përkundrazi, jo vetëm që nuk është treguar transparencë nga agjencitë, por pas çdo takimi që AMA kryente me palët e interesuara, Zyra Shqiptare të të Drejtave të Autorit (ende funksionale gjatë vitit të kaluar), ndërmerre fushata ndëshkimi kolektive ndaj subjekteve OSHMA, që ankoheshin për metodat dhe mungesën e transparencës së agjencive në fjalë. Këto masa kanë rezultuar tepër të ashpra, saqë të gjitha vendimet për dënimin me gobë janë plotësuar direkt nga zyra e ZSHDA-së në të njëjtën datë.

Tani, me ndryshimin e legjislacionit për të Drejtat e Autorit, si dhe me riorganizimin e Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit, AMA shpreson për një bashkëpunim më të mirë midis kësaj zyre dhe OSHMA-ve.

DREJTORIA JURIDIKE

Në këndvështrimin e vendimmarrjeve, AMA ka ushtruar veprimtarinë kolegjiale si një trup i plotësuar me të gjithë anëtarët e tij, duke përmblusur në këtë mënyrë plotësisht objektivat e parashikuara në ligjin e posaçëm, çka reflektohet në vendimet e miratuara prej saj që kërkojnë shumicë të cilësuar.

AMA ka plotësuar kuadrin nënligjor përmes miratimit të akteve përkatëse, të cilat kanë ndikim të ndjeshëm në veprimtarinë e mediave audiovizive. Në zbatim të përcaktimeve të legjislacionit organik, dhe në funksion të transparencës institucionale, por edhe të nevojës për marrjen e mendimeve, propozimeve dhe komenteve të grupeve të interesit, hartimi i kuadrit nënligjor është shoqëruar me kryerjen e një procesi të gjerë konsultimi dhe këshillimi publik, duke u bërë objekt diskutimi me palët e interesuara.

Gjatë vitit 2017 janë miratuar aktet e mëposhtme nënligjore:

- Rregullore “Për procedurat dhe kriteret e dhënies së autorizimeve”;
- Rregullore “Për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës lokale të transmetimit audioviziv në periudhën tranzitore”;
- Rregullore “Mbi procedurat e inspektimit të veprimtarisë audiovizive të ofruesve të shërbimit mediatik audio dhe/ose audioviziv”;
- Rregullore “Për procedurat për trajtimin e ankesave dhe për ushtrimin e të drejtës së përgjigjes”;
- “Kodi i Transmetimit për median audiovizive”;
- Ndryshime në rregulloren “Për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës së transmetimit audio”;

- Ndryshime në rregulloren “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për renditjen e shërbimeve audio dhe/ose audiovizive që mbështeten në rrjete numerike”;
- “Pagesat për licencë/autorizim dhe shërbimet që kryhen nga Autoriteti i Mediave Audiovizive”.

Miratimi dhe hyrja në fuqi e akteve të mësipërme i ka shërbyer zbatimit efektiv të kërkesave të ligjit organik për përmbushjen e objektivave të autoritetit rregullator për sigurimin e shumëllojshmërisë dhe cilësisë së lartë të programeve nga OSHMA-të publike e private; përmbushjen e objektivave nga transmetuesit e shërbimit publik, sipas përcaktimeve të këtij ligji, si dhe rritjen e shumëllojshmërisë së shërbimeve audiovizive.

Po ashtu, disa nga aktet nënligjore të miratuara kanë në fokus zgjidhjen e aspekteve lidhur me procesin e kalimit në transmetimet numerike dhe, përmes rregullimeve synojnë zbatimin e procedurave lehtësuese për subjektet audio/audiovizive në këtë proces.

Rregullorja për dhënien e licencave në periudhë tranzitore i ka hapur rrugë procesit të kalimit në transmetimet numerike të subjekteve audiovizivë ekzistues, kategori subjektësh që preken drejtpërdrejt nga procesi imbylljes së transmetimeve analoge.

Duke patur në fokus veprimtaritë lidhur me procesin e kalimit në transmetimet numerike, ku rëndësi të veçantë merr edhe renditja e programeve të operatorëve kombëtarë numerikë (publik dhe privat) dhe operatorëve lokalë/rajonale që mbështesin programet e tyre në këto rrjete, në mënyrë që publiku të orientohet lehtësisht në shërbimet e reja digjitale, AMA ka amenduar rregulloren për renditjen e shërbimeve të programeve audiovizive që mbështeten në rrjete numerike. Në zbatim të rregullores janë përcaktuar në vijim edhe Numrat Logjikë të Programit (NLP), identifikues për të gjithë ofruesit e shërbimit të programit audioviziv.

Ndryshimi më i rëndësishëm në kuadrin nënligjor për dhënien e autorizimeve lidhet me ndryshimin e teknologjisë së aplikuar prej subjekteve kabllorë, duke e zëvendësuar teknologjinë analoge me atë numerike, pasi përfitimet që sjellin këto teknologji janë të ndjeshme për konsumatorin, për sipërmarrësit dhe për rritjen ekonomike të vendit.

Në respektim të nenit 5 të ligjit organik që sanksionon parimin e lirisë së marrjes dhe të ritransmetimit nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian dhe të shteteve të treta evropiane, AMA ka ndryshuar rregulloren për procedurat e dhënies së licencës së transmetimit audio, duke i hapur rrugë procesit të rilicencimit të subjekteve audio dhe audiovizivë që ritransmetojnë shërbime të programeve audio dhe audioviziv të shteteve të tjera.

Akte të tjera që kanë plotësuar kuadrin rregullues të veprimtarisë së subjekteve audio dhe/ose audiovizive janë Kodi i Transmetimit si dhe rregullorja për ushtrimin e së drejtës së përgjigjes.

AMA, referuar përcaktimit ligjor me vendimin nr. 18, datë 02.03.2017, ka miratuar kontratën e shërbimit të transmetimit publik, akt i cili normon veprimtarinë e RTSH-së në aspektet programore dhe teknike. Ky akt është amenduar me vendimin e AMA-s nr. 82, datë 29.05.2017, duke i dhënë RTSH-së të drejtën e ofrimit të një shërbimi audio kombëtar pa

pagesë, "Radio Tirana Klasik".

Përgjatë periudhës raportuese, në zbatim të detyrimit të parashikuar në ligjin nr. 97/2013, të ndryshuar, Autoriteti ka përfunduar procesin e lëshimit të licencave për shërbimin audio të komunitetit, shërbim që synon promovimin e nevojave të komuniteteve të caktuara.


Për të garantuar përmbushjen e objektivave ligjorë dhe në përputhje me planin e miratuar të veprimit të autoritetit, AMA do të vijojë procesin e plotësimit të mëtejshëm të kuadrit ligjor përmes draftimit dhe miratimit të akteve nënligjore, duke synuar zhvillim të qëndrueshëm për ofruesit e shërbimit medatik audioviziv.

Rast pas rasti, aktet administrative të miratuara nga Autoriteti janë bërë objekt i hetimit dhe shqyrtimit gjyqësor, kryesisht pranë gjykatave të shkallës së parë. Pas përfundimit të gjykimit në shkallë të parë të 64 proceseve gjyqësore me palë ndërgjygjëse AMA-n, 51 çështje kanë përfunduar në favor të AMA-s, duke u gjetur e drejtë dhe mbështetur në ligj vendimmarrja e Autoritetit.

Edhe gjatë vitit 2017, referuar rregullimit ligjor për ekzekutimin e titujve ekzekutivë, AMA ka vijuar ndjekjen e procedurave për lëshimin e urdhrave të ekzekutimit ndaj sanksioneve gjobë, dhe më tej lidhjen e kontratave të shërbimit me përmbarues privatë për vjeljen e tyre. Ekzekutimi i vendimeve të AMA-s konsiderohet si element që ndikon në rritjen e autoritetit. Krahasuar me vitin 2016, në të cilin janë lidhur kontrata shërbimi për ekzekutimin e 16 titujve ekzekutivë (nga të cilët janë ekzekutuar plotësisht dhe tërësisht 6 tituj), gjatë vitit 2017 janë lidhur kontrata për ekzekutimin e 51 titujve ekzekutivë (nga të cilët janë ekzekutuar plotësisht dhe tërësisht 26 tituj).

lekë

Vitet	Të ardhura nga sanksione gjobë
2014	928,668
2015	5,430,724
2016	4,084,791
2017	11,325,738



DREJTORIA BNJMJ

AKTIVITETE TE AUTORITETIT

Edhe për vitin 2017 Autoriteti i Mediave Audiovizive ka vazhduar aktivitetet e tij me grupet e interesit në lidhje me çështje të rëndësishme të medias audiovizive.

BOTIMET E AUTORITETIT

Autoriteti publikoi në muajin maj 2017 Buletinin Periodik nr. 1 me të dhëna nga dinamika e tregut audioviziv në Republikën e Shqipërisë për periudhën janar-qershor 2016, dhe në muajin dhjetor 2017 botoi Buletinin nr. 2 me të dhëna të tregut audioviziv, për periudhën qershor-dhjetor 2016.

Buletini nr. 1 dhe nr. 2 janë përmbledhje e treguesve mbi sektorin e mediave audiovizive. Ato rrisin transparencën e aktivitetit audioviziv dhe tregojnë më qartë ndikimin në treg dhe tek konsumatorët e mediave audiovizive.

Për të prezantuar këto botime u organizuan dy takime: “Transparenca e aktivitetit audioviziv, ndikimi në treg dhe tek konsumatori” dhe “Misioni dhe funksioni i një Buletini Periodik-vështrim në dinamikën e treguesve të Edicionit të Parë”. Të ftuar në dy aktivitetet ishin nga fusha e Shërbimeve Shtetërore të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, INSTAT, Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit në Universitetin e Tiranës, Institutit Shqiptar të Medias në Tiranë, përfaqësues nga sektori privat.

Në muajin dhjetor 2017 u botua edhe Buletini i tretë i Këshillit të Ankesave. Me qëllim prezantimin e Buletinit u zhvillua një tryezë diskutimi mbi sfidat dhe shqetësimet për rritjen e cilësisë në përmbajtjen e prodhimeve audiovizive. Në tryezë morën pjesë aktorë të ndryshëm nga Komisioni i Medias, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe e Rinisë, Ministria e

Arsimit, Instituti Shqiptar i Medias, Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit në Universitetin e Tiranës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Agjencia për Mbrojtjen e Fëmijëve, studentë të gazetarisë, partnerë ndërkombëtarë etj.

Botimet periodike të AMA-s gjenden në versionin e tyre online edhe në faqen zyrtare të AMA-s, www.ama.gov.al.

PUBLIKOHET LIBRI “LAJMI NË MEDIA”

AMA mbështeti dhe mundësoi botimin e librit “Lajmi në media” të autorëve Hamit Boriçi dhe Sami Neza. Ky libër me vlerë në fushën e gazetarisë dhe komunikimit vjen prej autorëve të mirënjohur në fushën e gazetarisë dhe kërkimit në media. Ky libër i drejtohet një audience që është e lidhur me produktet e gazetarisë në Shqipëri me synimin rritjen e cilësisë së transmetimit dhe publikimit të lajmeve. Libri erdhi si një nevojë e domosdoshme për të përqasur metoda dhe përvoja të gazetarisë perëndimore me terrenin shqiptar.

PUBLIKOHET LIBRI “TIPET E LIGJËRIMIT”

AMA mbështeti dhe mundësoi botimin e librit “Tipe të ligjërimit” të autorit Hysamendin Feraj. Libri është një raport në mediat audiovizive dhe rezultat i përgjigjes ndaj një kërkese të shpalluar nga AMA për hulumtimin e tipeve të ligjërimit në emisionet e formatit debatues/forum në mediat audiovizive.

Hulumtimi u bazua në shikimin/dëgjimin e rreth 300 orë (289.9) orë, 37 ditë pune të emisioneve të tillë, të transmetuar nga mediat audiovizive kombëtare dhe lokale, në periudhën kohore 1 mars -31 maj 2016.

PUBLIKOHET STUDIMI “MEDIA NË PRIZMIN E TË RINJVE”

Studimi u realizua nga Instituti Shqiptar i Medias dhe analizon marrëdhëniet që kanë të rinjtë e kryeqytetit me median tradicionale dhe se cilat janë prirjet apo qasjet ndaj medias në kontekstin e sotëm teknologjik. Studimi është një projekt i mundësuar me mbështetjen financiare të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

PUBLIKOHET NR 2 I REVISTËS PERIODIKE TË AMA-S

Gjatë vitit 2017 u publikua Revista e AMA-s nr. 2, Newsletter. Revista është një periodik, ku synohet të publikohen aktivitetet kryesore të Autoritetit dhe gjithashtu fokusohet edhe në problematika të medias audiovizive. Në muajin shkurt 2018 u publikua edhe numri i tretë i kësaj reviste, ku në fokus janë marrëdhëniet e punës së gazetarëve.

Dita ndërkombëtare e shtypit

Më 3 maj 2017, në Ditën Ndërkombëtare të Shtypit, në kuadër të angazhimit të përbashkët institucional, Autoriteti i Mediave Audiovizive organizoi një pritje për të gjithë aktorët që ndikojnë në fushën e medias pranë zyrave të reja të institucionit.

Në këtë aktivitet ishin pjesëmarrës drejtues të mediave shqiptare, përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare me seli në Tiranë, si dhe aktorë të tjerë, të cilët kanë rol thelbësor në përmbushjen dhe bashkërendimin e forcave për rregullimin e tregut mediatik.

Konferenca “Fake news dhe sfida për të vërtetën në media”

Këshilli i Ankesave, në përmbushje të objektivave që rrjedhin nga ligji nr. 97/2013 dhe Kodi i Transmetimit”, por edhe rregulloreve të tjera të nxjerra nga AMA, organizoi në muajin tetor 2017 konferencën me temë: “Fake news dhe sfida për të vërtetën në media”.

MARRËVESHJET E BASHKËPUNIMIT

Autoriteti i Mediave Audiovizive ka ndërmarrë disa iniciativa për të rritur bashkëpunimin mes institucioneve të tjera shtetërore, si Autoriteti i Konkurrencës, Ministria e Kulturës (Drejtoria e të Drejtave të Autorit), Komisioni për Mbrojtjen e Konsumatorëve, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Ministria e Brendshme, Prokuroria e Përgjithshme, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave.

Iniciativa për lidhjen e një marrëveshjeje bashkëpunimi midis institucioneve tona vjen gjithashtu në vijim të kërkesës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, mbi krijimin e hapësirave dhe thellimin e formave të bashkëpunimit midis organeve të krijuara me ligj, sikurse janë institucionet tona.

Mbështetur në sa më sipër, si dhe duke konsideruar se bashkëpunimi dhe koordinimi i veprimtarisë mes AMA-s dhe këtyre institucioneve do të përmirësojë standardet dhe kushtet për një treg audioviziv të lirë dhe efektiv në përputhje me standardet evropiane, AMA, brenda periudhës raportuese ka propozuar nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit mes saj dhe institucioneve të lartpërmendura, duke përgatitur draft marrëveshje, objekt i të cilave është përcaktimi i fushave dhe formave të bashkëpunimit për vendosjen dhe garantimin e zbatimit të ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

TRAJNIME DHE ZHVILLIME

Bashkëpunimi me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, ka vijuar edhe përgjatë vitit raportues, ku në total, nga AMA janë trajnuar 11 nëpunës civil. Llojet e trajnimeve që këta nëpunës kanë ndjekur pranë ASPA-s kanë qenë:

Trajnimi i thelluar, ku janë trajnuar 10 nëpunës. Nëpërmjet këtij trajnimi nëpunësit janë njohur me parimet themelore, mënyrën e organizimit të administratës, kuadrin ligjor, menaxhimin sa më të mirë të burimeve për arritjen e objektivave, duke u fokusuar në:

- Parimet kushtetuese si bazë e veprimitarisë së administratës publike për respektimin e të drejtave të njeriut;
- Transparenca dhe efikasiteti në arritjen e objektivave dhe zbatimin e legjislacionit;
- Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e nëpunësit të administratës shtetërore;
- Sjellja, integriteti dhe lufta kundër korrupsionit;
- Menaxhimi me efencë i burimeve njerëzore dhe financiare;
- Procesi i integritetit evropian, detyrat dhe sfidat kryesore.

Formë trajnimi e ofruar ka qenë dhe rasti për përshtatje profesionale me vendin e punës, duke i ofruar njësisë së burimeve njerëzore njohuri të përgjithshme në lidhje me:

- Sistemin e menaxhimit të regjistrimit të punonjësve të Administratës Publike – moduli “Struktura”
- Projektin e Binjakëzimit “Mbështetja në Reformën e Shërbimit Civil në Shqipëri”, trajnimi me temë: Etika, vlerat dhe disiplina në administratën publike.

Gjithashtu, Autoriteti i Mediave Audiovizive është nga institucionet e para që është zotuar të promovojë politikën mjedisore dhe të mbështesë praktikën ambientaliste. Për herë të parë, në bashkëpunim me znj. Kristina Glasser, eksperte pranë “Creative Business Solution” (CBS), AMA ka trajnuar 50 nëpunës mbi “Eficencën e Energjisë dhe adoptimi i një plan veprimi për përmirësimin e saj”. Ky trajnim, i pari në llojin e tij, solli informimin dhe ndërgjegjësimin e gjithë stafit mbi ekonomizimin e energjisë elektrike dhe ruajtjen e resurseve natyrore.

Në vijim të trajnimeve për stafin, u realizua bashkëpunimi me një prej eksperteve ndërkombëtare me përvojë shumëvjeçare në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore, znj. Michele Barley, nën asistencën e së cilës u realizuan dy trajnime:

- Trajnim për 40 nëpunës civilë me temë: “Rritja e efektivitetit në realizimin e objektivave dhe roli e përgjegjësisë së çdo nëpunësi civil”. Trajnimi, nëpërmjet metodologjisë së përzgjedhur, bëri të mundur një komunikim interaktiv me çdo nëpunës pjesëmarrës, duke krijuar në këtë mënyrë një formë të ndryshme dhe së tepërmi efektive të përcimit të informacionit, ideve, koncepteve mbi menaxhimin dhe orientimin e burimeve njerëzore.
- Trajnim në stad të avancuar për nivelin drejtues të njësive organizative me temë: “Menaxhimi i personelit/performancës individuale” me pjesëmarrjen e 10 nëpunësve civil të nivelit drejtues, duke u mundësuar forcimin e kapacitetit të tyre menaxhues dhe promovimin e zhvillimit të tyre profesional, me qëllim marrjen e përvojës sipas fushave të përgjegjësisë dhe të drejtave specifike që mbulojnë.

Gjatë vitit 2017, në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional që AMA ka me organizata e institucione që punojnë në fushën e medias, u vlerësua qasja për partneritet me Këshillin e Evropës në kuadër të projektit të përbashkët BE–KiE “Rritja e Efektivitetit të Sistemit Shqiptar të Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut dhe Anti-diskriminimit”, ku u bë i mundur trajnimi i 20 nëpunësve të stafit të AMA-s. Roli i AMA-s në monitorimin e programeve të transmetuara nga ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv dhe sanksionimin e praktikave diskriminuese ishte një çështje që mori hapësirë gjatë trajnimit.

Në kuadrin e përgjithshëm të programeve të trajnimit një formë tjetër trajnimi ka qenë pjesëmarrja e një nëpunësi të AMA-s në trajnimet e zhvilluara nga Shkolla Ligjore e Leidenit, Komiteti Holandez i Helsinkit (NHC) dhe Akademia e Hagës për Qeverisjen Vendore (THA), ku çdo pjesëmarrësi i është dhënë mundësia për t’u njohur me praktikat më të mira, në fushën e medias dhe jo vetëm.


FINANCË

Autoriteti i Mediave Audiovizive, si një institucion me vetëfinancim, krijon dhe siguron me burimet e veta financiare përmbushjen e funksioneve të tij. Në këtë prizëm, përmirësimi i treguesve financiarë të veprimtarisë së Autoritetit, si dhe rritja e efektivitetit të shfrytëzimit të këtyre burimeve ka qenë një ndër objektivat kryesore të realizuara gjatë vitit 2017.

Me burimet e veta të financimit, AMA ndërmori investime dhe shpenzime të rëndësishme për përmbushjen e funksioneve dhe kryerjen e aktivitetit të saj në kushte të përshtatshme. Me gjithë rritjen e arkëtueshmërisë së të ardhurave gjatë vitit 2017, AMA pati një buxhet të pamjaftueshëm për të kryer investime dhe shpenzime që përmbushin tërësisht objektivat e Strategjisë dhe Planit të saj të Veprimit 2015-2017.

Realizueshmëria e objektivave vjetore të AMA-s është përqëndruar në:

- Rritjen e arkëtueshmërisë së të ardhurave, përmes rritjes së shlyerjes së detyrimeve financiare të viteve të mëparshme dhe të vitit 2017;



- Përbushja e një prej objektivave të strategjisë së AMA-s dhe planit të veprimit të saj 3-vjeçar.

Bazuar në ligjin 97/2013, i ndryshuar, Strategjinë dhe Planin e Veprimit për vitet 2017-2019, u miratua Vendimi nr.220, datë datë 01.12.2017 “Mbi përcaktimin e pagesave për licencë/ autorizim dhe shërbimet që kryhen nga Autoriteti i Mediave Audiovizive”. Me këtë vendim u arrit përbledhja në një akt të vetëm administrativ të të tërë llojeve dhe masave të pagesave për t’u zbatuar nga AMA. Në të u reflektuan nevojat e AMA-s për rritje të nivelit të vetëfinancimit për të mbuluar shpenzimet e nevojshme të institucionit; rishikimi i masave të pagesave për OSHMA-të sipas ndarjes së re administrative dhe nivelin e inflacionit; masat e pagesave për shërbime të reja audio/audiovizive, që ofrohen për shkak të zhvillimeve në fushën teknologjike.

- Rritje e depozitimit të bilanceve për vitin 2016 të OSHMA-ve

Në zbatim të ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar, në vitin 2017 pati një rritje të konsiderueshme të depozitimit të bilanceve të vitit 2016 nga OSHMA-të.

Masat shtrënguese në vitin 2017, përmes sanksionimit me gjobë të OSHMA-ve që nuk paraqitën bilancet për vitin 2015, reflektoi në rritjen e depozitimit të tyre për vitin 2016.

Godina e re e institucionit

Bazuar në VKM-në nr. 468, datë 03.06.2015 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi, Radio Televizioni Shqiptar tek Autoriteti i Mediave Audiovizive, të katit përdhes, katit të parë dhe të dytë të godinës me emërtimin “Atelier për Dekorin e Radio-Televizionit”, dhe investimit të ndërmarrë totalisht me financime të AMA-s, prej muajit prill 2017 institucioni ushtron aktivitetin e tij në një godinë të re me kushte funksionale dhe bashkëkohore.

Godina është ndërtuar sipas të gjitha standardeve të konstruksionit dhe implementimit të instrumentëve të sigurisë së aksesit fizik dhe atij logjik. Përveçse është siguruar akomodimi i të gjithë stafit në hapësira të dedikuara, sipas strukturës organizative, një problematikë e pazgjidhur prej vitesh në godinën e mëparshme, godina e re përban mjedise për zhvillimin e konferencave, aktivitetëve të ndryshme, akomodimin e grupeve të auditit, përfaqësive ose vizitorëve të ndryshëm.

Janë instaluar të gjithë instrumentët për sigurinë fizike dhe për parandalimin ose dedektimin e faktorëve të rrezikshëm si zjarri, uji etj.

Godina përmban mjedise të dedikuara për vendosjen e infrastrukturës informatike komunikuese dhe përpunuese të të dhënave, si dhe për pajisjet teknike të studios së monitorimit.

2. STRATEGJIA AUTORITETIT

Autoriteti i Mediave Audiovizive, gjatë vitit 2017 është përpjekur të realizojë angazhimet dhe objektivat kryesorë që lidhen me ecurinë e institucionit, si dhe zbatimin e kuadrit ligjor. AMA, me vendimin nr. 28, datë 29.03.2017 ka miratuar “Strategjinë e Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe Planit të Veprimit”, në të cilën janë parashikuar qëllimet kryesore dhe aktivitetet në përmbushje të objektivave të AMA-s. Plani i veprimit parashikon aktivitetet që duhet të ndërmarrë AMA për periudhën 2017-2019.

Gjatë vitit 2017, duke mbajtur në konsideratë edhe rekomandimet e rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, ka ndjekur me prioritet zbatimin e Planit të Veprimit përmes:

- Draftimit dhe ndjekjes së procedurave ligjore deri në miratimin e akteve rregullatore cituara në brendësi të këtij Raporti vjetor.
- Miratimit të kontratës së shërbimit të transmetimit publik, me vendimin nr. 18, datë 02.03.2017 të AMA-s si dhe shtojcës së saj.

Në kuadër të sigurimit të diversitetit dhe pluralizmit, si dhe promovimin e transmetimit të ndërgjegjshëm në drejtim të përmirësimit të përmbajtjeve audio dhe audiovizive:

- përmirësimi legjislativ (Kodi i Transmetimit të AMA-s, rregullorja e reklamave dhe komunikimeve tregtare);
- shqyrtimet tematike për probleme sensitive të përmbajtjeve të emetuara (mbrojtja e të miturve, reklamat, gjuha e urrejtjes dhe diskriminimi etj.);
- organizimi i forumeve me OSHMA-te për tema të caktuara (zbatimi i Kodit të Transmetimit, reklamat dhe komunikimet tregtare);
- bashkëpunimi me partnerët për trajnime me gazetarët dhe studime të situatës së tregut (etika në transmetimet audiovizive, barazia gjinore, mbrojtja e të miturve, gazetarët në kushtet e transmetimit digjital);
- Ka vijuar publikimi i Buletinit Periodik të AMA-s, një fluks të dhënash nga performanca e OSHMA-ve. Mbledhja, administrimi dhe publikimi i informacionit për sektorin e mediave audiovizive në Republikën e Shqipërisë, si një nga funksionet kryesore që i atribuohen AMA-s me ligj, ishte një nga shtysat kryesore për fillimin e botimit në mënyrë periodike të këtij Buletini për t’u prezantuar të gjitha grupeve të interesit tregues nga performanca e ofruesve të shërbimit mediatik audioviziv, OSHMA-ve, përfshirë të dhënat mbi pronësinë, të ardhurat nga reklamat, punësimi, etj.

Zhvillimet e ndërmarra në lidhje me forcimin e transparencës dhe llogaridhënies institucionale janë shtjelluar në mënyrë të hollësishme në pikën 8.1 të këtij raporti “Programi i Transparencës”.

3. QEVERISJA E AUTORITETIT

Në ushtrim të kompetencave të veta ligjore, të sanksionuara në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, vendimmarrja e AMA-s është realizuar përmes dhënies së licencave për transmetime numerike kombëtare, autorizimeve për ofrimin e shërbimeve mediatike audio/audiovizive dhe përsëritjen e shërbimeve mediatike audio/audiovizive, rinovimit të licencave/autorizimeve të OSHMA-ve, shqyrtimit të ankimeve administrative, por edhe çështje të tjera që përfshihen brenda veprimtarisë së AMA-s.

Gjatë procedurës administrative të shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga subjektet për dhënien e licencave/autorizimeve apo rinovimin e tyre, është mbajtur parasysh respektimi i kushteve të përcaktuara në ligj dhe në licencë nga ana e subjekteve që ushtrojnë veprimtari radiotelevizive. Kështu, gjatë shqyrtimit të kërkesave për rinovimin e licencave është realizuar verifikimi i respektimit të kriterëve dhe kushteve të licencës/autorizimit për sa u përket programeve, detyrimet financiare për periudhën e ushtrimit të aktivitetit, si dhe zbatimi i legjislacionit në përgjithësi dhe, veçanërisht i ligjit nr. 97/2013.

Ashtu si edhe gjatë vitit 2016, edhe përgjatë vitit raportues, vëmendje e veçantë i është kushtuar garantimit të transparencës së vazhdueshme të veprimtarisë së AMA-s si dhe komunikimit e bashkëpunimit të pandërprerë me të gjithë subjektet e përfshirë në fushën e medias dhe të të drejtave të transmetimit/autorit. Në këtë kuptim, AMA gjatë periudhës raportuese, nuk ka pasur prioritet të vendosë sanksione në mënyrë represive, por të sigurojë komunikim të vazhdueshëm me OSHMA-të, sa i përket mbrojtjes dhe respektimit të së drejtës së transmetimit dhe të drejtës së autorit.

Theksojmë se nga monitorimet e programeve të transmetuara është vënë re një zvogëlim i ndjeshëm i fenomenit të transmetimit të programeve pa pasur më parë të drejtat e transmetimit. Në mënyrë të veçantë, transmetimi i veprave kinematografike nga operatorët lokalë është kufizuar në transmetimin e veprave të prodhuara në Shqipëri dhe nga autorë shqiptarë, duke qenë se edhe sigurimi i të drejtave të transmetimit dhe atyre të autorit për këto vepra është dhe mbetet më e thjeshtë, në krahasim me të drejtat e veprave të huaja.

AMA, mbështetur në funksionet e dhëna prej ligjit organik për monitorimin e veprimtarisë radio/audiovizive, ka miratuar gjithashtu edhe vendime për heqje, konstatim pavlefshmërie, mosrinovime apo mosdhënie licence/autorizimi për disa subjekte, të cilat nuk kanë respektuar kushtet dhe kriteret të përcaktuara në ligj dhe licencën/autorizimin e miratuar.

AMA gjatë vitit 2017, ka vendosur:

- Dhënien e licencës së transmetimit audio të komunitetit për 4 subjekte;
- Dhënien e autorizimit për 2 subjekte për ofrimin e shërbimit të programit audio/audioviziv, si dhe zgjerimin/zvogëlimin e zonës së ofrimit të shërbimit për 8 subjekte;

- Rinovimin e licencës për transmetime audio për 10 subjekte, rinovimin dhe zëvendësimin e licencës për transmetime audiovizive analoge për 18 subjekte dhe rinovimin e autorizimit për 22 subjekte;
- Mosdhënien e autorizimit për 8 subjekte, konstatimin e pavlefshmërisë së licencës dhe/ose autorizimit për 19 subjekte, heqjen e licencës dhe/ose autorizimit për 6 subjekte dhe pezullimin e shqyrtimit të aplikimit për rinovim për 1 subjekt;
- Miratimin e ndryshimeve në të dhënat e ndodhura në kërkesën për marrje licence/autorizimi për 10 subjekte.

Për të siguruar respektimin e dispozitave të ligjit për strukturën e pronësisë së kontraktorëve të transmetimit, në mënyrë periodike AMA ka verifikuar në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit të dhënat mbi ndryshimet e kryera prej ofruesve të shërbimit mediatik audio/audioviziv, për të cilat nuk ishte njoftuar autoriteti rregullator.

Në vijim të kontroleve të kryera, AMA ka ndërmarrë procedimet administrative ndaj OSHMA-ve duke kërkuar informacion dhe dokumentacion ligjor mbi ndryshimet në të dhënat për licencë/autorizim si dhe rast pas rasti duke vendosur sanksionet përkatëse. Për këtë kundërvajtje administrative, AMA ka ndëshkuar me sanksion gjobë 5 subjekte OSHMA.

Gjatë periudhës raportuese, në zbatim të ligjit AMA ka përfunduar procesin e dhënies së licencave për shërbimin audio të komunitetit. Pas miratimit të kuadrit rregullator për dhënien e licencave të shërbimit të transmetimit audio të komunitetit, në zbatim të ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar, dhe vendimit nr. 55, datë 04.04.2016, më të cilin u miratua rregullorja për dhënien e licencave të transmetimit audio të komunitetit, në muajin dhjetor 2016 AMA shpalli në mënyrë publike procedurën për dhënien e licencave të transmetimit audio të komunitetit për 4 zona ofrimi shërbimi: qarqet Tiranë, Durrës, Lezhë dhe Shkodër; qarqet Tiranë, Durrës, Elbasan dhe Berat; qarqet Tiranë, Durrës, Fier dhe Elbasan dhe qarqet Tiranë dhe Durrës.

Në vijim, AMA, me vendimin nr. 20, datë 02 mars 2017 vendosi të shpallë çeljen e garës për dhënien e licencës të transmetimit audio të komunitetit për zonat Bashkitë Tiranë, Kamëz, Vorë, Durrës, Shijak.

Pranë AMA-s, në datat e përcaktuara si data përfundimtare për depozitimin e aplikimeve u depozituan 4 aplikime.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar nga subjektet aplikuese, AMA vendosi:

- Dhënien e licencës së transmetimit audio Komunitetit Mysliman të Shqipërisë për subjektin “Radio Spektrum” për të ofruar shërbim në Bashkitë Tiranë, Kamëz, Vorë, Durrës, Shijak. (Vendimi nr. 59, datë 10.05.2017);
- Dhënien e licencës së transmetimit audio të komunitetit Shoqatës “Radio Maria” për subjektin “Radio Maria” për të ofruar shërbim në qarqet Tiranë, Durrës, Lezhë dhe Shkodër; (Vendimi nr. 60, datë 10.05.2017);

- Dhënien e licencës së transmetimit audio të komunitetit Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë për subjektin “Radio Ngjallja” për të ofruar shërbim në qarqet Tiranë dhe Durrës (Vendimi nr. 61, datë 10.05.2017);
- Dhënien e licencës së transmetimit audio të komunitetit Kryegjyshitës Botërore Bektashiane të Shqipërisë për subjektin “Radio Dodona” për të ofruar shërbim në Qarqet Tiranë, Durrës, Elbasan dhe Berat; (Vendimi nr. 62, datë 10.05.2017).

4. AUTORITETI SI RREGULLATOR PËR NJË TREG AUDIOVIZIV TË PËRGJEGJSHËM

4.1. Shqyrtimi tematik i përmbajtjeve të emetuara

AMA, në procesin e monitorimit të përmbajtjeve të emetuara nga OSHMA, realizon dhe shqyrtime analitike, të tematizuara për të vlerësuar respektimin e kërkesave të ligjit 97/2013 dhe Kodit të Transmetimit. Gjatë vitit 2017, në qendër të vëmendjes së shqyrtimeve ishin edhe:

- a. mbrojtja e fëmijëve në transmetimet e televizioneve kombëtare;
- b. menaxhimi i hapësirës së reklamave dhe komunikimet me natyrë tregtare;
- c. shmangia e përdorimit të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit;
- d. respektimi i standardit letrar të gjuhës shqipe në përmbajtjet audiovizive;
- e. shmangia e përmbajtjeve të papërshtatshme dhe joetike në televizionet e formatit muzikor.

a. Mbrojtja e fëmijëve në transmetimet e televizioneve kombëtare

Mbrojtja e fëmijëve në përmbajtjet audiovizive të transmetuara mbetet një nga prioritetet e AMA-s, ndaj dhe ky aspekt në mënyrë periodike është në qendër të shqyrtimeve tematike që realizohen mbi përmbajtjet e emetuara nga OSHMA-të. Në muajin qershor 2017, AMA monitoroi 4 televizionet kombëtare: RTSH 1, Top Channel, Klan dhe Vizion Plus mbi çështje që lidhen me respektimin e:

- të drejtës së fëmijëve për privatësi;
- aspektit të identifikimit të fëmijëve në përmbajtjet e emetuara;
- standardeve të intervistimit;
- kërkesave të Kodit të Transmetimit për pjesën e reklamave, për programet kulturore argëtuese dhe filmat;
- vendosjes së shenjave paralajmëruese për mbrojtjen e fëmijëve në programet audiovizive etj.

Në programet informative (edicionet e lajmeve), të katër televizionet respektonin në përgjithësi kërkesat e Kodit të Transmetimit për mbrojtjen e fëmijëve. Megjithatë u evidentuan raste të shkeljes së të drejtës për privatësi të tyre, por krahasuar me shqyrtimet e mëparshme ato ishin më të pakta. Një problem tjetër që mbetet ende i pakonsoliduar në transmetimet e televizioneve kombëtare është vendosja e shenjave paralajmëruese për programet që janë të ndaluara ose mund të ndiqen nga fëmijët kur janë të shoqëruar nga prindërit. U vërejt se sasia e programeve dedikuar fëmijëve është ende e pakët në këto televizione, por kjo dukuri relativizohet në kushtet aktuale të tregut audioviziv, kur secili prej subjekteve është pjesë e platformave digjitale, ku ka kanale të posaçme tematike që kanë programacion vetëm për fëmijët.

b. Menaxhimi i hapësirës së reklamave dhe komunikimet me natyrë tregtare

Hapësira e reklamave dhe komunikimeve tregtare ka qenë dhe mbetet një ndër fokuset ku AMA është përqëndruar, për të nxitur subjektet audiovizive në respektimin e kuadrit ligjor në fuqi, në shërbim të informimit dhe orientimit sa më të mirë të publikut. Pas shqyrtimeve tematike mbi këtë aspekt, Autoriteti zhvilloi, në muajin mars të vitit 2017, një tryezë pune në Tiranë me subjektet audio dhe audiovizive. Në takim ishin të ftuar krahas përfaqësuesve nga OSHMA-të dhe partnerë të AMA-s, të cilët kanë rol në përmbushjen dhe bashkërendimin e forcave për rregullimin e tregut të reklamave, si Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, Urdhri i Mjekëve të Shqipërisë, Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë, apo ekspertë nga Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit në Universitetin e Tiranës, Instituti Shqiptar i Medias etj.

Aktiviteti krijoi hapësirën e një diskutimi të përbashkët mes palëve, për prezantimin e gjetjeve dhe dukurive të evidentuara gjatë monitorimit të përmbajtjeve të emetuara nga subjektet audiovizive: mënyrat e menaxhimit të hapësirës promovionale dhe impakti tek audienca; reklamat dhe mbrojtja e fëmijëve; promovioni audioviziv për shëndetin dhe rekomandimi për barnat përmes transmetimeve audiovizive etj.

Nisur nga problematikat dhe ndjeshmëritë që u përcollën nga takimi, AMA realizoi një monitorim që fokusonte emetimin e reklamave apo komunikimeve me natyrë tregtare audiovizive mbi shërbimet mjekësore, barnat dhe medikamentet e ndryshme që jepen vetëm me recetën e mjekut, në katër televizionet kombëtare RTSH 1, Klan, Top Channel dhe Vizion Plus. Veç RTSH 1, ku u evidentua se respektoheshin kërkesat e ligji 97/2013 rreth këtyre çështjeve, tek tre operatorët privatë u regjistruan raste shkeljesh. Më së shumti për përmbajtje kronikash e emisionesh ku aplikoheshin reklamë e fshehtë mbi shërbimet që ofrohen aty, apo duke promovuar trajtime të ndryshme shëndetësore. Kurse barnat që reklamoheshin ishin gjithmonë nga ato që shpërndahen pa recetë nga mjeku.

Më pas shqyrtimi po me të njëjtin fokus u krye dhe për televizionet informative News 24, Ora News, Report Tv dhe ABC News, duke monitoruar blloqet e reklamave në kënd dhe ato me titra; në shitjet e drejtpërdrejta; në komunikimet me natyrë tregtare, si dhe në komunikimet me natyrë tregtare të fshehura. Edhe nga këta operatorë u vu re se jo gjithmonë zbatoheshin ligji, sidomos përmes emetimit të kronikave që ishin si reklama të fshehura. Po kështu, edhe në reklamat me kënd.

Sa u takon problematikave të mësipërme, AMA u ka tërhequr vëmendjen OSHMA-ve për evitimin e shkeljeve, por procesi vlerësues do të vijojë duke këmbëngulur në zbatimin e kërkesave të ligjit 97/2013 dhe Kodit të Transmetimit, kur në raste përsëritjeje do të ketë sanksionim, bazuar në legjilacionin në fuqi. Në të njëjtën kohë janë parashikuar përmirësime specifike mbi shërbimet mjekësore, barnat dhe medikamentet e ndryshme, të cilat jepen vetëm me recetë nga mjeku në tekstin e projektregullores për reklamat dhe komunikimet tregtare. AMA është konsultuar dhe ka marrë mendime, sugjerime dhe propozime konkrete nga grupet e interesit, apo partnerët që punojnë në këtë fushë, duke përfshirë dhe Urdhrin e Mjekëve të Shqipërisë dhe Urdhrin e Farmacistëve të Shqipërisë, si dy struktura të specializuara.

c. Shmangia e përdorimit të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit

Në muajin nëntor 2017u realizua një shqyrtim tematik mbi përdorimin e gjuhës së urrejtjes

dhe diskriminimin në përmbajtjet që emetohen në televizionet kombëtare RTSH 1, Top Channel, Klan dhe Vizion Plus, në zbatim të ligjit 97/2013 dhe Kodit të Transmetimit të AMA-s. Fokusi ishte në përmbajtjet e programeve dhe rubrikave informuese e debatuese ose të formatit argëtues, ku nga vetë gazetarët apo të ftuarit trajtoheshin tema të aktualitetit me ndjeshmëri të lartë tek ndjekësit, ballafaqoheshin pikëpamje dhe qëndrime nga më të ndryshmet, ndesheshin këndvështrime mbi të sotmen dhe perspektivën sociale, ekonomike, politike, kulturore etj. Por pa lënë jashtë vëmendjes dhe përmbajtje të huazuara (të të tretëve), si filma, dokumentarë, spektakle etj

Shqyrtimi nuk shkante përkundër lirisë së shprehjes dhe pluralitetit në transmetimet audio dhe audiovizive, por për të evidentuar raste konkrete të përdorimit të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit për individë, grupe të ndryshme sociale, institucione etj.

Nga monitorimi i detajuar për dy javët e para të nëntorit 2017 u konstatua se nga të katër televizionet kombëtare në shqyrtim nuk kishte raste të shkeljes së ligjit dhe të Kodit të Transmetimit sa i takon përdorimit të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit. Por pavarësisht kësaj, AMA do të planifikojë shqyrtime mbi këtë tematikë edhe në të ardhmen, duke iu kthyer përmbajtjeve të emetuara jo vetëm nga operatorët me licencë kombëtare, por dhe ato lokale/rajonale.

d. Respektimi i standardit letrar të gjuhës shqipe në përmbajtjet audiovizive

Gjuha e shkruar dhe e folur në ekranet televizive kombëtare ishte një nga fokuset e shqyrtimeve tematike të vitit 2017, për të vlerësuar respektimin e standardeve të shqipes. AMA këtë aspekt e konsideron jo thjesht si detyrimin ligjor në veprimtarinë e operatorëve radiotelevizivë publikë e private, por të lidhur me faktin se kultura gjuhësore ndikon drejtpërdrejt dhe në mënyrë të tërthortë në formimin kulturor gjuhësor e letrar të ndjekësve të këtyre përmbajtjeve, sidomos te fëmijët dhe moshat e reja. Nga ana tjetër, mbrojtja, ruajtja zhvillimi dhe pasurimi i gjuhës shqipe është detyrë e përgjegjësi qytetare e atdhetare e institucioneve akademike të specializuara, por edhe e mjeteve të komunikimit masiv. Interesi publik për ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhës mbetet gjithnjë i lartë, pasi bëhet fjalë për shenjën e parë e më të rëndësishme të identitetit kombëtar. Standardi gjuhësor në media është, veç të tjerash, garanci për kulturë komunikimi, respektim të parimeve dhe kërkesave etike dhe profesionale në programet radiotelevizive. Fokusi ishte tek RTSH1, Top Channel. Klan dhe Vizion Plus, pasi, televizionet kombëtare, në veçanti, duhet të pasqyrojnë në veprimtarinë e tyre një kulturë gjuhësore në pajtim me normën e vendosur të gjuhës letrare kombëtare.

Nga shqyrtimi rezultoi se televizionet kombëtare, përgjithësisht, kanë më shumë vëmendje e kujdes për respektimin e standardit letrar të gjuhës shqipe në programet që transmetojnë. Janë shtuar përpjekjet për njohje dhe vlerësim të rregullave të drejtshqiptimit të shqipes dhe etikës së komunikimit gjuhësor televiziv, duke shmangur përdorimin e zhargonit dhe shprehjeve vulgare. Vijn dukuria shqetësuese e përdorimit të panevojshëm të fjalëve të huaja, nga folësit e drejtuesit e programeve, edhe në rastet kur mund të shmanget plotësisht përdorimi i tyre, duke i zëvendësuar me fjalë gjegjëse të gjuhës shqipe. Si shkelje e përsëritur, vijn të mos zbatohet norma drejtshkrimore për shkrimin e emrave të përveçëm të huaj dhe mbaresave rasore të emrave në titrat e lajmeve. Mospërdorimi i germës “Ë” (e madhe) dhe “Ç” (e madhe) në titrat e edicioneve informative nuk respekton normën drejtshkrimore, krijon paqartësi dhe vështirësi për teleshikuesit.

AMA u dërgoi një shkresë OSHMA-ve të monitoruara duke u tërhequr vëmendjen mbi gjetjet

e shqyrtimit të realizuar. Gjithashtu duke e konsideruar të rëndësishëm këtë komponent në transmetimet audiovizive, AMA do të realizojë një shqyrtim dhe me televizionet informative. Për vitin 2018 po ashtu është planifikuar dhe një takim pune, informimi dhe ndërgjegjësimi, me përfaqësues të OSHMA-të mbi problematikat e hasura dhe për të nxitur respektimin e shqipes standarde të shkruar dhe të folur, duke përfshirë në forum dhe ekspertë a studiues të gjuhës shqipe.

e. Shmangia e përmbajtjeve të papërshtatshme dhe joetike në televizionet e formatit muzikor

Në muajin tetor 2017, AMA u fokusua në transmetimet e televizioneve të formatit muzikor, nisur nga shqetësimet e shikuesve, për tekste të papërshtatshme këngësh apo dhe pamje videoklipesh me skena dhune e erotike, të transmetuara në orare kur para ekranit janë fëmijët, të miturit. Duke vlerësuar angazhimin e këtyre subjekteve për promovimin e kulturës kombëtare, sidomos për nxjerrjen në pah të krijimtarisë dhe performancës muzikore në gjuhën shqipe, AMA ka evidentuar përmbajtje që bien në kundërshtim me kërkesat e ligjit 97/2013 “Për transmetimet audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Kodin e Transmetimit të AMA-s, duke mos respektuar në mënyrë të veçantë të drejtat, interesat dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve.

Siç parashikon ligji, në nenin 4, pika 1, germa b, veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton “në mënyrë të veçantë të drejtat, interesat dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve”. Po kështu, në nenin 33 pika 1, germa d, sanksionohet se “ofruesi i shërbimit mediatik audioviziv, duhet të respektojë rregullat e etikës dhe moralit publik...”

Këto kërkesa të ligjit janë theksuar e përforcuar edhe në Kodin e Transmetimit të AMA-s. Në seksionin 1, pikat 1.4 dhe 1.7, si dhe në seksionin 5, pikat 5.29, thuhet se “OSHMA-të, në programet kulturore e argëtuese...duhet të tregojnë kujdesin e duhur ndaj ndjeshmërisë së publikut dhe efekteve të programeve të tilla në zhvillimin moral, mendor e fizik të të miturve”. Po ashtu, edhe në pikat 5.32, 5.33 të Kodit, përcaktohet se kur transmetohen programe që mund të dëmtojnë fëmijën duhet të paraprihen nga një paralajmërim akustik ose viziv, si dhe në pikat 5.34 e 5.35 përcaktohet se OSHMA-të duhet të mbajnë parasysht shkallën e efektit të shkaktuar nga materiale që dëmtojnë fëmijët, si dhe të shmangët rreziku i varësisë ndaj televizionit dhe imitimit të modeleve.

Pas përfundimit të shqyrtimit, AMA iu drejtua subjekteve që u monitoruan duke u tërhequr vëmendjen, për shmangien e transmetimeve të tilla në orare të papërshtatshme për fëmijët. Për përsëritje të mosrespektimit të ligjit, Autoriteti do të procedojë sipas kërkesave të kuadrit legjislativ në fuqi.

4.2. Monitorimet e përmbajtjeve

Për regjistrimin e subjekteve, në Studion e Monitorimit, tashmë përveç regjistrimeve të transmetimeve analoge, ka filluar që nga muaji qershor 2017 edhe regjistrimi i subjekteve audio dhe audiovizive në transmetimet digjitale.

Për monitorimin e transmetimeve analoge janë në funksion 10 kompjutera regjistruar, ku regjistrohen nga ora 07⁰⁰ deri në 04⁰⁰ të ditës së nesërme, (për t'u ristartuar përsëri në 07⁰⁰)

subjektet audio dhe audiovizivë që transmetojnë në qytetin e Tiranës, si dhe platforma Abcom, sipas një plani të miratuar, i cili përshtatet me kërkesat nga drejtoritë e tjera apo me ankesat nga palët e treta.


Për monitorimin e transmetimeve digjitale janë në funksion 16 njësi regjistrimi (regjistrimi kryhet pa ndërprerje 24 orë).

Në terma statistikorë, në total gjatë këtij viti, janë regjistruar:

- *në transmetime analoge rreth 70,000 orë transmetime audiovizive, 2,500 orë transmetime audio të subjekteve kombëtare dhe 650 orë regjistrime të subjekteve audio me kërkesë të të tretëve.*
- *në transmetimet digjitale 72,000 orë transmetime audiovizive dhe rreth 2,500 orë transmetime audio*

që krahasuar me vitin 2016 janë si më poshtë :

Vite	2015	2016	2017
Orë regjistrime televizione	69,000	70,000	142,000
Orë regjistrime radio	5,000	5,000	5,650



Krahas regjistrimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive që janë pjesë e Arkivës së Autoritetit të Mediave Audiovizive, puna në Studion e Monitorimit fokusohet në monitorimime:

- Reklamave;
- Edicioneve informative;
- Detyrimeve programore;

- Shqyrtimin e ankesave nga publiku;
- Shqyrtimin e ankesave nga operatorët;
- Monitorimet për të drejtat e transmetimit;
- Monitorimet për të drejtat e autorit.


Gjatë vitit 2017 në Studion e Monitorimit dhe Arkivës janë kryer 275 monitorime të subjekteve Ofrues të Shërbimeve Mediatike Audiovizive (OSHMA), si dhe janë kërkuar 22 (63 ditë) regjistrime programesh nga subjektet OSHMA, që nuk mund të monitorohen dot nga Studio e Monitorimit.

- Monitorimi i reklamave në subjektet audiovizivë kombëtarë janë rreth 16,000 orë programe të monitoruara.
- Edicione informative në subjektet audio dhe audiovizivë kombëtarë janë monitoruar rreth 2,100 (1,340 edicione të subjekteve audioviziv kombëtarë dhe 770 edicione të subjekteve audio kombëtare).
- Monitorim programacioni për të drejtat e transmetimit e të drejtat e autorit:
 - *për subjekte lokale rreth 6,700 orë transmetime,*
 - *për platformat Tring dhe Digitalb 2,100 orë transmetime,*
 - *për subjekte lokale që nuk mund të regjistrohen në Studion e Monitorimit 1,260 orë transmetime (pasqyrim i 22 kërkesave ose 63 ditë regjistrime).*

Krahasuar me vitet 2015 dhe 2016, të dhënat janë si më poshtë :


A. Monitorime edicione lajmesh

	Kategoria e OSHMA-ve	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017
1	Televizione	900	900	1,340
2	Radio	600	600	770



B. Monitorime reklamash


	Kategoria e OSHMA-ve	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017
1	Subjekte audiovizive kombëtarë	14,000	14,000	16,000



C. Monitorime për të drejta transmetimi

	Kategoria e OSHMA-ve	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017
1	Televizione lokale	1,250	3,300	6,700

2	Platformat Digitalb dhe Tring		1,250	2,100
---	-------------------------------	--	-------	-------



Gjatë periudhës maj-qershor 2017, Studio e Monitorimit dhe Arkivës në AMA ka ofruar shërbim vetëm për Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve, bazuar në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë dhe Marrëveshjen e Bashkëpunimit AMA - KQZ.

Në mbështetje të Kodit Zgjedhor, monitorimi i pasqyrimit të fushatës zgjedhore në median elektronike bëhet nga Bordi i Monitorimit të Medias (BMM). Angazhimi i Studios së monitorimit ishte maksimal në përshtatjen e metodologjisë së monitorimit, trajnimin e personelit të monitoruesve, përgatitjen e teknikës së nevojshme dhe infrastrukturës përkatëse në Studion e Monitorimit të AMA-s .

Në periudhën e fushatës zgjedhore, janë monitoruar 12 subjekte audiovizive dhe 2 subjekte audio në lidhje me edicionet e lajmeve (audio dhe audiovizive), si dhe për transmetimn e reklamave dhe emisioneve politike si më poshtë :

- Rreth 1800 edicione lajme të subjeteve audio dhe audiovizive;
- Rreth 3000 orë regjistrime për transmetimin e emisioneve politike;
- Rreth 3000 orë regjistrime për transmetimin e reklamave politike.

Ndarja e kohës në edicionet informative kryesore në subjektet kombëtare

Në procesin monitorues të përmbajtjeve të emetuara nga subjektet me licencë kombëtare, një fokus sistematik i përditshëm është dhe monitorimi i edicioneve kryesore informative të tyre. Kështu bëhet monitorim për:

-RTSH	(edicioni ora 20.00)
-Top Channel	(edicioni ora 19.30)
-Klan	(edicioni ora 19.30)

-Vizion Plus	(edicioni ora 19.30)
-Radio Tirana	(edicioni ora 20.00)
-Top Albania Radio	(edicioni ora 16.00)

Monitorimi i edicionit kryesor të lajmeve është përzgjedhje e fluksit informativ të një subjektit që është konsideruar nga AMA, si një nga treguesit kryesorë të shfaqjes së linjës editoriale, kujdesit që tregon radio ose televizioni për ndarjen kohore që u kushton subjekteve politike dhe institucioneve (në minuta dhe përqindje), si vlerësim për respektimin ose jo të balancës gjatë raportimit mbi zhvillimet nga aktualiteti.

Vlerësimi që bën AMA është vetëm sasior. Duke i përmbledhur me gjetjet e një muaji, treguesit bëhen publike duke u shkarkuar në faqen zyrtare të institucionit. Ndërkohë që çdo gjashtë muaj treguesit përfshihen të përmbledhura dhe në Buletinin Periodik të AMA-s. Bashkangjitur janë të dhënat e edicioneve kryesore të lajmeve të 6 subjekteve kombëtare për vitin 2017 (të grupuara në çdo muaj). Në muajin qershor 2017 treguesit janë të zëruar, sepse, siç dihet, ky ka qenë muaji fushatës elektorale, kur monitorimi i lëndës informative dhe debatuese monitorohet dhe vlerësohet nga KQZ.

Përlllogaritja e kohës në minuta ose përqindje është vetëm sasimore (sipas tabelave më poshtë), por jo nga pikëpamja cilësore (mbi nuancat, prirjet a qëndrimet evidente), pasi këto është e pamundur të realizohen në mënyrë periodike.

Vitet e fundit AMA është e fokusuar në trajtimin e rasteve kur një operator bën reklamë politike (jashtë periudhës zgjedhore), pasi një gjë e tillë ndalohet me ligjin 97/2013. Nga insistimi i AMA-s është evidente që ka ndërgjegjësim nga subjektet audiovizive për evitimin e reklamave politike.

Autoriteti i Mediave Audiovizive												
Raport i Drejtorisë së Programeve për Edicionet Informative												
Koha e plotë për subjektet politike dhe institucionet qendrore												
JANAR 2017												
Subjektet	TCH		KLAN		TVSH		R.TIRANA		TAR		VIZION PLUS	
	koha/min	koha/%	koha/min	koha/%	koha ne min	koha/%	koha/min	koha/%	koha/min	koha/%	koha/min	koha/%
Presidenca	2.57	1.34%	10.85	1.86%	4.9	1.86%	5.63	2.68%	1.17	1.18%	6.35	2.04%
Kryeministria	14.32	7.48%	25.25	14.88%	39.27	14.88%	34.57	16.47%	19.08	19.34%	47.92	15.43%
Qeveria	55.25	28.86%	35.85	37.15%	98.07	37.15%	79.83	38.03%	29.4	29.80%	90.68	29.20%
Parlamenti	20.68	10.80%	10.08	11.23%	29.63	11.23%	18.75	8.93%	10.1	10.24%	34.37	11.07%
Partia Socialiste	16.6	8.67%	17.02	7.95%	20.98	7.95%	18.3	8.72%	6.08	6.17%	20.95	6.75%
Partia Demokratike	35.48	18.54%	36.03	17.41%	45.95	17.41%	32.95	15.70%	14.83	15.04%	60.9	19.61%
Lëvizja Socialiste për Integrim	13.28	6.94%	11	5.13%	13.55	5.13%	13	6.19%	7.15	7.25%	23.7	7.63%
Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	2.98	1.56%	2.35	1.77%	4.68	1.77%	2.25	1.07%	2.07	2.09%	0	0.00%
Te tjera	6.9	2.04%	5.25	2.35%	6.22	2.35%	3.38	1.61%	2	2.03%	6.65	2.15%
Koha e plotë për subjektet politike dhe institucionet qendrore												
SHKURT 2017												
Subjektet	TCH		KLAN		TVSH		R.TIRANA		TAR		VIZION PLUS	
	koha/min	koha/%	koha/min	koha/%	koha ne min	koha/%	koha/min	koha/%	koha/min	koha/%	koha/min	koha/%
Presidenca	7.67	2.89%	32.25	13.21%	6.65	2.20%	7.92	3.51%	3.2	2.87%	3.1	1.11%
Kryeministria	35.07	13.24%	42.65	17.47%	41.57	13.73%	44.12	19.58%	17.32	15.52%	48.03	17.12%
Qeveria	58.53	22.10%	58.82	24.09%	93.77	30.96%	71.97	31.95%	26.38	23.64%	61.37	21.88%
Parlamenti	20.05	7.57%	28.38	11.62%	32.7	10.80%	27.03	12.00%	8.63	7.74%	26.92	9.59%
Partia Socialiste	13.62	5.14%	11.35	4.65%	15.58	5.15%	12.08	5.36%	8.13	7.29%	11.5	4.10%
Partia Demokratike	63.9	24.12%	59.55	24.39%	80.37	26.54%	45.55	20.22%	34.72	31.11%	101.75	36.27%
Lëvizja Socialiste për Integrim	19.17	7.24%	7.32	3.00%	12.2	4.03%	9.53	4.23%	5.6	5.02%	10.67	3.80%
Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	5.3	2.00%	0	0.00%	1.4	0.46%	1.15	0.51%	0	0.00%	1.5	0.53%
Te tjera	8.72	3.28%	3.85	1.58%	18.6	6.14%	4.66	2.07%	4.08	3.66%	12.5	4.45%

Autoriteti i Mediave Audiovizive												
Raport i Drejtorisë së Programeve për Edicionet Informative												
Koha e plotë për subjektet politike dhe institucionet qendrore												
MARS 2017												
Subjektet	TCH		KLAN		TVSH		R.TIRANA		TAR		VIZION PLUS	
	koha/min	koha/%	koha/min	koha/%	koha ne min	koha/%	koha/min	koha/%	koha/min	koha/%	koha/min	koha/%
Presidenca	11.68	4.05%	25.92	11.34%	7.73	3.18%	6.93	3.26%	2.58	2.07%	7.03	2.08%
Kryeministria	36.6	12.68%	54.62	23.89%	49.98	20.52%	49.25	23.15%	13.77	11.04%	71.93	21.27%
Qeveria	63.68	22.07%	24.88	10.88%	45.4	18.64%	46.18	21.71%	26.88	21.55%	70.93	20.97%
Parlamenti	22.47	7.79%	13.72	6.00%	22.97	9.43%	22.17	10.42%	8.8	7.06%	31.4	9.28%
Partia Socialiste	39.6	13.72%	14.3	6.25%	19.98	8.21%	16.57	7.79%	16.45	13.19%	42.4	12.54%
Partia Demokratike	60.7	21.04%	69.65	30.46%	62.2	25.54%	42.77	20.10%	30.32	24.31%	72.95	21.57%
Lëvizja Socialiste për Integrim	23.9	8.28%	17.9	7.83%	15.62	6.41%	15.37	7.22%	10.22	8.19%	22.28	6.59%
Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	4.03	1.40%	0	0.00%	7.27	2.98%	4.87	2.29%	3.73	2.99%	0	0.00%
Te tjera	4.75	1.65%	6.68	2.92%	12.4	5.09%	8.65	4.06%	5.09	4.07%	10.09	2.99%
Koha e plotë për subjektet politike dhe institucionet qendrore												
PRILL 2017												
Subjektet	TCH		KLAN		TVSH		R.TIRANA		TAR		VIZION PLUS	
	koha/min	koha/%	koha/min	koha/%	koha ne min	koha/%	koha/min	koha/%	koha/min	koha/%	koha/min	koha/%
Presidenca	4.73	2.00%	12.73	5.36%	11.1	4.09%	8.18	3.70%	3.4	2.89%	6.22	1.71%
Kryeministria	49.03	20.69%	53.63	22.56%	47.33	17.46%	51	23.03%	21.88	18.63%	70.8	19.51%
Qeveria	41.93	17.69%	15.55	6.54%	44.33	16.36%	33.98	15.34%	30.2	25.71%	40.58	11.18%
Parlamenti	14.62	6.17%	23.22	9.77%	23.93	8.83%	19.28	8.71%	11.85	10.09%	58.52	16.12%
Partia Socialiste	0	0.00%	0	0.00%	0	0.00%	0	0.00%	0	0.00%	0	0.00%
Partia Demokratike	0	0.00%	0	0.00%	0	0.00%	0	0.00%	0	0.00%	0	0.00%
Lëvizja Socialiste për Integrim	27.2	11.48%	31.05	13.06%	41	15.13%	24.95	11.27%	5.22	4.44%	51.75	14.26%
Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	65.05	27.45%	69.93	29.41%	64.23	23.70%	51.18	23.11%	30.65	26.09%	82.08	22.61%
Te tjera	34.42	14.52%	31.64	13.31%	39.13	14.44%	254.36	14.84%	14.28	12.16%	46.76	12.89%

Autoriteti i Mediave Audiovizive												
Raport i Drejtorisë së Programeve për Edicionet Informative												
Koha e plotë për subjektet politike dhe institucionet qëndrore												
MAJ 2017												
Subjektet	TCH		KLAN		TVSH		R.TIRANA		TAR		VIZION PLUS	
	koha/min	koha/ %	koha/min	koha/%	koha ne min	koha/%	koha/min	koha/ %	koha/min	koha/%	koha/min	koha/ %
Presidenca	16.65	7.47%	23.55	12.71%	12.75	7.44%	13.8	7.93%	5.07	6.46%	7.48	2.74%
Kryeministria	39.88	17.90%	34.52	18.63%	21.98	12.83%	26.05	14.98%	15.1	19.24%	29.42	10.76%
Qeveria	24.82	11.14%	8.75	4.72%	19.7	11.50%	19.63	11.29%	7.27	9.26%	23.8	8.71%
Parlamenti	12.17	5.46%	5.5	2.97%	11.08	6.47%	9.92	5.70%	5.18	6.60%	22	8.05%
Partia Socialiste	26.27	11.79%	30.13	16.27%	30.73	17.94%	39.35	22.63%	8.62	10.98%	60.47	22.12%
Partia Demokratike	77.2	34.65%	48.05	25.94%	43.9	25.62%	32.87	18.90%	24.07	30.66%	71.9	26.30%
Lëvizja Socialiste për Integrim	9.87	4.43%	22.17	11.97%	14	8.17%	19.12	10.99%	8.15	10.38%	21.33	7.80%
Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	0	0.00%	0.87	0.47%	2.4	1.40%	5.05	2.90%	1.47	1.87%	0	0.00%
Te tjera	10.44	4.68%	11.72	6.31%	14.81	8.64%	8.14	4.67%	3.56	4.53%	29.58	10.81%
Koha e plotë për subjektet politike dhe institucionet qëndrore												
(Zgjedhjet parlamentare 2017)												
QERSHOR 2017												
Subjektet	TCH		KLAN		TVSH		R.TIRANA		TAR		VIZION PLUS	
	koha/min	koha/ %	koha/min	koha/%	koha ne min	koha/%	koha/min	koha/ %	koha/min	koha/%	koha/min	koha/ %
Presidenca	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kryeministria	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Qeveria	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Parlamenti	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Partia Socialiste	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Partia Demokratike	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Lëvizja Socialiste për Integrim	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Te tjera	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Autoriteti i Mediave Audiovizive												
Raport i Drejtorisë së Programeve për Edicionet Informative												
Koha e plotë për subjektet politike dhe institucionet qëndrore												
KORRIK 2017												
Subjektet	TCH		KLAN		TVSH		R.TIRANA		TAR		VIZION PLUS	
	koha/min	koha/ %	koha/min	koha/%	koha ne min	koha/%	koha/min	koha/ %	koha/min	koha/%	koha/min	koha/ %
Presidenca	4.98	2.90%	7.92	4.58%	0.3	0.23%	8.83	7.14%	1.73	2.82%	4.67	2.20%
Kryeministria	56.23	32.74%	46.65	27.00%	28.88	0.23%	48.28	39.02%	16.18	26.31%	42.9	20.20%
Qeveria	22.02	12.82%	8.23	4.77%	21.72	21.98%	11.48	9.28%	8.03	13.06%	31.52	14.84%
Parlamenti	0	0.00%	0	0.00%	0.65	16.53%	0.93	0.75%	0.62	1.00%	2.77	1.30%
Partia Socialiste	9.33	5.43%	7	4.05%	10.58	0.49%	7.43	6.01%	1.1	1.79%	15.32	7.21%
Partia Demokratike	66.47	38.70%	98.17	56.82%	61.77	8.05%	40.5	32.73%	29.65	48.20%	109.43	51.53%
Lëvizja Socialiste për Integrim	12.7	7.40%	4.8	2.78%	4.93	47.00%	5.3	4.28%	2.87	4.66%	5.17	2.43%
Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	0	0.00%	0	0.00%	2.58	3.75%	0.98	0.79%	1	1.63%	0	0.00%
Te tjera	0	0.00%	0	0.00%	0	1.97%	0	0.00%	0	0.00%	0	0.00%
Koha e plotë për subjektet politike dhe institucionet qëndrore												
GUSHT 2017												
Subjektet	TCH		KLAN		TVSH		R.TIRANA		TAR		VIZION PLUS	
	koha/min	koha/ %	koha/min	koha/%	koha ne min	koha/%	koha/min	koha/ %	koha/min	koha/%	koha/min	koha/ %
Presidenca	6.3	8.78%	1.82	2.12%	7.32	12.04%	4.58	9.56%	2.43	10.25%	4.3	4.94%
Kryeministria	28.73	40.04%	33.95	39.62%	13.63	22.43%	25.65	53.49%	11.18	47.09%	35.07	40.26%
Qeveria	22.43	31.26%	9.72	11.34%	19.47	32.03%	8.08	16.86%	5.75	24.21%	20.6	23.65%
Parlamenti	0	0.00%	0	0.00%	0	0.00%	0	0.00%	0	0.00%	0	0.00%
Partia Socialiste	7.85	10.94%	13.47	15.72%	4.2	6.91%	2.87	5.98%	1.35	5.68%	9.8	11.25%
Partia Demokratike	3.15	4.39%	13.53	15.79%	8.55	14.07%	4.13	8.62%	2.23	9.40%	9.05	10.39%
Lëvizja Socialiste për Integrim	3	4.18%	6.37	7.43%	1.97	3.24%	1.83	3.82%	0.8	3.37%	7.83	8.99%
Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	0.3	0.42%	0.38	0.45%	0.5	0.82%	0.43	0.90%	0	0.00%	0.45	0.52%
Te tjera	0	0.00%	6.45	7.53%	3.35	5.51%	0.37	0.76%	0	0.00%	0	0.00%

Autoriteti i Mediave Audiovizive												
Raport i Drejtorisë së Programeve për Edicionet Informative												
Koha e plotë për subjektet politike dhe institucionet qëndrore												
SHTATOR 2017												
Subjektet	TCH		KLAN		TVSH		R.TIRANA		TAR		VIZION PLUS	
	koha/min	koha/ %	koha/min	koha/ %	koha ne min	koha/ %	koha/min	koha/ %	koha/min	koha/ %	koha/min	koha/ %
Presidencia	16.27	9.89%	6.43	3.81%	12.2	8.06%	17.2	12.70%	6.27	7.80%	16.53	6.19%
Kryeministria	26.68	16.23%	35.1	20.80%	23.3	15.40%	22.88	16.89%	12.83	15.97%	44.9	16.80%
Qeveria	38.58	23.47%	26.52	15.71%	41.6	27.49%	38.47	28.40%	21.52	26.77%	51.25	19.18%
Parlamenti	30.53	18.57%	25.63	15.19%	20.13	13.31%	11.57	8.54%	10.93	13.60%	47.1	17.62%
Partia Socialiste	9.35	5.69%	11.63	6.89%	11.2	7.40%	11.25	8.30%	8.3	10.33%	18.18	6.80%
Partia Demokratike	32.5	19.77%	51.63	30.59%	30.27	20.00%	22	16.24%	15.27	18.99%	64.73	24.22%
Lëvizja Socialiste për Integrim	9.25	5.63%	8.48	5.03%	10.42	6.88%	10.83	8.00%	5.27	6.55%	10.95	4.10%
Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	0.67	0.41%	0	0.00%	0	0.00%	0	0.00%	0	0.00%	0	0.00%
Te tjera	0.57	0.34%	3.35	1.98%	2.2	1.45%	0	0.00%	0	0.00%	6.44	2.41%
Koha e plotë për subjektet politike dhe institucionet qëndrore												
TETOR 2017												
Subjektet	TCH		KLAN		TVSH		R.TIRANA		TAR		VIZION PLUS	
	koha/min	koha/ %	koha/min	koha/ %	koha ne min	koha/ %	koha/min	koha/ %	koha/min	koha/ %	koha/min	koha/ %
Presidencia	4.25	1.88%	4.35	1.85%	11.95	4.72%	10.1	4.53%	3.2	3.45%	6.27	1.91%
Kryeministria	39.7	17.59%	64.02	27.16%	40.38	15.95%	53.48	24.00%	17.72	19.10%	70.85	21.59%
Qeveria	59.12	26.20%	40.72	17.27%	46.55	18.38%	51.77	23.23%	22.7	24.48%	78.88	24.04%
Parlamenti	30.33	13.44%	33.33	14.14%	34.47	13.61%	21.65	9.71%	9.48	10.23%	40.3	12.28%
Partia Socialiste	20.35	9.02%	24.72	10.49%	34.38	13.58%	24.18	10.85%	9.5	10.24%	35.47	10.81%
Partia Demokratike	49.02	21.72%	51.22	21.73%	55.98	22.11%	39.37	17.66%	20.22	21.80%	66.05	20.13%
Lëvizja Socialiste për Integrim	12.6	5.58%	15.27	6.48%	23.65	9.34%	16.75	7.52%	7.28	7.85%	10.23	3.12%
Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	0	0.00%	0.6	0.25%	0	0.00%	0	0.00%	0	0.00%	0.22	0.07%
Te tjera	8.25	3.66%	1.52	0.64%	5.85	2.31%	2.27	1.02%	2.63	2.84%	11.9	3.62%

Autoriteti i Mediave Audiovizive												
Raport i Drejtorisë së Programeve për Edicionet Informative												
Koha e plotë për subjektet politike dhe institucionet qëndrore												
NETOR 2017												
Subjektet	TCH		KLAN		TVSH		R.TIRANA		TAR		VIZION PLUS	
	koha/min	koha/ %	koha/min	koha/ %	koha ne min	koha/ %	koha/min	koha/ %	koha/min	koha/ %	koha/min	koha/ %
Presidencia	13.38	6.75%	13.5	6.63%	16.83	6.33%	15	6.16%	7.15	6.83%	13.37	4.48%
Kryeministria	23.68	11.95%	56.72	27.83%	53.88	20.25%	50.1	20.56%	16.03	15.31%	66.25	22.21%
Qeveria	60.87	30.71%	42	20.61%	64.38	24.20%	68.9	28.28%	26.58	25.39%	61.33	20.56%
Parlamenti	26.92	13.58%	23.7	11.63%	32.4	12.18%	28.98	11.90%	11.88	11.35%	38.3	12.84%
Partia Socialiste	19.73	9.96%	19.98	9.81%	24.43	9.18%	22.02	9.04%	10.65	10.17%	33.37	11.18%
Partia Demokratike	35.33	17.83%	45.45	22.30%	46.58	17.51%	29.47	12.09%	23.92	22.84%	65.42	21.93%
Lëvizja Socialiste për Integrim	11.42	5.76%	2.32	1.14%	16.23	6.10%	18.02	7.39%	5.35	5.11%	8.42	2.82%
Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	0	0.00%	0	0.00%	0	0.00%	0	0.00%	0	0.00%	0	0.00%
Te tjera	0.85	0.43%	0.1	0.05%	10.42	3.92%	0	0.00%	1.16	1.12%	0	0.00%
Koha e plotë për subjektet politike dhe institucionet qëndrore												
DHJETOR 2017												
Subjektet	TCH		KLAN		TVSH		R.TIRANA		TAR		VIZION PLUS	
	koha/min	koha/ %	koha/min	koha/ %	koha ne min	koha/ %	koha/min	koha/ %	koha/min	koha/ %	koha/min	koha/ %
Presidencia	8.05	6.75%	13.02	6.85%	15.6	7.60%	18.25	8.63%	4.97	6.20%	14.27	4.92%
Kryeministria	19.75	16.57%	44.08	23.19%	40.7	19.84%	41.6	19.67%	11.8	14.72%	54.97	18.96%
Qeveria	33.87	28.41%	40.08	21.09%	46.78	22.80%	65.38	30.92%	19.13	23.87%	72.4	24.98%
Parlamenti	16.52	13.85%	15.33	8.07%	19.57	9.54%	19.08	9.02%	8.48	10.58%	22.05	7.61%
Partia Socialiste	8.58	7.20%	18.47	9.72%	13.45	6.56%	14.45	6.83%	5.53	6.90%	27.13	9.36%
Partia Demokratike	23.23	19.49%	51.52	27.10%	50.65	24.69%	37.42	17.69%	20.87	26.03%	77.98	26.90%
Lëvizja Socialiste për Integrim	4.28	3.59%	3.65	1.92%	16.25	7.92%	11.72	5.54%	6.9	8.61%	13.88	4.79%
Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	0	0.00%	0	0.00%	1.75	0.85%	0	0.00%	0	0.00%	0	0.00%
Te tjera	4.93	4.14%	2.72	1.43%	0.42	0.20%	0.94	0.44%	2.48	3.10%	2.3	0.79%


4.3. Përqasja ndaj fenomenit të piraterisë në transmetimet audiovizive

Për një përjasje sa më efektive ndaj fenomenit të piraterisë, AMA krijoji në prill të vitit 2016 Drejtorinë e Mbikëqyrjes. Prej këtij momenti, AMA ka qenë edhe më aktive në ushtrimin e detyrave mbikëqyrëse ndaj fenomenit të piraterisë dhe mbrojtjes së të drejtave të transmetimit.

AMA ka ndjekur me prioritet të gjitha ankesat për pirateri të depozituara pranë Autoritetit, duke kryer inspektimet në terren apo monitorimet rast pas rasti. Në përfundim të procedurave përkatëse administrative, janë sanksionuar me gjobë subjektet, për mos respektimin e të drejtave të transmetimit, si dhe ndalimin e hyrjes së inspektorëve në mjediset ku janë vendosur pajisjet audiovizive të të licencuarit dhe/ose të të autorizuarit, ose nuk jepen të dhënat e kërkuara prej tyre. Kurse në rastet kur është konstatuar ushtrim i aktivitetit audioviziv pa licencimin, ose pa autorizimin e AMA-s, ndaj kundërvajtësve është bërë edhe ndalimi i ushtrimit të veprimtarisë së paligjshme dhe sekuestrimi i pajisjeve transmetuese audiovizive.

Në krahasim edhe me vitet e mëparshme, AMA ka qenë më aktive në ushtrimin e detyrave të inspektimit. Më konkretisht:

DETYRA	VITI 2015	VITI 2016	VITI 2017
INSPEKTIME	114	257	458
GJOBA	46	58	64
<i>Shfuqizuar</i>	10	32	29
SEKUESTRIME	9	23	24



Njëkohësisht, AMA ka mundur të lirojë të gjithë frekuencat radio nga transmetimet e paligjshme. Janë mbyllur 5 aktivitete audio që kryheshin në kundërshtim me parashikimet ligjore:

- 2 në Vlorë

- 2 në Lezhë
- 1 në Tiranë.

Në mënyrë të veçantë, në lidhje me respektimin e të drejtave të autorit, AMA vazhdimisht ka pasur një qasje të njëjtë ndaj të gjitha agjencive apo subjekteve të tjerë që përfaqësojnë dhe mbrojnë të drejta autorësh në vend. Për këtë AMA ka zhvilluar takime me përfaqësues të të gjithë palëve që operojnë në fushën e mediave audiovizive, në lidhje me ndërgjegjësimin dhe përcaktimet ligjore për respektimin e të drejtave të transmetimit dhe atyre të autorit. Një prej shqetësimeve të vazhdueshme të AMA-s, kundrejt agjencive kolektive të mbrojtjes së të drejtave të autorit ka qenë mungesa e transparencës së tyre kundrejt subjekteve OSHMA dhe vetë AMA-s. Mënyra e mbledhjes së tarifave, e cila kërkohen të shlyhet në formë aforfeje që në fillim të vitit, apo mungesa e plotë e transparencës në shpërndarjen e të ardhurave, kanë qenë dy prej problemeve më të mëdha, të cilat kanë qenë edhe objekt diskutimi në edhe në takimin e nëntë të Nënkomitetit “Tregu i Brendshëm dhe Konkurrenca duke përfshirë Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Shëndetit”, që u mbajt në Bruksel, më datë 17 tetor 2017, ku shtetit shqiptar iu theksua pikërisht fakti se nga këto agjenci nuk ishte shpërndarë asnjë honorar për autorët, pavarësisht se subjektet OSHMA kishin paguar rregullisht tarifatat e vendosura njëanshmërisht dhe pa asnjë kriter nga agjencitë.

Përkundrazi, jo vetëm që nuk është treguar transparencë nga agjencitë, por pas çdo takimi që AMA kryente me palët e interesuara, Zyra Shqiptare të të Drejtave të Autorit (ende funksionale gjatë vitit të kaluar), ndërmerre fushata ndëshkimi kolektive ndaj subjekteve OSHMA që ankoheshin ndaj metodave dhe mungesës së transparencës së agjencive në fjalë. Aq represive kanë qenë këto masa sa që të gjitha vendimet për dënimin me gobë të tyre janë plotësuar direkt nga zyra e ZSHDA-së në të njëjtën datë.

Tani, me ndryshimin e legjislacionit për të Drejtat e Autorit, kontrolli për zbatimin e ligjit për të drejtat e autorit në tregun e brendshëm bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin nga inspektorati që mbulon fushën e mbikëqyrjes së tregut, pranë ministrisë përgjegjëse për tregtinë.

Problemi kryesor qëndron në mbivendosjen e të drejtave dhe detyrimeve që ligji për mediat audiovizive i ka caktuar AMA-s dhe atyre që ligji për të drejtat e autorit i ka caktuar inspektoratit të sipërcituar, të cilat, në rastin e ndëshkimeve administrative janë të njëjta. Për këtë arsye, AMA ka përgatitur një draft bashkëpunimi me Drejtorinë e të Drejtave të Autorit (DDA) pranë Ministrisë së Kulturës, si organ që koordinon dhe ndjek zbatimin e legjislacionit nga agjencitë kolektive për mbrojtjen e të drejtave të autorit. Aktualisht jemi në pritje të miratimit të këtij drafti, i cili ka mbetur për mendim tek Ministria e Kulturës, por që, për shkak të ristrukturimeve të saj ka mbetur ende pa përgjigje.

Në përfundim të sa më sipër, gjatë periudhës së raportimit është vënë re një rritje e ndjeshme e ndërgjegjësimin të subjekteve në lidhje me detyrimet që ata kanë në respektimin e të drejtave të transmetimit dhe të drejtave të autorit, ndërgjegjësim që pasqyrohet në dokumentacionin e depozituar prej OSHMA-ve për kalimin e të drejtave të transmetimit të programeve dhe në dokumentacionin përkatës për përmbushjen e

detyrimeve kundrejt agjencive të licencuara të administrimit kolektiv të të drejtave të autorit.

5. KËSHILLI I ANKESAVE

- Ndërgjegjësimi publik dhe ankesat e shqyrtuara

Konstituimi i Këshillit të Ankesave në vitin 2016 nxiti ndërgjegjësimin qytetar dhe ndërinstucional për të ngritur çështje të debatueshme mbi përmbajtjen e transmetimeve audiovizive. Gjatë vitit 2017, numri i ankesave dhe çështjeve të trajtuara u dyfishua në raport me vitin 2016 duke shenjuar një trend në rritje mbi ndërgjegjësimin qytetar dhe jo vetëm për të respektuar parimet themelore të veprimtarisë së transmetimeve audiovizive drejt standardeve më të arrira profesionale bashkëkohore, normat dhe kërkesat etike. Në vitin 2016 u regjistruan rreth 35 ankesa ku pjesa më e madhe e tyre shenjonte raste të cenimit të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve. Ankesat më së shumti vinin nga qytetarët dhe më pak nga institucionet publike apo agjenci të ndryshme që në fokus kanë mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut. Në vitin 2017 numri i tyre arriti në më shumë se 70, ku shumica prej tyre kish të bënte me cenimin e privatësisë, respektimin e dinjitetit dhe rregullave etike. Ankesat, gjatë vitit që lamë pas vinin, kryesisht prej një numri më të madh qytetarësh, agjencish dhe organizatash, përfshirë dhe rrjetet sociale, ku shqetësimet e shprehura atje janë trajtuar nga Këshilli i Ankesave po më të njëjtën korrektesë dhe shpejtësi. Shtimi i çështjeve të trajtuara, falë reagimit për çdo ankesë të ardhur në AMA, rriti ndërgjegjësimin e operatorëve audiovizivë për zbatimin më korrekt të Kodit të Transmetimit. Si dhe mund të konstatohet prej shifrave, pjesa më e madhe e ankesave të ardhura në këtë periudhë kohore dyvjeçare të vënies në funksion të Këshillit të Ankesave lidhet me cenimin e të drejtave të fëmijëve dhe të drejtave themelore të njeriut. Po për t'u evidentuar janë ankesat nga qytetarë të grupeve të ndryshme, lidhur me përmbajtjen e reklamave në transmetimet televizive. Rasti më i fundit i trajtuar nga Këshilli i Ankesave ishte reklama për një medikament mjekësor që transmetohej thuajse nga të gjithë operatorët televizivë. Nisur nga ankesat e shumta mbi përmbajtjen e reklamës në fjalë, AMA i kërkoi kompanisë farmaceutike të ndërhynte për të shmangur disa pjesë të reklamës, gjatë të cilës shfaqeshin skena dhune të skajshme dhe artificiale. Në mungesë të një versioni të dytë nga kompania, Këshilli i Ankesave kërkoi ndërprerjen e menjëhershme të reklamës nga transmetimet audiovizive. Kompania farmaceutike u tregua e gatshme për të hequr reklamën nga transmetimi që ditën që iu kërkua kjo nga Këshilli.

- Hartimi i Rregullores për procedurat e trajtimit të ankesave

Që prej krijimit të Këshillit të Ankesave, një prej objektivave të tij ishte nxitja e një komunikimi sa më të lehtë me publikun. Thjeshtëzimi i procedurës për t'u ankuar dhe shqyrtuar ankesat, u reflektua në miratimin e rregullores së re sipas kërkesave të ligjit. Rregullorja mbi "Procedurat për trajtimin e ankesave dhe ushtrimin e përgjigjes" sjell përmirësimin e mëtejshëm të veprimtarisë së Këshillit të Ankesave, por edhe të OSHMA-ve në trajtimin e problematikave mbi përmbajtjen audiovizive.

Ky dokument përcakton rregullat dhe procedurat për trajtimin e ankesave të paraqitura mbi programet e transmetuara prej ofruesve të shërbimit mediatik audio dhe/ose audioviziv dhe për ushtrimin e së drejtës së përgjigjes. Dispozitat e kësaj rregulloreje u hartuan në bazë edhe të ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë". Në këtë Rregullore është përshkruar edhe procedura për trajtimin e ankesave nga OSHMA-të, të

cilat duhet të shqyrtojnë çdo ankesë të arsyetuar të paraqitur me shkrim nga çdo person fizik ose juridik për programet e transmetuara prej tij.

- Rishikimi i Kodit të Transmetimit

Rishikimi i Kodit të Transmetimit u pa si nevojë e reflektimit të rasteve të shqyrtuara nga Këshilli i Ankesave mbi përmbajtjen e transmetimeve audiovizive. Nisur nga fakti se Kodi i Transmetimit ishte miratuar në vitin 2014, ai nuk mund t'u përgjigjej disa prej problematikave të reflektuara në ankesat e qytetarëve. Kontributi i Këshillit të Ankesave në këtë drejtim ka qenë rezultativ, ashtu si bashkëpunimi dhe koordinimi me drejtoritë e tjera në AMA, si Drejtoria e Programacionit dhe ajo Juridike. Këshilli i Ankesave, bazuar mbi përvojën dhe praktikën e deritanishme të trajtimit të ankesave, propozoi disa ndryshime në Kodin e Transmetimit me qëllim saktësimin dhe dhënien e përkufizimeve sa më të qarta të disa koncepteve të ndryshme të tij në funksion të zbatimit të Kodit të Transmetimit nga OSHMA-të.

- Anketimi me publikun

Anketimi me publikun lindi si nevojë e përmirësimit të Kodit të Transmetimit, por edhe si mënyrë për të përfshirë drejtpërdrejt opinionin publik në vlerësimin e performancës së Kodit të Transmetimit. Realizimi i dy anketimeve me mbi 200 qytetarë që u përkasin grupeve të ndryshme sociale dhe gjinore, u realizua në bashkëpunim me Departamentin e Gazetarisë dhe Komunikimit në UT. Rezultatet dhe përfundimet e nxjerra prej anketimeve u sugjeruan njëkohësisht si rekomandime edhe për përmirësimin e Kodit të Transmetimit, si dhe për ndërgjegjësimin e OSHMA-ve mbi përmbajtjet audiovizive.

Anketa e parë u krye gjatë periudhës qershor 2016 - dhjetor 2016. Ajo u realizua sipas projektit të hartuar nga Këshilli i Ankesave dhe iu besua Departamentit të Gazetarisë dhe Komunikimit të Universitetit të Tiranës, me të cilin AMA ka bashkëpunuar në vijimësi. Ky Departament realizoi zbatimin e metodologjisë mbi hulumtimin e tregut për të përcaktuar qëndrimet e publikut ndaj një sërë çështjesh me rëndësi dhe sensibilizuese për të. Pikë e rëndësishme e anketimit ishte thithja e mendimeve, perceptimeve mbi shkelje të mundshme të Kodit të Transmetimit në programet televizive. E gjithë kjo panoramë i shërbeu Këshillit të Ankesave gjatë procesit gjithëpërfshirës për rishikimin dhe përmirësimin e Kodit të Transmetimit.

Anketimi i dytë u krye gjatë periudhës janar - qershor 2017. Ai ishte më i plotë në të dhëna dhe përmbajtje, sepse dhe kërkesat tona ndaj performancës së Kodit të Transmetimit në programet audiovizive ishin më të detajuara dhe bazuar mbi ankesat e ardhura nga publiku dhe institucione të ndryshme. Në pyetjet e këtij anketimi jepen rezultate mjaft interesante nga publiku mbi disa prej sfidave kryesore që ka media shqiptare sot. Një gjetje është edhe reklama në media, duke njohur shqetësimin për reklamën e fshehtë. 67% e qytetarëve të pyetur mendojnë se ka reklamë të fshehur në median shqiptare. Po ashtu, ata japin mendimin e tyre se në cilin programacion i shohin këto reklama. Gjithashtu, anketimi ka edhe një vlerësim për reklamat dhe si i konsideron ato.

- Buletini i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave, çdo gjashtë muaj, boton një përmbledhje të përfundimeve të nxjerra në një buletin të veçantë që botohet nga AMA. Çdo ankesë e trajtuar dhe e shqyrtuar nga Këshilli i Ankesave, në bashkëpunim me drejtoritë e tjera në AMA, bëhet publike dhe transparente nëpërmjet këtij buletini periodik. Buletini përmban trajtimin, shqyrtimin dhe vendimarrjen e ankesave, duke shërbyer si udhërrëfyes për çdo OSHMA që mund të përballet në të ardhmen me raste të ngjashme. Publikimi i çdo ankesë të trajtuar ka nxitur ndërgjegjësimin e OSHMA-ve në përmirësimin e standardeve mbi zbatimin e Kodit të Transmetimit. Institucionet, organizatat jofitimprurëse apo individët kanë rritur vëmendjen ndaj problematikave të vërejtura në përmbajtjen audiovizive. Në buletinin e dytë të botuar nga AMA janë përfshirë rreth 20 ankesa të trajtuara, 14 prej të cilave ka patur vendimarrje, ndërsa 1 ankesë është rrëzuar, pasi i kishin kaluar afatet ligjore. Sipas tipit të ankesave, 8 janë për shkelje të të drejtave të fëmijëve; 8 për shkelje të etikës dhe dinjitetit; 3 ankesa me objekt të ndryshëm. Buletini i tretë i Këshillit të Ankesave sapo është përfunduar. Ky buletin i përket gjashtëmuajorit të dytë të vitit 2017, qershor - dhjetor 2017. Në këtë buletin janë përfshirë 22 ankesa, ku 7 prej tyre kanë pasur si subjekt cenimin e të drejtave të fëmijëve, 6 kanë pasur si subjekt cenimin e dinjitetit dhe personalitetit të njeriut, 5 prej tyre me natyrë tregtare etj.

- Konferenca dhe Tryeza

Gjatë vitit 2017, Këshilli i Ankesave ka organizuar disa tryeza/ konferenca që lidhen me problemet etike të programeve audiovizive. Konferencat dhe tryezat e rrumbullakëta, Këshilli i ka projektuar si një platformë efektive për komunikim dhe shkëmbim informacioni mes institucioneve dhe organizatave të ndryshme që fokus qendror kanë mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut, autoriteteve qeveritare dhe organizatave ndërkombëtare. Diskutimet dhe rekomandimet e bëra në këto tryeza kanë ndihmuar në hartimin e qasjeve të reja për veprimet e ndërmarra gjatë punës së Këshillit të Ankesave dhe propozimeve konstruktive që ai ka ngritur, në bashkëveprim me njësitë e tjera pranë AMA-s.

Gjatë kësaj periudhe, Këshilli i Ankesave ka vijuar takimet e tij me aktorë të ndryshëm të shoqërisë, për t'u shpjeguar rolin dhe detyrat e tij, në mbrojtje të parimeve themelore të sanksionuara nga Kodi i Transmetimit. Këto takime e përpjekje kanë shërbyer për të sensibilizuar shoqërinë që të adresojnë ankesat dhe shqetësimet e tyre, si dhe për të ndërgjegjësuar operatorët audiovizivë mbi respektimin e normave dhe parimeve të sanksionuara nga ligji.

Në këndvështrimin e Këshillit të Ankesave, të gjitha këto takime përfshihen në Planin e Veprimit që Këshilli i Ankesave pat ndërmarrë që në krye të herës. Në këtë Plan Veprimi një pikë e rëndësishme është dhe *Komunikimi Ndërveprues*. Në zbatim të kësaj strategjie, Këshilli po kujdeset që me qytetarët, aktorët dhe palët e interesuara të shpalosë komunikimin e drejtëpërdrejtë, si një mekanizëm më efikas për arritjen e objektivave të përbashkët. Paralelisht, Këshilli i Ankesave ka vijuar edhe me tryeza të rrumbullakëta, ku çështje që prekin shqetësimet e qytetarëve mbi përmbajtjet televizive janë në fokus të debateve mes partnerëve publikë.

- Takimi me temë “*Diskutime mes trupave rregullatore dhe partnerëve: Drejt përmirësimit të standardeve profesionale në produktet që ofrojnë shërbimet e medias*” ishte një aktivitet që mbledhi partnerë institucionalë si Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Mirëqënies dhe Rinisë, Komisionerin për Mbrojtjen e Të Dhënave Personale apo dhe atë të Mbrojtjes nga Diskriminimi, si dhe organizata të tjera joqeveritare që merren me të drejtat themelore të njeriut apo dhe të drejta të tjera. (prill 2017).
- Një nismë tjetër e Këshillit të Ankesave ishte dhe organizimi i një konference studimore në bashkëpunim me Departamentin e Gazetarisë në UT, me temë “*Fake news dhe sfida për të vërtetën në media*”. Ekspertët paraqitën punimet e tyre dhe sot ka një botim me kërkimet e tyre shkencore për këtë çështje. (tetor 2017)
- Organizimi i një tryeze të rrumbullakët me temë: *Mbrojtja e Fëmijëve në Shërbimet e Medias Audiovizive - Sfidat drejt së ardhmes*. Kjo tryezë synoi të promovojë kulturën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në transmetimet audiovizive, të rrisë ndërgjegjësimin e publikut dhe të gjithë aktorëve të interesuar mbi këtë çështje. Kjo tryezë u realizua në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale, Ministrinë e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, me Departamentin e Gazetarisë dhe Komunikimit, organizmave ndërkombëtarë, Institutin Shqiptar të Medias etj.
Në përmbushje të disa objektivave të caktuara, veç detyrave të përditshme të marrjes dhe trajtimit të ankesave, deri në një vendimmarrje të caktuar, Këshilli i Ankesave ka qenë aktor dhe ka kontribuar në disa aktivitete të përbashkëta me partnerë institucionalë dhe ndërkombëtarë si OSBE dhe KiE, ndër të cilët:
 - Konferenca tematike “*Liria e Shprehjes Online*”; Takimi rajonal i organizuar nga KiE mbi përgatitjen e një botimi: “*Mbi autoritetet rregullatore të medias dhe gjuha e urrejtjes*”; Mal i Zi, Beograd, Durrës (korrik 2016- shkurt 2017- korrik 2017).
 - Tryezë e rrumbullakët me Institutin Shqiptar të Medias me temë “*Edukimi për Median dhe Informacionin (EMI) në Shqipëri*”. (shkurt 2017, Tiranë).
 - Konferencë shkencore me temë “*Historia e medias dhe transformimet mediatike*”, organizuar nga Kolegji AAB. (Prishtinë, shtator 2017).
 - Tryezë e Rrumbullakët me Komisionerin Për Të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale me temë “*Ruajtja e privatësisë në media*”. (dhjetor 2017, Tiranë).
 - Forumi për Zhvillimin e Medias organizuar nga OSBE, mbi çështjet madhore të zhvillimit të medias në Shqipëri dhe u përqendrua tek arritjet dhe sfidat në transformimin e RTSH-së në një media publike, sfidat kryesore lidhur me lirinë e medias në vend, mbrojtja e privatësisë dhe aksesit në informacion, shpifja dhe fenomeni i lajmeve të rreme, si dhe te perspektivat e zhvillimit të vetërregullimit të medias në Shqipëri. (dhjetor 2017, Tiranë).

6. AUTORITETI NË PËRMBUSHJE TË ZBATUESHMËRISË LIGJORE

6.1. Plotësimi i akteve nënligjore të domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit të OSHMA-ve

Në funksion të rritjes së zbatueshmërisë ligjore, AMA ka përmbushur detyrimet e parashikuara në ligj, përmes miratimit të një sërë aktesh normative, përfshirë këtu edhe rishikimin e akteve nënligjore në fuqi. Nga ana tjetër, AMA ka hartuar edhe akte të tjera që janë në proces miratimi nga Autoriteti.

Procesi i plotësimit të kuadrit nënligjor është shoqëruar me realizimin e një procesi të gjerë këshillimi publik, në të cilin janë përfshirë si palë interesi, ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive, institucione publike, organizata joqeveritare si dhe organizmave ndërkombëtarë, si Organizata për Bashkëpunimin dhe Sigurinë në Evropë (OSBE) dhe Këshilli i Evropës.

AMA, në zbatim të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, ka miratuar aktet nënligjore si më poshtë:

- a. Rregullore “Për procedurat dhe kriteret e dhënies së autorizimeve”, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 99, datë 07.06.2017. Në këtë akt përcaktohen rregullat, kriteret dhe procedurat për dhënien dhe rinovimin e autorizimeve për ofrimin e shërbimeve mediatike audiovizive si dhe për përsëritjen e shërbimit të programit audiovizive të të tretëve, në rrjete të komunikimeve elektronike të ndryshme nga ato tokësore.
- b. Rregullore “Për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës lokale të transmetimit audioviziv në periudhën tranzitore”, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 100, datë 07.06.2017. Në këtë akt përcaktohet kriteret dhe rregullat për marrjen e licencës lokale të transmetimit audioviziv nga subjektet analogë vendorë që janë të licencuar për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv në zonën që planifikohet për t’u mbuluar nga një rrjet SFN.
- c. Rregullore “Mbi procedurat e inspektimit të veprimtarisë audiovizive të ofruesve të shërbimit mediatik audio dhe/ose audioviziv” miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 101, datë 07.06.2017. Me miratimin e këtij akti është plotësuar kuadri nënligjor për monitorimin dhe kontrollin e veprimtarisë programore, financiare, teknike dhe organizative të subjekteve audiovizive. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe procedurave për realizimin e të drejtës së të licencuarve dhe/ose të autorizuarve, në rastin kur AMA ushtron kontroll të veprimtarisë audiovizive të mbajtësit të një licence dhe/ose autorizimi.
- d. Rregullore “Për procedurat për trajtimin e ankesave dhe për ushtrimin e të drejtës së përgjigjes”, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 181, datë 11.09.2017, ku përcaktohen rregullat dhe procedurat që duhet të ndiqen nga Këshilli i Ankesave

në përmbushje të objektit të punës së tij të përcaktuar nga ligji organik, në drejtim të mbikëqyrjes së zbatimit të kodeve dhe rregulloreve, nga Ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv dhe Radio Televizioni Shqiptar dhe shqyrtimit të ankesave të depozituara në AMA. Duke pasur parasysh se ligji organik është tërësisht i përafëruar me *acquis communautaire*, edhe rregullimi i procedurave të shqyrtimit të ankesave është në përputhje me direktivën e BE-së 2010/13/EU “Për shërbimin mediatik me zë dhe figurë”.

- e. “Kodi i Transmetimit për median audiovizive”, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 228, datë 11.12.2017. Ky akt nënligjor, me të cilin është ndryshuar Kodi në fuqi i Transmetimit përmban dhe përcakton parimet, rregullat, kërkesat dhe praktikën e transmetimeve audiovizive në Republikën e Shqipërisë. Kodi i transmetimit është hartuar në zbatim të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- f. “Pagesat për licencë/autorizim dhe shërbimet që kryhen nga Autoriteti i Mediave Audiovizive”, me vendimin nr. 220, datë 01.12.2017. Përmes këtij akti janë miratuar ndryshime në vendimet ekzistuese për caktimin e pagesave për licencë, autorizim, shërbimet e tjera që kryhen nga AMA duke u përfshirë të gjithë llojet dhe masa e pagesave në një akt administrativ.
- g. Ndryshime në rregulloren “Për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës së transmetimit audio”, me vendimin nr. 192, datë 06.10.2017, me qëllim rregullimin e procedurës së rinovimit të licencave për ritransmetimin e programeve të huaja audio.
- h. Ndryshime në rregulloren “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për renditjen e shërbimeve audio dhe/ose audiovizive që mbështeten në rrjete numerike”, me vendimin nr. 196, datë 25.10.2017.
- i. *Projektregullore “Për komunikimet audio dhe/ose audiovizive me natyrë tregtare. Format, kushtet dhe koha ditore e lejuar për transmetimin e tyre”*. Kjo projektregullore përfshin dhe saktëson, në mënyrë të detajuar, kërkesat e ligjit për transmetimin e reklamave, oraret dhe ndërprerjet, kushtet dhe kërkesat për mbrojtjen e konsumatorit dhe sidomos fëmijëve, respektimin e rregullave të etikës në përmbajtjen dhe mënyrën e transmetimit të reklamave dhe komunikimeve tregtare, të papërcaktuara më parë në legjislationin shqiptar, si për shembull “vendosja e produktit” apo “dritaret e teleshitjeve”. Pas përfundimit të procesit të këshillimit publik, projekt rregullorja është në proces miratimi nga AMA.
- j. *Projektregullore “Mbi ofrimin e shërbimeve me akses të kushtëzuar”*. Objekti i kësaj projektregulloreje është përcaktimi i rregullave për ofrimin e shërbimeve me akses të kushtëzuar, për të siguruar lëvrimin e shërbimeve të mbrojtura tek abonentët me cilësi, në kushte të ndershme, të arsyeshme dhe jodiskriminuese. Projektregullorja përkufizon shërbimin e aksesit të kushtëzuar (*conditional access*), që është çdo masë apo rregullim teknik që mundëson marrjen në formë

të kuptueshme të shërbimeve të mbrojtura, kundrejt një autorizimi individual paraprak. Pas përfundimit të procesit të këshillimit publik, projekt rregullorja është në proces miratimi nga AMA.

- k. *Projektvendimi "Për miratimin e listës së ngjarjeve me rëndësi të madhe për publikun si dhe mënyrën e transmetimit pa pagesë të tyre nga OSHMA-ja e kualifikuar".* Nëpërmjet këtij vendimi AMA synon të përcaktojë shprehimisht ngjarjet të cilat konsiderohen se kanë rëndësi të madhe për publikun brenda territorit të Republikës së Shqipërisë sipas kriterëve të përcaktuara nga ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe të përcaktojë mënyrën e transmetimit pa pagesë të një ngjarjeje me rëndësi të madhe, nëse duhet të transmetohet direkt, i regjistruar apo në të dyja mënyrat dhe në të gjithë ose një pjesë të territorit të vendit. Ky vendim, përpara se ti nënshtrohet miratimit do t'i përcillet për mendim Ministrisë së Kulturës, Sportit, Turizmit, Këshillit të Ankesave, etj.
- l. *Projektudhëzimi "Për regjistrimin e transmetimeve",* në të cilin përcaktohen procedurat dhe rregullat që duhet të ndiqen për regjistrimin dhe arkivimin e programeve të transmetuara nga ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv. Aktualisht është hartuar drafti përfundimtar dhe ka filluar procedura e këshillimit publik.
- m. *Projektregullore "Për monitorimin e spektrit të frekuencave".* Qëllimi i këtij akti nënligjor është përcaktimi i procedurave të monitorimit të spektrit të frekuencave me qëllim që spektri i frekuencave të përdoret vetëm nga përdoruesit e lejuar duke synuar krijimin e një mjedis të përshtatshëm dhe pa interferenca të dëmshme për operimin e sistemeve dhe të stacioneve të transmetimit audioviziv, që do të përdoren për qëllime private ose publike. Aktualisht është hartuar drafti përfundimtar dhe ka filluar procedura e këshillimit publik.

6.2. Mbikëqyrja e shfrytëzimit të spektrit të frekuencave

Në kuadër të procesit të digjitalizimit, gjatë periudhës së raportimit është kryer monitorimi në të gjitha pikat transmetuese të vendit. Ky monitorim ka konsistuar në kontrollin e shfrytëzimit të spektrit të frekuencave në brezin 174 -230 Mhz dhe 470 – 862 për shërbimet audiovizive dhe 88 – 108 MHz për shërbimet audio.

Nga monitorimi është verifikuar:

- Mbulimi me sinjal i territorit nga operatori publik shqiptar, RTSH;
- Nëse brezi i frekuencave DD1 (790 -862 Mhz) është i lirë nga transmetimet audiovizive;
- Nëse spektri i frekuencave përdoret vetëm nga subjektet e licencuara nga AMA;

Monitorimet e kryera në kuadër të procesit të digjitalizimit të transmetimeve audiovizive:

Në kuadër të procesit të kalimit nga transmetimet analoge në transmetimet numerike janë kryer monitorime intensive në të gjithë Shqipërinë dhe, në mënyrë të veçantë, në qarqet Berat dhe Korçë ku u mbylleen transmetimet analoge përkatësisht në 15 gusht 2017 (në Berat) dhe në 8 janar 2018 (në Korçë).

Fokusi i monitorimeve ka qenë verifikimi i mbylljes së transmetimeve analoge, mbartja e operatorëve lokalë/rajonale në rrjetet kombëtare dhe përmbushja e kërkesave/kushteve të licencës nga operatorët numerik (realizimi i mbulimit të territorit me sinjal numerik, cilësia e sinjalit, numri logjik të programit etj).

Ndërkohë monitorimet vijojnë në qarkun e Fierit, i cili do të jetë qarku pasardhës ku do të mbylleen transmetimet analoge.

Në lidhje me mbulimin me sinjal të territorit nga operatori publik shqiptar, RTSH, theksohet se:

Vlen të nënvizohet se, pavarësisht fillimit të transmetimeve numerike dhe mbylljes me sukses të operatorëve analogë në allotmentet (qarqet) Berat dhe Korçë, disa zona të këtyre allotmenteve nuk mbulohet me sinjal nga operatorët kombëtarë të licencuar, në mënyrë të veçantë nga ana e RTSH, si i vetmi operator publik, që ka në shfrytëzim dy rrjete numerike.

Më konkretisht, nga operatori publik RTSH nuk mbulohen me sinjal numerik zonat:

1. Allotmenti Korçë:

- Voskopojë
- Dardhë
- Çërravë
- Mokër
- Aksi rrugor Korçë – Bilisht (Plasë, Kuç i Zi, rrëzë malit Moravë);

2. Allotmenti Berat:

- Njësia administrative Sinje.
- Tre lagjet pas Kalasë.

Në këto zona, pavarësisht se shtetasit janë të pajisur me dekodera DVB-T2, nuk arrijnë të marrin sinjalin tuaj numerik dhe, për rrjedhojë, të mos shohin asnjë prej programeve të RTSH-së.

Përveç sa më sipër, nga ana e RTSH nuk bëhet mbulimi me sinjal, as numerik dhe as analog, dhe nuk ofrohen shërbime audiovizive as në zonat si më poshtë:

1. Bashkitë:

- Himarë
- Memaliaj
- Bulqizë
- Klos
- Divjakë
- Gramsh

- Konispol
- Selenicë
- Këlcyrë
- Librazhd
- Vau i Dejës

2. Njësitë administrative dhe fshatrat:

- Rrëshen
- Qukës
- Dhërmi
- Qeparo
- Borsh
- Lukovë
- Maqellarë
- Lekbibaj
- Fierzë
- Pogë
- Razëm

Në lidhje me këtë AMA i ka kërkuar RTSH-së që të mundësojë menjëherë sinjalin në të gjitha këto zona, në mënyrë të veçantë, në zonat, pjesë e qarqeve ku ende nuk përfunduar procesi i digjitalizimit dhe mbyllja e sinjaleve analoge të operatorëve TV. Të paktën të mundësojë sinjalin analog, pavarësisht se kur do të përfundojë së implementuari sinjali numerik.

Në lidhje me lirim e brezit të frekuencave DD1 (790 - 862 Mhz):

Gjatë vitit 2017, AMA ka monitoruar përdorimin e brezit DD1 duke bërë të mundur migrimin në brezin 470-790 MHz të transmetimeve analoge në të gjitha pikat transmetuese ku ato ekzistojnë: Fushë-Dajt, Tarabosh, Kodra e Marinës, Himarë, Tepelenë, Berat, Kodër-Ishëm dhe Çardhak dhe mbylljen e transmetimeve numerike pa autorizim në pikat e transmetimit: Fushë – Dajt, Tarabosh, Tyrbe – Lezhë, Kodra e Marinës, Çardhak dhe Tushemisht.

Aktualisht është duke u punuar për mbylljen e tyre edhe në pikat e transmetimit: Zvërnec (Vlorë), Petresh (Elbasan) dhe Ardenicë (Fier)—subjekti Digitalb.

Në lidhje me përdorimin e spektrit të frekuencave vetëm nga subjektet e licencuara nga AMA:

Gjatë vitit të raportimit janë konstatuar:

- Subjekte që transmetojnë në mënyrë të paligjshme:
 - Radio “Vlora 6+1” – qyteti Vlorë
 - Radio “Re-Al” – qyteti Vlorë;
 - Radio Moor – qyteti Lezhë;

- Subjekte që transmetonin edhe pse AMA kishte vendosur shfuqizimin e licencës së tyre:
 - TV“ARV” – qyteti Pogradec
 - Radio “DJ” – qyteti Tiranë
 - Radio “Univers” – qyteti Tiranë
 - Radio “Aldo 03” – qyteti Tiranë
 - Radio “Italia” (me përsëritës) – qyteti Tiranë
 - Radio “Lezha” – qyteti Lezhë.

Të gjithë subjekteve të mësipërme u është bërë ndërprerja e menjëhershme e transmetimeve.

Krahas monitorimit të spektrit, vëmendje të veçantë gjatë vitit të raportimit i është kushtuar edhe trajtimit të ankesave për interference përcjellë në AMA nga vendet fqinje. Konkretisht, vlen të përmendet:

- Ankesa e shoqërisë “ALBtelecom” Sh.a. për interferencë shkaktuar në brezin GSM - 900 MHz në qytetin e Sarandës nga subjekti audioviziv TV “Tele-Jon”;
- Ankesa e shoqërisë “Telekom” Sh.a po në këtë brez në qytetin e Krujës nga subjekti TV “Kruja”.

Këto ankesa janë trajtuar me prioritet duke bërë të mundur eliminimin e tyre në mënyrë të menjëhershme.

Me prioritet maksimal janë trajtuar ankesat për interferencë, përcjellë në AMA nga vendet fqinje, konkretisht:

- Ankesat për interferencë janë paraqitur nga Mali i Zi dhe Italia dhe kanë lidhje me transmetimet (numerike & analoge) në brezin e frekuencave DD 1 (790 -862 Mhz).
- Me Agjencinë për Komunikime Elektronike dhe Shërbime Postare të Malit të Zi, gjatë vitit 2017 ka pasur komunikime të shpeshta në lidhje me interferencat e dëmshme. Nga këto komunikime është arritur dhe krijimi i grupeve të përbashkëta të punës për realizimin e matjeve të spektrit edhe në territorin e Malit të Zi.
- Ankesë për interferencë është paraqitur edhe nga Shërbimi Aeronautik i Maqedonisë, për interferencë në frekuencën 112.8 MHz shkaktuar nga sinjali i Radio Logos (Korçë).

Edhe në këto raste, AMA ka marrë masat e menjëhershme, duke eliminuar interferencat e shkaktuara.

7. AUTORITETI SI NXITËS I ZHVILLIMIT TË SEKTORIT AUDIOVIZIV

7.1. Angazhimi i Autoritetit në zhvillimet teknologjike të tregut audioviziv

Teknologjia digjitale po zëvendëson atë analoge jo vetëm në fushën e mediave audiovizive, por në të gjitha fushat. Përfitimet që sjellin këto teknologji janë të ndjeshme për

konsumatorin, për sipërmarrësit, si dhe për rritjen ekonomike të një vendi.

Nisur nga kjo, AMA me vendimin nr. 182, date 6.9.2016, ndërmori hapin për kalimin e plotë në teknologjinë digjitale të transmetimeve audiovizive mbështetur në rrjetin kabllor, duke i lënë si afat subjekteve ekzistues në treg për të ndryshuar teknologjinë e tyre analoge deri më datë 31.12.2017

AMA ka mbajtur të informuar subjektet e autorizuar për të ofruar shërbime mbështetur në rrjete kablore se afati i fundit i përdorimit të teknologjisë analoge është 31.12.2017. Ndërkohë ka autorizuar hyrësit e rinj në treg për ofrimin e shërbimeve audiovizive bazuar në teknologjinë digjitale.

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në bashkëpunim me Ministrinë e Inovacionit dhe Administratës Publike, në kuadër të Javës së Inovacionit më datë 17 maj 2017, organizuan konferencën me temë “Digital Switchover & Broadband Services”.

Në konferencë ishin të ftuar përfaqësues të rregullatorëve të pavarur AMA dhe AKEP, të operatorëve kryesorë në fushën e transmetimeve audiovizive dhe komunikimeve elektronike si dhe grupe interesi lidhur me median dhe komunikimet elektronike.

Zhvillimet teknologjike dhe tendencat e tregut audio/audiovizive dhe tregut mobile në Shqipëri për implementimin e teknologjive të reja ishin në fokus të këtij organizimi. Prezantimet e mbajtura sollën ndër të tjera, të rejat mbi teknologjitë e avancuara në rrjetet DVB-T2, revolucionin në teknologjitë mobile (e ardhmja e rrjeteve 5G), rrjetet/infrastrukturat e gjeneratës së ardhshme si dhe projektet për zhvillimin e broadband në Shqipëri.

7.2. Kontributi i Autoritetit në mbështetje të studimeve shkencore

Në vijim të sinergjisë mes Departamentit të Gazetarisë dhe Komunikimit në Fakultetin e Histori - Filologjisë në Universitetin e Tiranës dhe AMA-s, gjatë vitit 2017 u realizua studimi i tregut “Krizat e mediave televizive shqiptare dhe nevoja për një model të ri ekonomik”. Objekt ishte performanca e operatorëve audiovizivë në vendin tonë, për të evidentuar elementë të rëndësishëm që lidhen me modelin menaxherial, tregun e reklamave, për pronësinë dhe bashkëpronësinë në aktivitetin audioviziv, ndikimi në përmbajtjet e emetuara etj.

Studimi u mbështet në dy kolona: përfaqësuesit e operatorëve, si dhe mendimet e perceptimet e shikuesve. Bazuar në të dhënat e mbledhura në subjektet RTSH 1, Klan, Top Channel, Vizion Plus, News 24, Ora News, TV Kombi, Rozafa TV, Star Plus Tv, Tv 1 Chanel, si dhe dy platformat digjitale tokësore Digitalb dhe Tring, studimi përfshiu tregues miqs, edhe nga të licencuarit vendorë ashtu dhe ata kombëtarë, të cilët krijojnë një pikturë dhe faktojnë mbi një proces menaxherial, nën ndikimin e faktorëve të brendshëm të tregut (digjitalizimi), por dhe nga faktorë të jashtëm, jo mediatikë, edhe këto me ndikim të drejtpërdrejtë. Studimi përbën një dosje, ku secili prej aktorëve në treg kupton dinamikën, ku studiues, kërkues apo të interesuar të kësaj fushe gjejnë dukuri të aktualitetit dhe tendenca të së nesërme.

Të gjithë materialin studimor të përgatitur në kuadër të studimit, Departamenti e vendosi në qendër të një konference shkencore e titulluar “Modelet ekonomike të industrisë televizive

në Shqipëri”, një tjetër synim kryesor në kuadër të projektit “Krizat e mediave televizive shqiptare dhe nevoja për një model të ri ekonomik”. Referentët në këtë event nuk ishin vetëm nga pjesëmarrësit në studimin e tregut, por dhe të tjerë nga rradhët e pedagogëve, doktorantëve dhe kërkuesve të fushës mediatike, të cilët në këndvështrime të ndryshme sollën në auditor teza, mendime dhe argumente në favor apo si alternative për gjetjet dhe përfundimet e grupit të punës.

Konferenca u strukturua në dy seanca prezantimi dhe diskutimi. Në punimet e seancës së parë “Aspekte menaxheriale dhe të pronësisë në industrinë televizive”, fokusi ishte mbi probleme të tilla si, modelet e biznesit dhe strategjia-rasti i kompanive në Shqipëri; ndryshimet ligjore dhe format e pronësisë në media; tipare të pronësisë dhe bashkëpronësisë në tregun audioviziv; modeli i biznesit mes inovacionit dhe rezistencës së operatorëve; nevoja për formalitet në menaxhimin e televizioneve lokale; dhe televizionet lokale përballë kostove të digjitalizimit. Ndërsa në seancën e dytë përqëndrimi ishte në lidhjen mes performancës ekonomike të operatorëve dhe përmbajtjeve që transmetoheshin. Në këtë pjesë të konferencës që titullohej “Modelet e financimit dhe përmbajtja mediatike”, pati trajtime e diskutime mbi probleme të tilla si modelet e financimit të televizioneve në kushtet e përqendrimit të mediave; sinergjia e reklamës në televizion dhe në web; ndryshimet në konceptimin e reklamës në media në kushtet e zhvillimeve teknologjike dhe transformimeve mediatike; përmbajtja në ekranin e vogël si mundësi e re financimi për televizionet, raporti mes modelit të biznesit dhe përmbajtjeve mediatike; modeli i massmedias si ofruese informacioni dhe transfertat monetare me politikën; oferta televizive në web për audiencat shqiptare; si dhe të ardhurat e televizioneve në fushatën zgjedhore parlamentare të vitit 2017.

Në gjithë këtë proces, studimin e tregut dhe konferencën shkencore u angazhuan 25 pedagogë dhe kërkues shkencorë, si dhe 14 studentë që u aktivizuan me anketimet në qarkun e Tiranës dhe në të tjerë.

7.3. Bashkëpunimi në rregullimin e tregut audioviziv

Gjatë vitit 2017, AMA ka bërë sinergji me subjekte partnere që kontribuojnë në fushën e medias, përmes realizimit të projekteve të orientuara në kualifikimin dhe ndërgjegjësimin e redaksive audiovizive në përmirësimin e raportimit për aspekte të ndryshme përmbajtësore në programet që transmetohen. Synimi kryesor ka qenë dhe mbetet zbatimi i Kodit të Transmetimit, si dhe shumëllojshmëria dhe cilësia e programeve për ndjekësit, konkretisht :

- *Përmirësimi i raportimit mbi viktimat e dhunës me bazë gjinore, dhunës në familje dhe trafikimit*

Në partneritet me Rrjetit për Demokraci të Grave Shqipëri, WDN-Albania dhe AMA-s u mundësua realizimi i një projekti për ngritjen e kapaciteteve të redaksive audiovizive në përmirësimin e raportimit mbi viktimat e dhunës me bazë gjinore, dhunës në familje dhe trafikimit. Në mënyrë të drejtëpërdrejtë aplikimi i këtij projekti ka pasur investimin tek gazetarët dhe reporterët që punojnë në fushën audiovizive, për të ndarë me ta përvojën, si dhe për të ndikuar në respektimin e standardeve të Kodit të Transmetimit, si dhe kodeve të tjera të etikës.

Në aktivitetet forum dhe kualifikuese që janë zhvilluar me grupet e interesit në kryeqytet,

Vlorë, Shkodër e Lezhë, prezantimet dhe diskutimet mes të pranishmëve u përqëndruan në problematikën e barazisë gjinore, më specifikisht tek dhuna dhe trafikimi, si tematika që janë të ndjeshme për audiencën dhe transmetimeve audiovizive, si hapësira ku vihen re se ka shmangie nga kërkesat e Kodit të Transmetimit të AMA-s apo dhe akteve të tjera vetërregulluese në media.

WDN Albania paraprakisht eksploroji brenda komunitetit të gazetarëve audiovizivë në qarqet e sipërmendur, duke mbledhur të dhëna nga plotësimi i një pyetësi, ku u evidentuan një sërë çështjesh nga aktualiteti, asaj që ndodhte realisht. P.sh. që kronikat mbi dhunën me bazë gjinore kanë interes të veçantë për redaksitë, madje në shumë raste ngjarje të tilla janë hapëse për edicionet informative, sidomos kur dhuna ka shkaktuar viktima në humbje jetësh. Media audiovizive, produktet e saj në të gjitha formatet, luan rol ndërgjegjësues dhe sensibilizues për të tilla aspekte, sikundër në anën tjetër ka dhe qëndrime të kombinuara, ku media konsiderohet si një instrument kompleks informimi që luan një rol mes frenimit dhe nxitjes.

Produkt konkret i projektit ishte dhe hartimi i një manuali mbi përmirësimin e raportimit në media mbi problematikën e viktimave të dhunës me bazë gjinore, dhunës në familje dhe trafikimit, në formën e një ekstrakti udhëzimesh në sigurimin e standardeve profesionale në mediat audiovizive. Aspektet kryesore ishin mbi privatësinë dhe ruajtjen e konfidencialitetit, përshkrimin e karakteristikave fizike, promovimin e roleve dhe barazisë gjinore, cilësinë dhe ruajtjen e standardeve, gjetjet nga pyetësi mbi mbulimin nga mediat i dhunës me bazë gjinore, fëmijët dhe gratë viktima në transmetimet audiovizive etj. Manuali iu ofrua pjesëtarëve të redaksive që u trajnuan si një set përmbledhjeje për shkrimin e njohurive teorike të raportimit efektiv, të hulumtimeve rreth rasteve tipike dhe të përvojës praktike të gazetarëve, për të kuptuar më mirë problematikën dhe fushat e ndërhyrjes.

-Gazetari e përgjegjshme dhe etike

Projekti i aplikuar nga Qendra Media Aktive, “Gazetari e përgjegjshme dhe etike” kishte në vëmendje aspekte të zbatimit të Kodit të Transmetimit të AMA-s, si dhe kodit të etikës së gazetarëve përmes diskutimit dhe shkëmbimit të ideve e pikëpamjeve mbi çështje të tilla, si: etika në redaksinë e lajmeve; gazetari televiziv përballë pushtetit, dilemat etike, sfidat etike të së nesërme për gazetarinë televizive; Transmetuesi Publik, a mund të kthehet në shembullin për t’u ndjekur; “Fake News” dhe nevoja e shoqërisë për edukim mediatik; të drejtat e viktimave dhe të fëmijëve; simbolet kombëtare, simbolet fetare, të drejtat e pakicave etj.

Në etapën e parë u organizuan 14 seanca trajnimesh, ku pjesëmarrës ishin rreth 70 gazetarë të rinj, kurse në etapën e dytë të projektit u zhvillua një cikël bashkëbisedimesh me pjesëmarrjen e gazetarëve të njohur në fushën audiovizive, si Mentor Kikia, Blendi Fevziu, Alban Dudushi, Endri Xhafo, Enkel Demi dhe Blendi Salaj. Të ftuarit sollën për pjesëmarrësit përvojën e tyre të gjatë si gazetarë radiotelevizivë me shembuj dhe precedentë konkretë të dilemave etike, përballë të cilave gazetari televiziv gjendet vazhdimisht.

Aktivitetet e projektit kanë pasur dhe elementë aplikimi në angazhimet e gazetarëve pjesëmarrës, duke i përfshirë ata krahas trajtimeve teorike e bisedore, edhe në të ashtuquajturit Laboratorët në Studio, ku secili apo në ekip ushtrohej në një rrethanë faktike njësoj si në kushtet e punës reale, duke vënë në zbatim njohuritë e tyre. Në këtë mënyrë, seancat trajnuese kanë dhënë impakt për ndërgjegjësim tek pjesëmarrësit, duke forcuar bindjen se respektimi i kërkesave të Kodit të Transmetimit dhe rregullave të përgjithshme

etike është qasja më e mirë që një media audiovizive mund të krijojë me publikun e vet, pasi vetëm duke respektuar ndjeshmëritë, nevojat, pritshmëritë e publikut shqiptar do të jetë e mundur që media të plotësojë rolin që ajo ka në shoqëri.

- *Publiku përballë televizioneve: sfidat e sotme*

Instituti Shqiptar i Medias (ISHM) u mbështet gjatë vitit 2017 nga AMA për realizimin e një ankete me të rinjtë e shkollave të mesme në kryeqytet, nën kredon: “Media në prizmin e të rinjve”, si dhe zhvillimin e disa forumeve të diskutimit me studentët me temën “Televizioni dhe Qytetarët”. Dy produktet e ISHM-së ndërlihen në çështje shumë të rëndësishme që lidhen me tregun audioviziv, si dhe me edukimin mediatik, apo ajo që njihet si aftësia e audiencës për t’u orientuar, “lexuar” dhe “kuptuar” në përmbajtjet mediatike.

Anketa synoi tërheqjen e mendimeve nga të rinjtë rreth aktorëve të sotëm mediatikë, për të njohur nivelin e besimit që ata kanë tek mediat, mënyrën e informimit, nevojat dhe preferencat e tyre, portretizimin e tyre specifik në programet radiotelevizivë. Rreth 500 gjimnazistë, 16-18 vjeç, iu përgjigjën pyetësorëve, duke identifikuar qëndrimet dhe prirjet e tyre në lidhje me televizionin, besimin dhe rolin që ka ai në jetën e tyre, internetin apo burime tradicionale të informacionit dhe edukimit, si librat e shkolla etj., si një qasje gjithëpërfshirëse në lidhje me burimet e informacionit dhe besueshmërinë e peshën që ka secili burim në jetën e tyre. Pas mbledhjes së të dhënave, përpunimit dhe prezantimit të tyre në një botim të posaçëm, në fazën përmbyllëse të këtij komponenti, ISHM zhvilloi një takim forum në Tiranë me përfaqësues të medias, të rinj dhe ekspertë, të cilët diskutuan gjetjet kryesore dhe rekomandimet e testimit/sondazhit “Media në prizmin e të rinjve”. Botimi ka si target redaksitë mediatike dhe mbi të gjitha të rinjtë.

Ideimi dhe organizimi i katër forumeve në një format bashkëbisedimi mes të ftuarve dhe studentëve (Shkodër, Elbasan, Durrës dhe Tiranë), u përqendrua kryesisht te gjendja e medias sot, mënyra se si e shohin atë studentët dhe qytetarët, si dhe problemet kryesore që ka me imazhin e medias, të ndërthurur edhe me politikën. Përballë të ftuarve nga rradhët e personazheve kryesore mediatike, diskutimi u orientua dhe tek çështje të tilla, si vetëcensura, rregullimi i marrëdhënieve të punës, ndërhyrjet ose presioni i perceptuar nga faktorë të jashtëm, por edhe brenda redaksisë, aspekte të formimit të tyre profesional, duke u ndalur edhe te roli i universiteteve në edukimin e brezit të ri etj.

- *Mbrojtja e fëmijëve në transmetimet audiovizive*

Qendra Shqiptare për Komunikim Publik, ACPC, e mbështetur nga AMA, përgatiti një manual orientues për gazetarët, redaktorët dhe reporterët që punojnë në median audiovizive: “Udhëzuesi mbi raportimin e ngjarjeve dhe tematikës mbi të miturit në televizionet shqiptare”. Si produkt i një projekti mbi mbrojtjen e fëmijëve në transmetimet audiovizive, manuali trajtonte praktikisht aspekte të tilla si: fëmijët dhe media, përgjegjësia dhe roli edukativ i medias; përdorimi i imazhit të të miturve me qëllim tërheqjen e audiencës; kuadri legjislativ vendas dhe ndërkombëtar; standardet deontologjike dhe etike rreth transmetimeve mbi ta.

Ky produkt didaktik e zgjeron rrezet e përfituesve nga projekti, duke qenë një bazë e mirë teorike dhe praktike nga angazhimet e përditshme të redaksive audiovizive, jo vetëm ata që

u përfshinë në serinë e eventeve trajnuese, por dhe të tjerë që do ta marrin në duar këtë material.

Përfaqësues të redaksive audiovizive në qarqet e Tiranës, Shkodrës, Elbasanit, Korçës dhe Vlorës janë përfshirë në serinë e trajnimeve dhe diskutimeve të përbashkëta të zhvilluara në kuadër të projektit të ACPC. U aplikuan dy nivele trajnimi dhe diskutimi me përfituesit e projektit: duke u fokusuar në grupe të përbashkëta të një qarku dhe, së dyti, duke zbatuar formatin e trajnimit “in house”. Për versionin e parë diskutimet kanë qenë mbi aspekte të veçanta të Kodit të Transmetimit dhe zbatimi i tyre konkret, ku kanë dominuar më shumë tematikat që lidhen me mbrojtjen e të miturve, por dhe evitimi i rasteve që frymëzojnë intolerancën dhe gjuhës së urrejtjes.

Në trajnimet “in house”, ACPC ka përzgjedhur redaksi të veçanta dhe ekspertët e saj janë investuar konkretisht në trajtimin e situatave të përditshme në kushtet reale të punës në media të qarqeve që janë target. Ky është një element i dobishëm i kualifikimit duke punuar dhe konsultuar në grupe të vogla apo tek individi, në rrethana të asaj që ai planifikon dhe realizon çdo ditë. Qendra ka organizuar dhe dy workshop-e në Tiranë me pjesëmarrjen jo vetëm të gazetarëve dhe redaktorëve nga mediat audiovizive, por dhe të ekspertëve, studentëve të gazetarisë, duke vënë në qendër më shumë pjesët e Kodit të Transmetimit të AMA-s për mbrojtjen e fëmijëve.

8. KALIMI NË TRANSMETIMET NUMERIKE

Në Planin e Veprimit të Dokumentit Strategjik të AMA-s janë planifikuar veprimtaritë me përparësi, si dhe rezultatet e pritshme për përmbushjen e qëllimeve strategjike, të ndara në afate (për periudhën 2017-2019), ku ndër të tjera renditet edhe procesi i Kalimit në Transmetimet Numerike.

AMA është angazhuar maksimalisht në përmbushje të veprimtarive të planifikuara në Dokumentin Strategjik, me qëllimin final për të përfunduar me sukses procesin e digjitalizimit të transmetimeve audiovizive.

Referuar afatit të përcaktuar për mbylljen e transmetimeve analoge në qarqet Tiranë - Durrës (30 qershor 2017), Sekretariati Teknik, struktura e posaçme e ngritur në zbatim të strategjisë për kalimin nga transmetimet analoge në ato numerike, për ndjekjen e procesit të digjitalizimit, në mbledhjen e zhvilluar më 7 qershor 2017, ka konkluduar se mbyllja e transmetimeve analoge si fillim në një allotment me popullsi të vogël do të përcaktonte dhe plotësonte me lehtë kërkesat e qytetarëve për marrës televizivë numerikë, dhe në rast të problematikave të paparashikuara do të kishte një impakt më të vogël krahasuar me qarqet me popullsi më të madhe.

Për më tepër, AMA nuk ka ndërmarrë fushatën e informimit të publikut për mbylljen e transmetimeve në qarqet Tiranë-Durrës, sipas afateve të Strategjisë (3 muaj përpara datës së mbylljes së transmetimeve analoge), për shkak të mungesës së akordimit të fondeve nga Buxheti i Shtetit, për mbulimin e kostove të kësaj fushate. Referuar Planit të Veprimit, miratuar me Strategjinë e vitit 2012, AMA merr përsipër kryerjen e fushatës informuese, vetëm nëse sigurohet financimi përkatës nga Buxheti i Shtetit.

Si pasojë, allotmenti i parë ku u mbyllën transmetimet analoge, në datën 15 gusht 2017, ishte qarku i Beratit. Më pas procesi i digjitalizimit vijoi me mbylljen e transmetimeve analoge në qarkun e Korçës. Afati i përcaktuar për mbylljen e transmetimeve analoge në qarkun e Korçës, data 15 nëntor 2017, u zhvendos më datë 8 janar 2018 për shkak të situatës së reshjeve në vend dhe më pas me kërkesë të RTSH-së, duke qenë se procesi po ndodhte pranë festave të fundvitit dhe mund të sillte problematika lidhur me mbulimin e zonave të caktuara me shërbim. Tashmë janë mbyllur transmetimet analoge në qarqet Berat dhe Korçë dhe procesi po vijon me mbylljen e transmetimeve analoge në qarkun e Fierit, më datë 31 mars 2018.

Fushata e informimit të publikut për qarqet Berat dhe Korçë është realizuar vetëm përmes njoftimeve me titra, dhe jo përmes emisioneve speciale, spoteve publicitare, për shkak të mungesës së fondeve, ndërkohë për qarkun e Fierit do të vijojë me anë të spoteve publicitare, meqë me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 708, datë 1.12.2017 Autoritetit të Mediave Audiovizive i akordohet fondi prej 40,000,000 (dyzetmilionë) lekësh për financimin e fushatës për informimin e publikut për kalimin nga transmetimet analoge në ato numerike.

8.1. Digjitalizimi i transmetimeve audiovizive të operatorit publik

AMA, në përmbushje të detyrave dhe funksioneve të përcaktuara në ligjin 97/2013, Strategjinë për kalimin nga transmetimet analoge në transmetimet numerike, si dhe Planin Strategjik të Veprimit, ka ndjekur me prioritet implementimin e procesit të digjitalizimit të transmetimeve audiovizive.

Në mënyrë të veçantë, në fokus të AMA-s ka qenë implementimi i rrjeteve numerike të operatorit publik shqiptar (RTSH) dhe zbatimi nga ana e tij i kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në Kontratën e Shërbimit. Kjo për arsyen se nëpërmjet rrjeteve numerike të RTSH-së publikut shqiptar do t'i ofrohen më shumë kanale televizive pa pagesë, pra do të rritet numri i programeve të ofruara nga RTSH (aktualisht RTSH transmeton në numerik 10 kanale), si dhe për faktin se në njërin nga rrjetet numerike të saj do të mbështesin programin e tyre audiovizivë edhe operatorët lokalë/rajonalë ekzistues në treg.

Gjatë vitit 2017, AMA ka zhvilluar korrespondenca të vazhdueshme me RTSH-në dhe ka organizuar takime në nivele të larta e nivele teknike, me qëllimin për t'u paraprirë problematikave që mund të haste implementimi i procesit të digjitalizimit.

Procesi i digjitalizimit në allotmentet e Beratit dhe Korçës, edhe pse përfundoi sipas afateve të përcaktuara (respektivisht në datat 15 gusht 2017 dhe 8 janar 2018 janë mbyllur transmetimet analoge në këto qarqe), rezultoi me probleme në lidhje me mbulimin e të gjithë territorit me sinjal numerik nga ana e RTSH-së. Zona të caktuara të këtyre qarqeve për shkak të relievit kodrinor apo malor nuk mund të aksesonin transmetimet audiovizive numerike. AMA ka koordinuar punën me operatorin publik shqiptar (RTSH), operatorët privatë kombëtarë numerikë dhe operatorët lokalë/rajonalë të qarqeve Berat dhe Korçë në mënyrë intensive me qëllim realizimin më të mirë të mbulimit të territorit me shërbim. Gjithashtu ka kryer monitorime të vazhdueshme në terren për të verifikuar situatën, edhe në përgjigje të ankesave të ardhura nga banorët e këtyre qarqeve.

AMA ka vijuar ndërkaq fushatën e informimit publik për të njoftuar publikun mbi afatet e mbylljes së transmetimeve analoge në qarqet Berat dhe Korçë, si dhe për ta ndërjegjësuar atë mbi veprimet që duhet të ndërmarra për të përfituar transmetimet numerike. Aktualisht po vijon fushata për informimin e publikut mbi mbylljen e transmetimeve analoge në qarkun e Fierit më datë 31.03.2018.

Proceset dhe aktivitetet e ndjekura nga AMA për qarqet Berat dhe Korçë do të vijojnë të ndiqen edhe për digjitalizimin e transmetimeve audiovizive në qarqet e tjera të vendit, përgjatë vitit 2018.

8.2. Digjitalizimi i transmetimeve audiovizive kombëtare private

Aktivitetet e ndërmarra në kuadër të procesit të digjitalizimit kanë pasur në fokusin e tyre edhe bashkëpunimin apo koordinimin me 5 operatorët privatë numerikë kombëtarë të licencuar nga AMA.

Koordinimi ka konsistuar në përcaktimin dhe respektimin e afateve për mbylljen e transmetimeve analoge, gjetjen e zgjedhjeve teknike për mbështetjen e operatorëve lokalë/rajonalë ekzistues në rrjetet e tyre, përmbushjen e kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në licencë, ku në mënyrë të veçantë janë trajtuar problemet lidhur me mbulimin e territorit të shërbimit me sinjal, si dhe cilësia e shërbimit. Tjetër aspekt ka qenë edhe respektimi i numrave logjikë (LCN) nga këta operatorë për programet e veta dhe programet e operatorëve lokalë/rajonalë që janë mbështetur në rrjetin e tyre.

Zbatimi i rendit të implementimit në mënyrë të unifikuar nga të gjithë operatorët kombëtarë (publik dhe privat), lejon zbatimin e dispozitës ligjore mbi mbështetjen e operatorëve lokalë/rajonalë në rrjetet kombëtare numerike, duke u dhënë atyre mundësinë të zgjedhin operatorin kombëtar ku ata duan të mbështesin programet e tyre audiovizive. Nëse rendi i implementimit nuk do të ishte i unifikuar, atëherë operatorët lokalë/rajonalë nuk do të kishin mundësi zgjedhjeje.

Sa u takon përmbushjes së kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në licencë, duke i dhënë rëndësi të veçantë mbulimit të territorit me shërbim dhe me cilësi sinjali audiovizive, AMA ka kryer monitorime të përsëritura në terren. Në rastin e identifikimit të zonave të pambuluara me sinjal është kontaktuar me operatorët privatë kombëtarë, duke u kërkuar gjetjen e zgjedhjeve të shpejta.

Operatorët privatë kombëtarë numerikë u janë përmbajtur afateve të përcaktuara nga AMA për mbylljen e transmetimeve analoge në qarqet Berat dhe Korçë dhe, ndërkohë po vijojnë punën për të finalizuar procesin e digjitalizimit në qarkun e Fierit, si dhe për shtrimin e infrastrukturës numerike edhe në qarqet e tjera të vendit.

8.3. Digjitalizimi i rrjeteve analoge të operatorëve ekzistues

Digjitalizimi i rrjeteve analogë vendorë ekzistues përbën detyrim ligjor dhe alternativat për kalimin në transmetimet numerike të këtyre operatorëve janë të parashikuara në ligjin nr.

97/2013 të ndryshuar, si dhe në Strategjinë për kalimin nga transmetimet analoge në ato numerike, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 292, datë 02.05.2012.

Këto alternativa janë:

1. Mbështetja e programeve analogë ekzitues vendorë në rrjetin numerik të televizionit publik ose rrjetet e tjera numerike

Referuar sa më sipër, AMA ka kërkuar në mënyrë të përsëritur nga subjektet televizive depozitimin e kontratës së mbështetjes në rrjetin numerik që do të përzgjidhet prej tyre. Aktualisht janë depozituar kontratat e nënshkruara me RTSH nga 9 (nëntë) operatorë audiovizivë.

AMA ka detyrimin të sigurojë vijimësinë e transmetimeve televizive nga operatorët ekzitues analogë në zonat respektive të mbulimit, duke bërë të mundur që programet analoge ekzituese të vijojnë të transmetohen hapur (pa pagesë) edhe pasi të mbështeten në platformat numerike.

2. Aplikimi bashkërisht për një licencë rrjeti numerik vendor brenda një zone të planifikuar për t'u mbuluar nga një rrjet SFN, sipas planit të frekuencave numerike;

Per zbatimin e këtij parashikimi ligjor, AMA, me vendimin nr. 100, datë 07.06.2017 ka miratuar rregulloren "Për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës lokale të transmetimit audioviziv në periudhën tranzitore".

Në këtë rregullore përcaktohen kriteret dhe rregullat që duhet të përmbushen dhe respektohen për marrjen e licencës lokale të transmetimit audioviziv nga subjektet analogë vendorë që janë të licencuar për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv në zonën që planifikohet për t'u mbuluar nga një rrjet SFN.

Miratimi i këtij akti nënligjor i ka hapur rrugë procesit të lëshimit të licencave të transmetimit audiovizive lokale, duke garantuar jo vetëm kalimin në transmetimet numerike të subjekteve të licencuar për transmetime analoge, por edhe lëshimit të licencave të shërbimit të programit audioviziv për këto subjekte.

Në rast se nuk do të përzgjidhet asnjë nga dy alternativat e mësipërme, AMA do të procedojë shpalljen e konkurrimit për licencimin e rrjetit numerik lokal.

AMA ka organizuar takime konsultative edhe me operatorët televizivë lokalë dhe rajonalë, në ambientet e AMA-s, si dhe në qarqet Berat dhe Korçë, për të diskutuar nga afër shqetësimet dhe problematikat lidhur me mbështetjen e programeve të tyre në rrjetet kombëtare numerike.


Operatorët lokalë/rajonalë të qarqeve Berat dhe Korçë, ku edhe ka përfunduar procesi i digjitalizimit, kanë mbështetur programet e tyre tek rrjeti numerik i operatorit publik. Megjithë procesin koordinues dhe konsultues të zhvilluar nga AMA me operatorët analogë vendorë lidhur me mbështetjen e tyre në një nga rrjetet e operatorëve kombëtarë, në

allotmentet e Beratit dhe Korçës çështjet e nënshkrimit të kontratave të mbështetjes dhe aspektet teknike të përcjelljes dhe lidhjes së operatorëve analogë vendorë hasën vonesa të konsiderueshme, duke gjetur zgjidhje vetëm në prag të arritjes së afatit.

Së fundmi, AMA ka vendur korrespondencë me operatorët lokalë/rajonalë ekzistues të qarkut Fier, ku edhe do të vijojë procesi i digjitalizimit, me qëllim përmbushjen e afatit për mbylljen e transmetimeve analoge në këtë qark. Qarku i Fierit është ndër qarqet me numër të konsiderueshëm të operatorëve lokalë/rajonalë (gjithsej 16 operatorë lokalë/rajonalë), i dyti pas allotmentit të Tiranës, ndaj angazhimi i AMA-s do të jetë maksimal në të gjithë aktivitetet që do të ndërmerren.

MBULIMI I TERRITORIT ME TRANSMETIME NUMERIKE

Mbulimi i territorit të Shqipërisë me transmetime numerikë



8.4. Procesi i migrimit të frekuencave

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), në kuadër të procesit të digjitalizimit, ka ndjekur me prioritet procesin e lirimimit të kanaleve frekuencorë të Planit GE06 (të miratuar nga AMA për ndërtimin e rrjeteve kombëtarë të transmetimit numerik) të zëna nga operatorë televizivë të transmetimit analog dhe migrimin e tyre në frekuenca që nuk janë të përfshira në Planin GE06.

Procesi i migrimit të frekuencave është i rëndësishëm për faktin se garanton mosndërprerjen e transmetimeve audiovizive nga operatorët aktualë në treg, duke mbrojtur konsumatorin fundor, i cili do të vijojë të aksesojë pa ndërprerje transmetimet audiovizive.

Procesi i migrimit të frekuencave është kryer në zbatim të planit/grafikut të migrimit të frekuencave të hartuar nga AMA. Gjatë vitit 2017 është bërë i mundur lirimi i frekuencave të përcaktuara për ndërtimin e rrjeteve numerike kombëtare në të gjitha qarqet e vendit.

8.5. Lirimi i brezit të Dividendit Digjital

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 29.03.2017 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave” brezi 790-862 MHz (brezi DD1) duhet të lirohej plotësisht nga përdorimet për transmetimet audiovizive brenda datës 30 qershor 2017. Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike nxori udhëzimin nr. 1, datë 11.04.2017 “Për zbatimin e Planit Kombëtar të Frekuencave për lirimin efektiv të frekuencave të Dividendit Digjital nga transmetimet audiovizive”. Ky udhëzim ngarkonte Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA) dhe Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për ngritjen e një grupi të përbashkët pune për monitorimin e procesit të lirimimit të brezit DD1 nga transmetimet audiovizive në gjithë territorin e vendit.

Bazuar në udhëzimin e sipërcituar, AMA dhe AKEP me urdhrin nr. 88, datë 18.04.2017 kanë ngritur grupin e përbashkët të punës “Për monitorimin e procesit të lirimimit të Dividendit të parë Numerik (DD1) nga transmetimet audiovizive në të gjithë territorin e vendit”, i cili zhvilloi takimin e parë menjëherë pas daljes së urdhrin (datë 21.04.2017) në kuadër të përshtetimit të procesit të lirimimit të brezit DD1.

Në zbatim të detyrave të ngarkuara në urdhrin nr. 88, datë 18.04.2017, AMA hartoi planin e monitorimit të brezit DD1 në të gjithë vendin dhe më pas grupi i përbashkët AMA-AKEP në zbatim të këtij plani kryen monitorimet në terren.

Ndërkohë, paraprakisht që në muajin mars 2017, AMA ka njoftuar të gjithë operatorët audiovizivë, të cilët kishin në përdorim kanalet frekuencore të brezit DD1 për ofrimin e transmetimeve analoge, që të lirojnë këto kanale dhe të migrojnë në kanale të tjera të përcaktuara nga AMA. Korrespondencat kanë vijuar edhe më pas, si dhe janë zhvilluar takime të përsëritura me operatorët lokalë/rajonalë/kombëtarë. Në sajë të këtyre aktiviteteve është bërë e mundur lirimi i frekuencave që kishin në përdorim operatorët për transmetimet analoge (gjithsej 10 operatorë), si dhe operatorët për transmetimet numerike.

AMA ka monitoruar në terren përdorimin e brezit 790-862 MHz nga operatorët audiovizivë. Nga monitorimet e kryera në dhjetor 2017 rezulton se kanalet frekuencorë të këtij brezi janë

liruar nga 15 operatorë në 45 pika transmetimi. Po gjatë këtij muaji ka vijuar puna për lirimin e tre pikave të transmetimit të mbetura.

8.6. Fushata e informimit të publikut

Strategjia e Kalimit nga Transmetimet Analoge në Transmetimet Numerike përcakton AMA-n si autoritetin përgjegjës për realizimin e fushatës së informimit të publikut. Duke qenë se procesi i kalimit nga transmetimet analoge në ato numerike është jo vetëm një proces prioritar për të gjitha vendet evropiane, pjesë e BE ose jo, por mbi të gjitha është një proces me ndikim të gjerë në gjithë shoqërinë shqiptare, AMA, prej muajit prill të vitit 2016, por edhe gjatë vitit 2017 ka vënë në dispozicion numrin e Call Center (04-410-44-55 dhe 04-410-44-56). Këto dy numra janë në dispozicion të të gjitha pyetjeve të qytetarëve apo operatorëve nga ora 9.00 deri në orën 21.00, çdo ditë të javës.

Gjithashtu, në rubrikën “Digjitalizimi” në faqen online zyrtare të institucionit, AMA nxjerr njoftime dhe mban të informuar në kohë reale të gjitha palët e interesuara në lidhje me kuadrin rregullator, planin numerik frekuencor, të dhëna të përgjithshme mbi procesin, broshurën dhe fletëpalosjen e përgatitur nga AMA për digjitalizimin, kontaktet e strukturës Call Center, linkun që të çon direkt në faqen e rrjetit social facebook të AMA-s, si dhe të gjitha intervistat e emisioneve speciale mbi digjitalizimin e transmetimeve audiovizive të realizuara nga stafi i AMA-s.

Në adresën zyrtare të Autoritetit info@ama.gov.al vijnë, ndër të tjera, edhe pyetje të rastësishme të qytetarëve në lidhje me digjitalizimin e transmetimeve. Sipas specifikës së pyetjes, ajo i dërgohet për përgjigje drejtorisë përkatëse, e cila përgatit përgjigjen brenda afateve të përcaktuara nga ligji 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Në kuadër të fushatës informuese, AMA ka krijuar dhe llogarinë e saj në facebook “Autoriteti i Mediave Audiovizive – Digjitalizimi”, ku publikohen të gjitha informacionet në lidhje me procesin. Po ashtu, të gjitha pyetjeve që vijnë në postën private të kësaj adrese marrin përgjigje me të njëjtën procedurë si ato që vijnë në adresën info@ama.gov.al.

Gjithashtu, bazuar në planin e shtrirjes së transmetimeve digjitale, Autoriteti i Mediave njofton me spote televizive për shtrirjen e procesit dhe masat që duhet të marrin përdoruesit e mediave audiovizive për të vijuar shikimin e transmetimeve audiovizive.

Theksojmë se AMA do të vijojë me informimin e publikut mbi procesin dhe zhvillimet e tij deri në momentin kur transmetimet digjitale të jenë aktive në të gjithë territorin e vendit.

Gjatë vitit 2017 janë pritur rreth 2000 telefonata nga struktura Call Center.

- Në 6-mujorin e parë pyetjet më të shpeshta kanë qenë:
 1. Kur fillon procesi i digjitalizimit në zona të ndryshme të Shqipërisë?
 2. Pyetje për koston e dekoderit, pikën e shitjes?
 3. Pyetje mbi numrin e kanaleve që do të shfaqen?
 4. Kur do të përfundojë procesi i digjitalizimit?
- Qytetet nga kanë ardhur më shumë telefonata janë: Elbasani, Librazhdi, Korça, Shkodra, Lezha etj.
- Telefonatat më të shpeshta janë bërë nga meshkujt.

8.7. Kontrata AMA - RTSH

Pas miratimit të Kontratës së Shërbimit të transmetimit publik nga AMA, (vendimi nr. 18.02.03.2017), sipas kërkesave të ligjit 97/2013, fokusi i Autoritetit ka qenë në vijueshmëri ndjekja e zbatimit të termave të referencës së kësaj Kontrate. Pikërisht, pas 6 muajsh nga miratimi i këtij dokumenti, që për RTSH-në është e barazvlerëshme me licencën, AMA realizoi në muajin shtator 2017 një shqyrtim vlerësues rreth krijimit të platformës programore me 12 kanale të Transmetuesit Publik, si dhe nivelin e mbulimit me sinjal të emetimit në territorin e vendit.

Në konceptimin dhe realizimin e shqyrtimit u mbajt parasysh që:

- AMA kryen monitorime për nivelin e mbulimit me sinjal të transmetimeve nga subjektet audio dhe audiovizive;
- faza tranzitore e kalimit nga analogu në transmetimet numerike dhe Kontrata e Shërbimit e ka vendosur RTSH-në përpara sfidash e detyrimesh të reja lidhur me strukturën programore, natyrën, llojin dhe përmbajtjen e programeve;
- rëndësi ka larmia, shumëllojshmëria e programeve gjeneraliste, përcaktimi strukturor dhe cilësia në rritje e programeve tematike (kanaleve të dedikuara);
- shqyrtimi shërben jo vetëm për të thelluar njohjen dhe evidentimin e problematikave të transmetimit të përmbajtjeve të RTSH-së, por edhe për t'i ardhur në ndihmë transmetuesit publik përmes një procesi komunikimi institucional me AMA-n.

Shqyrtimi vlerësues i AMA-s u përqendrua në të gjitha programet (kanalet) gjeneraliste: RTSH 1, RTSH 2, RTSH 3 dhe ato tematike: RTSH SHQIP, RTSH 24, RTSH MUZIKË, RTSH FILM, RTSH SPORT, RTSH KUVENDI të platformës digjitale tokësore të RTSH-së.

Në nenin 6 të Kontratës saktësohet se RTSH do të ofrojë për publikun 12 programe (8 programe SD dhe 4 programe HD), nga të cilat 7 programe do të nisin transmetimet brenda muajit mars 2017, ndërsa programet e tjera brenda vitit 2017. Nga shqyrtimi vlerësues i muajit shtator 2017 rezultoi se RTSH kishte:

- tre programe gjeneraliste (RTSH 1, RTSH 2, RTSH 3);
- katër programe tematike RTSH SHQIP, RTSH MUZIKË, RTSH FILM, RTSH SPORT;
- gjithashtu transmetonte edhe në dy kanale të tjera, RTSH 24 dhe RTSH KUVENDI, por RTSH 24 transmetonte të njëjtat programe (identike si strukturë dhe përmbajtje) me programin RTSH Shqip, kurse RTSH KUVENDI nuk transmetonte përmbajtje (kishte vetëm sigël dhe kolonë zanore që përsëritej pa ndërprerje, në çdo orë e ditë transmetimi), ndërkohë që punimet e Kuvendit emetoheshin në RTSH 1.

Nga pikëpamja sasiore rezultoi i përmbushur detyrimi i parashikuar në Kontratën e Shërbimit të Transmetimit Publik. Por nëse përqasim llojet e programeve aktuale të RTSH me Katalogun e Programeve të parashikuar në Kontratë rezultoni të papërmbushur ende:

- dy programe (kanale) tematike për fëmijë, RTSH Fëmijë 1 (programe të dedikuara për fëmijë të moshës parashkollore) dhe RTSH Fëmijë 2, (programe të dedikuara për fëmijë të moshës shkollore e të rinisë);
- një program (kanal) tematik RTSH Lajme (kanal tematik informativ);
- një program (kanal) tematik RTSH JETË (me programe të dedikuara për mënyrën e

jetesës, udhëtimet, turizmin, kuzhinën, veshjen, shëndetin dhe trupin).

RTSH është zotuar në Kontratë se do të transmetojë të paktën një edicion informativ në 24 orë në dy kanalet gjeneraliste RTSH 1 dhe RTSH 3 për personat me nevoja të veçanta shqisore, duke siguruar emetim simultan në një kënd të ekranit. Nga shqyrtimi rezultoi se një akses i tillë për këta persona ishte siguruar vetëm në RTSH 1.

Për pjesën e shqyrtimit që vlerësonte nivelin e mbulimit me sinjal të transmetimeve të RTSH-së, AMA evidentoi se në 12 bashki nuk kishte asnjë shërbim audioviziv nga Transmetuesi Publik. Në këtë situatë qytetarëve u kufizohej një prej të drejtave kushtetuese, ajo e informimit, në një kohë që ata paguanin taksën mujore për shërbimin e RTSH-së.

Gjetjet dhe përfundimet e këtij shqyrtimi AMA ia dërgoi me shkresë zyrtare dhe Drejtorisë së Përgjithshme dhe anëtarëve të Këshillit Drejtues të RTSH-së. Autoriteti do të vijojë periodikisht monitorimin dhe vlerësimin e procesit të ndërtimit të platformës programore të RTSH-së, si dhe nivelin e mbulimit me sinjal, informacion të cilin do ta ndajë dhe me drejtuesit e këtij institucioni, jo vetëm përmes shkresave, por dhe kontakteve të drejtëpërdrejta.

Pas miratimit të kontratës së mësipërme, RTSH, në zbatim të nenit 15 të kontratës ku parashikohet mënyra e amendimit të saj, ka kërkuar të ndërtojë një rrjet të ri transmetimi kombëtar radio FM, pa pagesë, "Radio Tirana Klasik". Objekti i shtojcës së kontratës është ofrimi i një shërbimi audio kombëtar pa pagesë, "Radio Tirana Klasik". Kanali audio "Radio Tirana Klasik" do të transmetojë 24 orë në 24 program me muzikë klasike me repertorin më të mirë të muzikës klasike botërore dhe shqiptare, të ekzekutuar nga Orkestra Simfonike e RTSH-së, por edhe nga orkestra të tjera evropiane dhe botërore.

Në zbatim të ligjit nr. 97/2013, RTSH si operator publik ka të drejtë të ngrejë, të mirëmbajë dhe të vërë në funksionim shërbimin kombëtar të transmetimeve audio dhe audiovizive, i cili duhet të jetë shërbim transmetimi pa pagesë për publikun dhe i kapshëm, për aq sa është e mundur, nga të gjithë individët në Republikën e Shqipërisë, të përfshijë në transmetimet e saj pa pagesë jo më pak se 2 programe kombëtare transmetimi audio.


Në referencë të sa më sipër, AMA, me vendimin nr. 82, datë 29.05.2017, ka miratuar shtojcën e kontratës së shërbimit të transmetimit.

8.8. Planifikimi dhe administrimi i spektrit të frekuencave

8.8.1. Planifikimi i frekuencave për shërbimet audiovizive

Planifikimi i spektrit të frekuencave është një proces i rëndësishëm në mbështetje të përmirësimit të mbulimit me sinjal të operatorëve ekzistues audio/audiovizive, në funksion të krijimit të hapësirave të nevojshme për implementim e operatorëve të rinj në treg, si dhe me synimin për të parandaluar interferencat e dëmshme drejt shërbimeve audio/audiovizive dhe shërbimeve të tjera.

Brezat që administrohen nga AMA janë brezat që përdoren për transmetimet audio dhe audiovizivë:



Në kuadër të planifikimit të frekuencave për shërbimin audioviziv, gjatë vitit 2017, AMA ka ndjekur procesin e migrimit të frekuencave dhe procesin e lirimit të brezit DD1. Aktivitetet e ndërmarra në lidhje me këto procese janë identifikuar më sipër.

Gjithashtu, AMA ka vlerësuar kapacitetet e lira të frekuencave të brezit audiovizivë me qëllimin për të përmbushur kërkesat e paraqitura në AMA nga operatorët audiovizivë në treg, për përdorimin e tyre në mënyrë të përkohshme deri në kalimin e plotë në transmetimet numerike.

Përcaktimet frekuencore për ndërtimin e rrjeteve kombëtare numerike (publik dhe privat) nuk kanë pësuar ndryshime.

Ndërkohë, frekuencat e lira që janë parashikuar për licencimin e operatorëve lokalë/rajonalë mbeten ende të pashfrytëzuara. AMA, me vendimin nr. 100, datë 07.06.2017, ka miratuar rregulloren “Për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës lokale të transmetimit audioviziv në periudhën tranzitore”, duke i hapur kështu rrugën licencimit të operatorëve lokalë/rajonalë.

Kanalet frekuencore për 2 rrjetet publike kombëtare numerike të RTSH-së në brezin UHF

Rrjetet Publike	Allot Shkodër	Allot Kukës	Allot Dibër	Allot Lezhë	Allot Tiranë	Allot. Elbasan	Allot Fier	Allot Berat	Allot Korçë	Allot Gjirokastrë	Allot Vlorë
MUX-1	28	26	38	43	34	23	27	25	43	26	23
MUX-2	41	32	24	23	21	33	31	30	45	37	39

Kanalet frekuencore për 5 rrjetet private kombëtare numerike në brezin UHF

Rrjetet private	Allot Shkodër	Allot Kukës	Allot Dibër	Allot Lezhë	Allot Tiranë	Allot. Elbasan	Allot Fier	Allot. Berat	Allot Korçë	Allot. Gjirokastrë	Allot. Vlorë
Klan MUX-3	34	50	55	33	41	42	35	32	51	44	46

Digitalb MUX-4	59	40	30	46	53	48	28	36	55	29	57
Top Channel MUX-5	45	42	25	29	59	49	22	54	57	50	43
Vizion + MUX-6	22	36	54	----- -	57	46	29	24	21	48	-----
ADTN MUX-7	51	52	60	----- -	39	40	45	47	27	35	-----

Kanalet frekuencore të mbetura të lira për brezin VHF dhe UHF janë:

	Allot. Shkodër	Allot. Kukës	Allot. Dibër	Allot. Lezhë	Allot. Tiranë	Allot. Elbasan	Allot. Fier	Allot. Berat	Allot. Korçë	Allot. Gjirokastrë	Allot. Vlorë	Suballot. Tiranë
Kanalet e lira në VHF	9	9	8	9	10	7	10	5	6	8	8	6
Kanalet e lira në UHF		56				56	51	52	28	38		26
						58			59	53		37
										56		44
										58		50
									60			60

8.8.2. Koordinimi i frekuencave të brezit audioviziv

Në zbatim të Planit të Veprimit të Dokumentit Strategjik të AMA-s, ku një ndër veprimtaritë e planifikuara ishte edhe koordinimi me vendet nënshkruese të Marrëveshjes së GE06 mbi riorganizimin e frekuencave të planeve frekuencore përkatëse për evidentimin e hapësirave të optimizimit dhe të shtimit të kapaciteteve transmetuese, AMA ka marrë pjesë në takimet koordinuese të zhvilluara nga vendet e rajonit.

Vendet e rajonit kanë ndërmarrë nisma për koordinimin e përbashkët lidhur me përdorimin e brezit audioviziv nisur edhe nga zhvillimet e fundit mbi reduktimin e këtij brezi. Brezi 470-790 MHz do të reduktohet, duke përjashtuar brezin 694-790 MHz (brezi DD2), i cili është përcaktuar për t'u përdorur për shërbimet broadband.

Më konkretisht, AMA ka marrë pjesë në takimet koordinuese të administratave të zonave bregdetare të Adriatikut dhe Jonit (konkretisht administratave të Shqipërisë, Kroacisë, Greqisë, Italisë, Malit të Zi, San Marinos dhe Sllovenisë), si dhe ka qenë e njohur me rezultatet e marrëveshjes shumëpalëshe të Forumit të Implementimit të Dividentit Digital

në Evropën Jugore (SEDDIF).

Lidhur me këto dy nisma ndërkombëtare, AMA ka bërë me dije se në Shqipëri ende nuk ka akte të miratuara në kuadrin ligjor/rregullator që trajton strategjinë, modalitetet apo afatet për lirim e brezit DD2. Dokumenti i vetëm që pritet të trajtojë këtë çështje është Dokumenti i Politikës Kombëtare të Spektrit, i cili aktualisht është ende në fazën e hartimit.

AMA ka zhvilluar takim me operatorët kombëtarë numerikë (publik dhe privat), duke i informuar ata mbi këto procese koordinuese. Nga takimi i zhvilluar rezultoi se operatorët audiovizivë numerikë kundërshtonin këto procese, për faktin se ata janë ende duke investuar për ndërtimin e rrjeteve numerike dhe ndryshimet që do të ndodhin me lirim e brezit DD2 nuk marrin në konsideratë këto investime. AMA ka licencuar operatorët numerikë me afat 15 vjet, duke marrë në konsideratë vlerën e kthimit të investimit. Ndryshimet e diktura në një kohë kaq të shkurtër janë të papërbalueshme për këta operatorë. Gjendur në këto kushte, AMA nuk ka nënshkruar draft-marrëveshjet e sipërcituara.

Ndërkohë, AMA ka kryer studimet teknike dhe ka verifikuar përputhshmërinë e propozimeve të paraqitura nga vendet e rajonit me përcaktimet në Planin GE06. Rezulton se të gjithë kanalet janë sipas përcaktimeve të këtij plani, duke përjashtuar kanalën Ch46, i cili në marrëveshje është përcaktuar për ta pasur në përdorim Italia, ndërkohë që aktualisht është në përdorim nga operatorët tanë audiovizivë. Lidhur me këtë kanal i është përcjellë shqetësimi edhe palës Italiane, me të cilën pritet të zhvillohen takime dypalëshe për të diskutuar mbi përdorimin e këtij kanali e më gjerë.

8.8.3. Planifikimi i frekuencave për shërbimet audio

Sa i takon planifikimit dhe administrimit të spektrit audio 87.5-108 MHz, AMA ka vlerësuar periodikisht kapacitetet e lira të frekuencave audio dhe ka përditësuar Planin e Përdorimit të frekuencave për këto shërbime.

Zonat që indentifikohen problematike në lidhje me disponueshmërinë e frekuencave të lira janë qarqet Tiranë, Durrës dhe Fier, ndërkohë për të gjithë zonat e tjera disponohen resurset e nevojshme.

AMA ka kryer studime teknike në programin profesional ICS Telecom për licencimin e dy radiove kombëtare, njëra i përket operatorit publik dhe tjetra për çdo subjekt privat të interesuar.

Gjithashtu, janë kryer studime edhe lidhur me kërkesat e paraqitura nga subjektet audio për ndryshim të karakteristikave teknike të transmetimit (si CRI, Rash, Radio Fieri etj). Studimet konsistojnë në kryerjen e llogaritjeve teknike mbi mbulimin e zonës së shërbimit me sinjal, si dhe shmangien e interferencave të ndryshme brenda dhe jashtë vendit.

Referuar Planit të Veprimit të Dokumentit Strategjik të AMA-s, janë vlerësuar përputhshmëritë e pikave transmetuese dhe frekuencave të licencuara për transmetimet audio në Republikën e Shqipërisë me marrëveshjet ndërkombëtare në fuqi.

Nga verifikimet e kryera ka rezultuar se nuk ka përputhshmëri midis pikave transmetuese/frekuencave që kanë në përdorim operatorët audio në treg me të dhënat e regjistruara në regjistrat ndërkombëtarë. Për këtë arsye nevojitet koordinim i frekuencave me vendet fqinje dhe pas miratimit të tyre duhet të bëhet regjistrimi në regjistrin ndërkombëtar të ITU-së. Meqë AMA ka qenë e angazhuar me procesin e digjitalizimit të transmetimeve audiovizive, ishte e pamundur të ndërmerret hapa koordinues me vendet fqinje sa u takon frekuencave të shërbimit audio.

8.9. Adresimi i interferencave të shkaktuara në vendet fqinje

AMA, gjatë vitit 2017, ka ndërmerret disa aktivitete për të shmangur interferencat e dëmshme të shkaktuara nga operatorët audiovizivë shqiptarë drejt operatorëve të vendeve fqinjë si Mali i Zi dhe Maqedonia. Interferencat shkaktoheshin në brezin 790-862 MHz (brezi DD1), i cili në vendin tonë përdorej për transmetimet audiovizive, ndërkohë vendet fqinjë e përdorin këtë brez për shërbimet mobile (LTE).

Për zgjidhjen e interferencave të shkaktuara drejt Malit të Zi është bashkëpunuar ngushtë me homologët tanë të vendit fqinjë, si dhe me operatorët audiovizivë, që përdornin frekuenca të brezit DD1. Nëpërmjet koordinimit me autoritetin rregullator të Malit të Zi (EKIP), fillimisht është bërë e mundur shmangia e interferencave që shkaktoheshin nga operatorët audiovizivë shqiptarë, që transmetonin në pikën e transmetimit Tarabosh (Shkodër), por ndërkohë vijonin ndërhyrjet (interferencat) nga transmetues të tjerë. Për identifikimin e tyre, AMA dhe EKIP, pas organizimit të një takimi të përbashkët pune ku u diskutuan mundësitë dhe afatet përfundimtare të zgjidhjes së çështjes, zhvilluan një monitorim të përbashkët në terren, ku u identifikua se interferencat shkaktoheshin edhe nga pikat e transmetimit Fushë Dajt dhe Tyrbe Lezhë. Ato u shmangën në kohë të shkurtër, duke eliminuar përfundimisht interferencat drejt Malit të Zi.

Gjithashtu, hapa bashkëpunimi janë ndërmerret edhe me rregullatorin e Maqedonisë në kuadër të identifikimit të burimeve të interferencës së shkaktuar. Duke qenë se këto interferenca shkaktoheshin nga transmetimet në pikat transmetuese të vendosura në qarkun e Korçës, shmangia plotësisht e tyre është realizuar vetëm pas mbylljes së transmetimeve analoge në qarkun e Korçës.

Në këtë mënyrë, AMA ka zgjidhur përfundimisht problemin e interferencave të dëmshme të shkaktuara drejt vendeve fqinjë.

Gjithashtu, janë shmangur dhe interferencat e shkaktuara nga operatorët audiovizivë të Maqedonisë drejt vendit tonë, të cilët përdornin frekuenca jashtë planit GE06, të akorduara për operatorët tanë audiovizivë që transmetojnë në qarkun e Korçës. Pas korrespondencave dhe bashkëpunimit me homologët maqedonas, u bë e mundur shmangia e interferencave dhe mbyllja brenda afatit i transmetimeve analoge në qarkun e Korçës.

8.10. Angazhimi i Autoritetit në zhvillimet teknologjike të tregut audioviziv

Teknologjia digjitale po zëvendëson atë analoge jo vetëm në fushën e mediave audiovizive, por në të gjitha fushat. Përfitimet që sjellin këto teknologji janë të ndjeshme për konsumatorin, për sipërmarrësit, si dhe ndikojnë ndjeshëm në rritjen ekonomike të një vendi.

Nisur nga kjo, AMA, me vendimin nr. 182, datë 6.9.2016, ndërmori hapin për kalimin e plotë në teknologjinë digjitale të transmetimeve audiovizive mbështetur në rrjetin kabllor, duke ulur afat subjekteve ekzistues në treg për të ndryshuar teknologjinë e tyre analoge deri më datë 31.12.2017.

AMA, me shkresa zyrtare, ka mbajtur të informuar subjektet e autorizuar për të ofruar shërbime audiovizive mbështetur në rrjet kabllor se afati i fundit i përdorimit të teknologjisë analoge është 31.12.2017. Ndërkohë ka autorizuar hyrësit e rinj në treg për ofrimin e shërbimeve audiovizive, bazuar në teknologjinë digjitale.

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në bashkëpunim me Ministrinë e Inovacionit dhe Administratës Publike, në kuadër të Javës së Inovacionit, më datë 17 maj 2017, organizuan konferencën me temë "Digital Switchover & Broadband Services".

Në konferencë ishin të ftuar përfaqësues të rregullatorëve të pavarur - AMA dhe AKEP - të operatorëve kryesorë në fushën e transmetimeve audiovizive dhe komunikimeve elektronike, si dhe grupe interesi lidhur me median dhe komunikimet elektronike.

Zhvillimet teknologjike dhe tendencat e tregut audio/audiovizive dhe tregut mobile në Shqipëri për implementimin e teknologjive të reja ishin në fokus të këtij organizimi. Prezantimet e mbajtura paraqitën ndër të tjera, të rejtat mbi teknologjitë e avancuara në rrjetet DVB-T2, revolucionin në teknologjitë mobile (e ardhmja e rrjeteve 5G), rrjetet/infrastrukturat e gjeneratës së ardhshme, si dhe projektet për zhvillimin e broadband në Shqipëri.

9. AUTORITETI NË PËRMBUSHJE TË TRANSPARENCËS DHE RITJES SË IMAZHIT INSTITUCIONAL

9.1. Programi i transparencës

Në kuadër të programit të transparencës, Autoriteti i Mediave Audiovizive është angazhuar të përditësojë herë pas here informacionin publik në përputhje me Ligjin për të Drejtën e Informimit. Faqja zyrtare web e AMA-s, www.ama.gov.al, është burim informacioni për shumë media, ekspertë, gazetarë, ndërkombëtarë etj, dhe mban parasysh interesin më të mirë të publikut dhe sidomos garantimin e njohjes maksimale me informacionin publik, duke vënë në dispozicion shumë informacione pa kërkesë, me qëllim pakësimin e nevojave për kërkesa individuale për informacion.

Në përmbushje të programit të transparencës, në faqen zyrtare të AMA-s, www.ama.gov.al

në rubrikën përkatëse të transparencës gjendet informacioni i përditësuar mbi buxhetin vjetor, mbi realizimet për të ardhurat dhe shpenzimet, si dhe informacionin lidhur me procedurat për prokurimet publike të ndjekura nga AMA.

Gjithashtu, në faqen zyrtare web të AMA-s janë të publikuara të gjitha informacionet në lidhje me strukturën organizative të AMA-s, të dhënat mbi arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, si dhe struktura e pagave për të gjithë nëpunësit e tjerë.

Për vitin raportues, pranë AMA-s kanë ardhur rreth 80 kërkesa, të cilat gjendet të pasqyruara edhe në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve në faqen zyrtare të Autoritetit, www.ama.gov.al nën Rubrikën Veprimtari/Transparenca, ku janë përfshirë edhe kërkesat për kryerjen e shërbimeve nga ana e Autoritetit.

Ky program transparence është në përputhje të plotë me ligjin mbi të drejtën e informimit dhe rrit dukshëm imazhin institucional, duke përmirësuar qeverisjen e Autoritetit.

Gjatë periudhës raportuese, AMA ka qenë palë e paditur ose palë e tretë në procese gjyqësore administrative/civile për zgjidhjen e konflikteve të ndryshme. Krahas proceseve gjyqësore të filluara në vitin 2017, AMA ka ndjekur proceset gjyqësore të iniciuara përpara vitit 2017, të cilat për shkak të ushtrimit të ankimeve apo rekurseve prej palëve ndërgjyqëse janë në proces gjykimi në Gjykatat e Apelit apo Gjykatën e Lartë.

Si person juridik, edhe AMA në disa raste, ka vënë në lëvizje gjykatën në cilësinë e palës paditëse, me palë të paditur subjektet audio/audi vizive. Konkretisht, AMA ka depozituar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, kërkesë paditë për subjektet debitorë, të cilëve u është hequr licenca/autorizimi në vitet 2015 dhe 2016.

Pasqyrimi në mënyrë të përmbledhur i çështjeve gjyqësore në gjykim, në tre shkallët e gjyqësorit, të ekzekutuara dhe të përfunduara gjatë vitit 2017, paraqitet në aneksin nr. 1.

9.2. Publikimi i Buletinit Periodik të AMA-s

Publikimi i të dhënave me natyrë ekonomike, teknike, pronësore, përmbajtësore, të burimeve njerëzore etj., si pjesë e Buletinit Periodik të AMA-s, është një kontribut për transparencën e tregut audioviziv në Republikën e Shqipërisë. Gjatë vitit 2017 treguesit e Buletinit ka qenë shumë referencialë në punimet dhe kërkimet studimore të pedagogëve të shkencave të komunikimit dhe gazetarisë, si dhe në procesin e përgatitjeve të temave të diplomave dhe detyrat e kursit të studentëve të këtij drejtimi. Përveç kësaj, dy subjekte joqeveritare të njohura për projekte ndërkombëtare në fushën e transparencës së mediave - platforma ballkanike investigative, BIRN dhe kompania e kërkimeve dhe konsulencës IDRA - nga fundi i vitit 2017, bazuar në të dhënat e Buletinit Periodik, po bashkëpunojnë me AMA-n në shkëmbimin e informacionit mbi tregun audioviziv, veçanërisht mbi aspektet e pronësisë në këtë sektor.

Në edicionin e tretë të Buletinit, AMA do të prezantojë dhe të dhënat e detajuara të pronësisë në subjektet e licencuara audio dhe audiovizive, në përmbushje të transparencës dhe informimit të publikut dhe grupeve të interesuara.

Në dy edicionet e para, panorama e pronësisë është treguar bazuar jo në subjekte të veçanta, por bazuar në katër grupet e mëdha të OSHMA-ve: televizionet, radiot, kabllorët dhe shërbimet e tjera.

Në vijim, përmbajtja e Buletinit Periodik të AMA-s, treguesit e performancës do të

reflektojnë dhe ndryshimet objektive që ka pësuar dhe do të pësojë tregu audioviziv në Republikën e Shqipërisë nga përmbyllja e procesit të digjitalizimit, ku tregu rikonfigurohet me 7 platforma digjitale tokësore dhe kanalet televizive që do të barten në to.

9.3. Menaxhimi i performancës së burimeve njerëzore

Në përmbushje të qëllimit strategjik të Planit Strategjik të Veprimit 2017-2019, mbi objektivin specifik, përfundimi i qeverisjes dhe zhvillimi i organizatës, AMA-s ka pasur angazhim maksimal në realizimin e një organizate të shërbimit publik të zhdërvjellët, efikase, që evoluon vazhdimisht.

Në kuadër të përmirësimit të kapaciteteve institucionale të Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe prioriteteve të vendosura për vitin 2017, si dhe mbi bazën e një studimi analitik mbi nevojat dhe mundësitë e reja të trajnimeve, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në fillim të vitit kalendarik ka hartuar Kalendarin Vjetor të Trajnimeve, duke parashikuar analizën e nevojave për trajnim, mbi bazën e të cilit punonjësit u përfshinë gjatë vitit në një proces trajnimesh, që mundësuan njohjen me standardet dhe praktikën më të mira për administratën publike.

Trajnimet janë realizuar në disa forma, duke filluar nga ato të drejtpërdrejta brenda vendit të punës, nga punonjësit më të kualifikuar, deri te shkëmbimi i përvojave me organizmat ndërkombëtarë, si dhe trajnimet pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASP), ku përfshihen praktika njohjeje për nëpunësit civilë të saporekrutuar dhe programe të vazhdueshme trajnimi profesionale për nëpunësit civilë të administratës publike.

AMA i ka kushtuar rëndësi të madhe bashkëpunimit me ekspertë të organizatave të ndryshme ndërkombëtare, në kuadër të zhvillimit të kapaciteteve të stafit, rritjes së aftësive profesionale dhe përmirësimit të njohurive bazë. Në këtë kontekst përmendim trajnimet e kryera si më poshtë:

- Trajnim për stafin e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) me temë “Mbrotjtja e të Drejtave të Njeriut dhe Anti-Diskriminimi” nga ekspertë të Këshillit të Evropës, në kuadër të projektit të përbashkët BE–KiE “Rritja e Efektivitetit të Sistemit Shqiptar të Mbrotjtjes së të Drejtave të Njeriut dhe Anti-Diskriminimit”. Në fokus të këtij trajnimi ishte mbrotjtja e të drejtave të njeriut, analizimi i konceptit të anti-diskriminimit në kuadër të kornizës ligjore kombëtare e ndërkombëtare, prezantimi i hartës institucionale dhe sjellja në vëmendje e roleve dhe përgjegjësi përkatëse për çështjet e anti-diskriminimit, si dhe roli i AMA-s në promovimin e praktikave anti-diskriminuese dhe sanksionimin e gjuhës dhe praktikave diskriminuese.

Ekspertë të Këshillit të Evropës trajtuan kuadrin ligjor dhe standardet e mos-diskriminimit, duke dhënë informacion të përgjithshëm për kuadrin ligjor shqiptar mbi rregullat, standardet dhe masat anti-diskriminuese. Ky trajtim solli në vëmendje edhe nevojën për rishikim dhe azhurnim të kuadrit ligjor të AMA-s me praktikën evropiane, duke iu referuar Konventave Ndërkombëtare të Ratifikuara, Konventën e Mbrotjtjes së të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, si dhe Direktivat e Bashkimit Evropian për Trajtimin e Barabartë.

Trajnim për nëpunësit e institucionit me temë: “Rritja e efektivitetit në realizimin e objektivave dhe roli e përgjegjësia e çdo nëpunësi civil” i organizuar nga ekspertë ndërkombëtarë me përvojë shumëvjeçare, të specializuar në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore, e cila me përvojën dhe metodologjinë e perzgjedhur, bëri të

mundur një komunikim interaktiv me çdo nëpunës pjesëmarrës, duke krijuar në këtë mënyrë një formë të ndryshme dhe së tepërmi efektive të përcimit të informacionit, ideve, koncepteve mbi menaxhimin dhe orientimin e burimeve njerëzore.

- Trajnim individual për nivelin drejtues të njërive organizative me temë: *“Menaxhimi i personelit/performancës individuale”*, ku qëllimi i përgjithshëm përfshinte vendosjen e objektivave, metodat dhe mjetet e menaxhimit të personelit, menaxhimin e performancës, kryesisht: vlerësimi i performancës si mjet drejtimi; drejtimi i bazuar në objektiva; vendosja e objektivave, treguesve dhe planit; duke u dhënë nëpunësve civilë një mundësi për të forcuar kapacitetin e tyre menaxhues të burimeve njerëzore dhe promovimin e zhvillimit të tyre profesional, me qëllim marrjen e përvojës sipas fushave të përgjegjësive dhe të drejtave specifike që mbulojnë.
Gjatë vitit raportues, AMA ka zbatuar planin vjetor të rekrutimit, duke organizuar dhe drejtuar punën për zbatimin me përpikmëri të legjislacionit të shërbimit civil, nëpërmjet forcimit të parimit të meritës në rekrutim, rritjen e mobilitetit dhe zhvillimit të karrierës brenda shërbimit civil.
- Një tjetër formë trajnimi ka qenë pjesëmarrja në trajnimet e zhvilluara nga Shkolla Ligjore e Leidenit, Komiteti Holandez i Helsinkit (NHC) dhe Akademia e Hagës për Qeverisjen Vendore (THA), ku nëpërmjet aplikimit online çdo nëpunësi civil, i është ofruar mundësia për t’u trajnuar në fushën e medias, ku është njohur me praktikat më të mira në një gamë të gjerë temash të sundimit të ligjit, nëpërmjet sesioneve interaktive që kombinojnë teorinë, aftësitë praktike dhe vizitat studimore. Nëpërmjet këtij rrjeti bashkëpunimi u ofrua një platformë për mësim, shkëmbim dhe bashkëpunim.
- Në vëmendje kanë qenë dhe trajnimet inovative për ndërgjegjësimin mjedisor të stafit të AMA-s, ku vlen të përmendet trajnimi i zhvilluar nga AMA në bashkëpunim me Creative Business Solution (CBS), një organizatë që ofron konsulencën ndaj ekspertizave më të mira në këtë fushë, në kuadër të politikave të gjelbërta “Eficenca e Energjisë dhe adoptimi i një plan-veprimi për përmirësimin e saj”. Duke marrë parasysh përgjegjësinë e lartë sociale të AMA-s si institucion shtetëror dhe për më tepër si Autoriteti Rregullator i Mediave Audiovizive, AMA është nga institucionet e para, i cili është zotuar të promovojë përpjekje të mëtejshme për t’u bërë më miqësore me mjedisin dhe të mbështesë praktikatat ambientaliste.

Në lidhje me mbledhjet e AMA-s, gjatë vitit 2017 janë zhvilluar 14 mbledhje, në të cilat të gjithë anëtarët e AMA-s kanë qenë të pranishëm.

9.4. Infrastruktura e informacionit dhe e njohurive

Rritja e kapaciteteve komunikuese dhe përpunuese në fushën e Teknologjisë së Informacionit

Gjatë vitit 2017, në kuadër të rritjes së efektivitetit në punë, janë përmirësuar kapacitetet komunikuese dhe përpunuese të informacionit në institucionin e AMA-s. Kjo rritje ka sjellë

një performancë më të lartë të zhvillimit të detyrave funksionale, si dhe shtim të elementëve të sigurisë mbi ruajtjen e informacionit.

Rritja e kapaciteteve komunikuese, përpunuese, si dhe rritja e elementëve të sigurisë së informacionit në AMA konsiston më konkretisht si më poshtë:

- Rrjeti i komunikimit kompjuterik është tërësisht i ri dhe me parametra bashkëkohorë, duke sjellë komunikim të shpejtë dhe pa ndërprerje të punës së punonjësve të AMA-s (ndryshimet u kryen si pasojë e ndërrimit të godinës së AMA-s).
- Vënia në efikasitet të Serverit qendror të AMA-s, duke sjellë rritjen e elementëve të sigurisë së informacionit komunikues dhe përpunues në AMA.
- Rritje me 70 % të kapacitetit elektronik dhe programor në studion e monitorimit të programeve, duke rritur ndjeshëm përpunimin e informacionit mediatik, si dhe ruajtjen e sigurtë të tij.
- Rritjen e sistemeve të kontrollit në AMA, ku përfshihen sistemi i kamerave, sistemi i alarmit dhe sistemi i hyrje-daljeve në institucion.
- Përmirësimi i linjave telefonike komunikuese.
- Rrjeti elektrik në AMA është tërësisht i ri dhe me parametra bashkëkohorë, duke siguruar vijimësinë e punës në rast se shkëputet energjia elektrike (ndryshimi u krye si pasojë e ndërrimit të godinës së AMA-s).
- Sigurimi i dy linjave interneti të pavarura për komunikimin e brendshëm të punonjësve, duke siguruar vijimësinë e punës në raste defektesh.

Në kuadër të rregullimit të proceseve të administrimit, ruajtjes, funksionimit, përpunimit dhe menaxhimit të të dhënave të informacionit, AMA ka miratuar rregulloret dhe procedurat përkatëse që duhet të ndiqen nga punonjësit e AMA-s.

Më poshtë janë listuar emërtimet e akteve të përgatitura:

- Procedura e ndryshimeve në pajisjen fundore;
- Procedura e menaxhimit të incidentit të pajisjeve fundore;
- Procedura e monitorimit dhe mirëmbajtjes;
- Procedura e ndryshimeve në dhomën teknike (dhoma e serverëve);
- Procedura e lidhjes në distancë me rrjetin e AMA-s;
- Procedura e konfigurimit të mail client dhe mirëmbajtjes së faqes;
- Procedura e instalimit të sistemeve të operimit;
- Procedura Backup dhe Restore (e ruajtjes së informacionit në rrjetin kompjuterik të AMA-s).

10. TREGUESIT FINANCIARË DHE MENAXHIMI I BURIMEVE

10.1. Menaxhimi i burimeve financiare

10.1.1. Burimet e financimit

Bazuar në nenin 24, të ligjit nr. 97/2013, burimet e financimit të AMA-s janë:

- a) të ardhurat nga pagesat për marrjen dhe rinovimin e licencave dhe/ose autorizimeve;
- b) të ardhurat nga pagesat vjetore të licencave dhe/ose autorizimeve;
- c) të ardhurat nga përpunimi administrativ i kërkesave për aplikime;
- ç) të ardhurat nga tarifatat për shërbimet e transmetimeve të caktuara në ligjet fiskale, në rolin
- e) e agjentit tatimor;
- d) financime nga Buxheti i Shtetit;
- dh) burime të tjera të ligjshme.

AMA, me vendimin nr. 247, datë 21.12.2016, ka miratuar buxhetin vjetor për vitin 2017.

Në zërin të *ardhura të pritshme* u përfshinë të ardhura nga vetëfinancimi dhe të ardhura të pritshme nga Buxheti i Shtetit.

AMA, në buxhetin për vitin 2017, ka parashikuar financimin nga Buxheti i Shtetit të detyrimit të lindur për shoqërinë "Media+" sh.a. (Tv Shijak) në masën **81,951,292 lekë**. AMA ka lidhur akt-marrëveshje me shoqërinë "Media +" sh.a. në dhjetor 2015, për të parandaluar ekzekutimin e menjëhershëm të detyrimit të përcaktuar në urdhrin e ekzekutimit të detyrueshëm. Kjo akt-marrëveshje e lidhur ka përfunduar në datën 01 janar 2018. Deri më sot, AMA-s nuk i është akorduar asnjë fond nga Buxheti i Shtetit për këtë detyrim.

Bazuar në VKM-në nr. 292, datë 02.05.2012 "*Për miratimin e strategjisë së kalimit nga transmetimet analoge në ato numerike*", AMA ka kërkuar gjatë vitit 2017 financime nga Buxheti i Shtetit për vijimin e procesit të informimit të publikut.

Gjatë vitit 2017, AMA, në mungesë të financimit nga Buxheti i Shtetit për vijimin e fushatës së informimit të publikut për kalimin e transmetimeve analoge në transmetime numerike (gjatë muajve maj - nëntor 2017), miratoi ndryshimet në buxhet me vendimet nr.17, datë 02.03.2017 dhe nr.58, datë 10.05.2017.

Me VKM-në nr.708, datë 01.12.2017 "*Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2017, miratuar për Kryeministrinë*", AMA-s iu akordua fondi 40,000,000 lekë, i cili po përdoret për vijimin e organizimit të fushatës së informimit të publikut për kalimin e transmetimeve analoge në transmetime digjitale për muajt janar- prill 2018.


10.1.2. Ecuria e arkëtueshmërisë të burimeve të vetëfinancimit

AMA, gjatë vitit 2017, ka vazhduar me trendin rritës të arkëtueshmërisë së burimeve të saj të financimit, kryesisht zëri "**Të ardhura nga detyrimet për pagesën vjetore për licencë/autorizim**", si më poshtë:

lekë

Vitet	Të ardhura vjetore të pritshme	Të ardhura vjetore të realizuara	Realizimi në %
-------	--------------------------------	----------------------------------	----------------

2013	116,958,810	42,899,741	37%
2014	102,413,197	61,525,629	60%
2015	140,277,514	111,769,232	80%
2016	160,610,044	140,241,752	87%
2017	166,773,463	156,661,376	94%



10.1.3. Detyrimet financiare të OSHMA-ve


OSHMA të rezultuara me detyrime financiare klasifikohen si më poshtë:

a. OSHMA të licencuara/autorizuara;

Pasyqyra përmbledhëse e OSHMA-ve të licencuara/autorizuara që rezultojnë me detyrime financiare ndaj AMA-s dhe buxhetit të shtetit deri në fund të vitit 2017.

lekë

Kategorizimi i OSHMA-ve	Detyrimi i mbetur në fund të vitit 2017
Televizione analogë	7.931.882
Ripërsëritës programi	4.201.093
Ofrues programi	293.050
Radio analoge	994.486
Totali	13.420.511




b. OSHMA me licenca/autorizime të hequra/të pavlefshme gjatë vitit 2017

AMA, gjatë vitit 2017, ka vijuar marrje vendimesh për heqje licence/autorizime për OSHMA-të, si më poshtë:

lekë

Kategorizimi i OSHMA-ve	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Totali
Televizione analogë		5,485,300	415,228	5,900,528
Ripërsëritës programi	10,450,000	60,767,125	3,243,285	74,460,410
Ofrues programi		25,041,700	161,545	25,203,245
Radio analoge		2,428,490	1,232,760	3,661,250
Shuma				109,225,433



10.1.4. Vendime të sanksioneve me gjobë

Gjatë vitit 2017, nga AMA janë vendosur 99 sanksione me gjobë, si më poshtë:

- Drejtoria e Mbikëqyrjes ka vendosur 77 sanksione me gjobë.
- Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme ka vendosur 14 sanksione me gjobë;
- Këshilli i Ankesave ka vendosur 2 sanksione me gjobë;
- Drejtoria e Programacionit ka vendosur 1 sanksion me gjobë;
- Drejtoria Juridike dhe e Licencave ka vendosur 5 sanksione me gjobë.

Ecuria financiare e saksioneve gjobë në vitin 2017

	<i>Lekë</i>
Çelja në fillim të vitit 2017	231.625.817
Vendime të sanksioneve me gjobë në 2017	110.080.000
Kamatvonesa	25,224,722
Detyrime të shlyera nga vendime të sanksioneve me gjobë dhe kamatvonesa	11.325.738
Vendime të denimeve me gjobë të shfuqizuara/ulur masa/shuar titulli ekzekutiv nga përmbaruesi	59.782.000
Detyrimi në fund të 2017	295.822,801

10.1.5. Përdorimi i burimeve financiare

Gjatë vitit 2017, AMA ka menaxhuar burimet financiare bazuar në vendimin e buxhetit nr. 247, datë 21.12.2016, të ndryshuar, Rregjistrin të Parashikimeve Publike për vitin 2017, të ndryshuar dhe fondeve të akorduara nga Buxheti i Shtetit.

Investimet dhe shpenzimet kryesore të kryera janë:

- VKM nr. 468, datë 03.06.2015 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi, Radio Televizioni Shqiptar tek Autoriteti i Mediave Audiovizive, të katit përdhes, katit të parë dhe të dytë të godinës me emërtimin “Atelier për Dekorin e Radio-Televizionit”, nuk u shoqërua me fond financimi nga Buxheti i Shtetit as për investimin “Projekt – preventiv të zbatimit” dhe as për zbatimin e tij. AMA, me fondet e saj, ndërmori një investim në vlerën 95,5 milionë lekë për kthimin e një godine totalisht të amortizuar, në një godinë me kushte funksionale dhe bashkëkohore.

-Me fondet e saj, AMA ka kryer një investim prej 19 milionë lekë për mobilimin e mjediseve/zyrave të godinës së re.

-Me VKM-në nr. 768, datë 02.11.2016 “Për një ndryshim në Vendimin nr. 402, datë 01.06.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2016, miratuar për Kryeministrinë” AMA-s iu akordua nga Buxheti i Shtetit fondi 45,000,000 lekë. Ky fond u përdor për financimin e organizimit të fushatës së informimit të publikut për kalimin e transmetimeve analoge në transmetime digjitale dhe monitorimin e saj për periudhën dhjetor 2016 - prill 2017.

10.2. Pasqyrat Financiare

- Pasqyra "Aktive dhe Pasive"

lekë

Nr.	Emërtimi	Viti 2017	Viti 2016
A.	Aktivët Afatshkurtra (I - IV)	488.792.447	416.835.743
I.	Gjendje Inventari imët	2.367.054	3.039.950
II.	Kërkesa për arkëtim ndaj të tretëve (1 - 4)	420.786.406	313.109.857
1	-Klientë për licencë (Klientë të arkëtueshëm)	114.032.821	70.699.449
	(Klientë hequr licenca)	9.117.208	18.298.879
	(Klientë hequr licenca të zhvlerësuar)	104.915.613	90.167.115
	(Klientë hequr licenca të zhvlerësuar)	-	- 37.766.545
2	-Klientë për tarifën shërbime RTV (Klientë të arkëtueshëm)	8.422.857	10.307.801
	(Klientë hequr licenca)	4.305.057	6.752.301
	(Klientë hequr licenca)	4.117.800	3.555.500
3	-Klientë për gjoba	272.152.989	231.625.817
4	-Klientë për kamatvonesa (Klientë për kamatvonesa për autorizime)	26.177.739	476.790
	(Klientë për kamatvonesa për gjoba)	2.507.927	476.790
	(Klientë për kamatvonesa për gjoba)	23.669.812	
III.	Të tjera kërkesa ndaj të tretëve	2.351.354	68.907
	-Paradhënie	145.210	64.166
	-Diferenca nga shteti për tatime dhe taksa	11.372	4.741
	-Parapagime ndaj të tretëve, gjoba personale etj	2.194.772	-
IV.	Arka dhe Banka	63.287.633	100.617.029
B.	Aktivët Afatgjata (I - II)	151.313.459	57.387.371
I.	Studime dhe kerkime neto	10.705.689	6.308.708
II.	Aktive të qëndrueshme neto	140.607.770	51.078.663
	- Inventar ekonomik	18.568.656	264.270
	- Instalime teknike, pajisje, vegla pune	18.259.522	11.367.490
	- Mjete transporti	4.264.528	4.547.661
	- Shpenzime për ndërtesa administrative	99.515.064	34.899.242
C.	Pasivët (I-IV)	640.105.906	474.223.114
I.	Fondet e veta	35.253.150	74.459.019
II.	Transferta nga MF për Fushatën e Informimit të Publikut për Digjitalizimin	105.000.000	105.000.000
III.	Rezultati ushtrimor i vitit	118.800.048	-39.205.869
IV.	Detyrimet afatshkurtra ndaj të tretëve (1 - 6)	381.052.708	333.969.964
1	Personeli, deficite dhe gjoba	259.334	-
2	Detyrime mbi klientë për shtetin për tatime, gjoba dhe kamatvonesa	284.849.691	230.064.562

3	Detyrime ndaj furnitorëve Detyrime ndaj shtetit për tatime dhe	7.700.096	11.234.158
4	kontribute	819.322	1.586.605
5	Kreditorë të viteve të mëparshme	82.893.542	89.494.892
6	Kreditore për mjete në ruajtje	4.530.723	1.589.747

- **Pasqyra «Të ardhura dhe shpenzime»**

lekë

Nr.	Emërtimi	Viti 2017	Viti 2016
A	Të Ardhurat korente të periudhës	177.256.938	196.156.075
1	Të Ardhura nga Licenca/autorizim	151.702.955	178.623.198
2	Të ardhura si agjent tatimor	2.498.611	992.725
4	Të ardhura nga përpunimi administrativ	1.670.000	5.440.000
5	Të ardhura nga interesat bankare	95.043	120.838
6	Të ardhura të tjera nga gjobat, kamatvonesa për autorizime/gjوبا)	21.290.329	10.979.314
B	Shpenzimet Operative	95.389.415	89.316.932
1	Materiale zyre kancelari	2.610.825	1.584.513
2	Paga, shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli	79.385.814	73.068.973
3	Shpenzime mirëmbajtje të godinës	1.392.900	879.500
4	Shërbime mirëmbajtje pajisje elektronike	110.272	378.970
5	Shpenzime për shërbime furnizuese	5.794.261	5.607.447
6	Shpenzime transporti dhe mirëmbajtje të makinave	3.925.639	2.640.621
7	Taksa Vendore	1.149.258	15.000
8	Shpenzime gjyq, legale	1.020.446	5.141.908
C	Shpenzime të veprimtarisë funksionale të AMA-s	10.942.603	22.358.406
1	Konsulenca, trajnime, studime tregu	1.040.186	4.668.837
2	Shpenzime përfaqësimi	6.534.592	4.770.021
3	Shpenzime për digjitalizimin	3.367.825	12.919.548
D	Fond i Veçantë nga MF për Fushatën e Informimit të Publikut	37.846.801	67.095.980
E	Humbje të vitit	2.034.225	8.621.100

	Shfuqizim gjobash	1.780.000	3.840.000
	Heqje licence/autorizimi, sistemime	254.225	4.781.100
F	Amortizime dhe zhvlerësime të aktiveve të trupëzuara	7.958.991	10.202.981
G	Transferta nga/për organizatat e huaja/buxheti shtetit	40.000.000	0
H	Shuma të parashikuara për rreziqe/sistemime nga vitet e kaluara	-55.715.145	37.766.545
	TOTALI	118.800.048	-39.205.869